ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 23 JANAR 2021. NUMËR 114. VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Timo Flloko ka lindur dhe ka jetuar në Pejë deri në moshën tetëvjeçare, është rritur në Vlorë ndërsa në Tiranë mbaroi institutin e lartë të arteve. Me dhjetra rolet e realizuara në film dhe në teatër, Flloko u bë një yll i kinemasë shqiptare, një artist shumëdimensional. Prej kohësh ka tërhequr vëmendjen e lexuesit me vëllimet poetike si dhe përkthimet si një personalitet i rëndësishëm i kulturës sonë.



Piktura nga Bashkim Ahmeti

TIMO FLLOKO

Pengu im: kinemaja u shua në moshën e pjekurisë profesionale më të epërt, atëhere kur priten veprat e mëdha

Intervistoi Liridon Mulaj

NJË PROZË E PANJOHUR E FAIK KONICËS

"Mendimet e Filopimin Trukuleskut"

nga Sevdai Kastrati (fq. 6)

Ministria e Kulturës e nderoi me çmimin **"Autori i vitit 2020"** për romanin **"Diktatori në Kryq"**, Akademia Kult me çmimin **"Përkthyesi i Vitit 2020"** për romanin **"Njëqind Vjet Vetmi"** të Marquez

Trofeu i dytë i Mira Meksit

(fq. 5)

Por fituesi i vërtetë është lexuesi shqiptar i cili mund ta lexojë tani kryeveprën e letërsisë botërore "Njëqind vjet vetmi" të përkthyer për herë të parë nga origjinali.

ABSURDI I POLITIKËS NË VËLLIMIN "PRILL I HIDHUR" TË POETIT BARDHYL LONDO

nga Kujtim Mateli (fq. 16)

Poezia e Bardhyl Londos është realiteti në të cilin jetojmë, realiteti që prekim dhe e përjetojmë çdo ditë, prej të cilit provojmë gëzimet apo hidhërimet, është realiteti i botës shqiptare që ne trashëgojmë nga njëri brez në tjetrin...

"Të fshehtat e treguara" të Rexhep Qosjes -një roman postmodern

nga Feride Papleka (fq. 12)



Ka romane që e pasurojnë letërsinë, sepse hedhin një dritë të re edhe me anë të teknikave strukturore të shkrimit. Duke paraqitur metarrëfimin si mjet për të shmangur kontrollin e përhershëm të autorit që doemos çon në një kuptim të vetëm, ata kthehen në një parodi për epokën apo për disa dukuri dhe karaktere të saj.

Kur letërsia shqipe përfiton nga "përkthyesi i padukshëm"

Bisedë e gazetares Mimoza Hasani Pllana me autoren skoceze (fq. 14)

MORELLE SMITH

MARIO VARGAS LLOSA

Leximi i letërsisë së mirë

(fq. 21)

BIBLIOTEKË

Shazim Mehmeti (fq. 15)
Miniatura

Ajkuna Dakli (fq. 18)
Rruga e gjatë

Roland Gjoza (fq. 19)
Tropik Melankolik

John Cheever (fq. 20)
Alarmi i katërt

Qazim Shehu (fq. 21)
Solidaritet njerëzor

Flurans Ilia

MIGJENI TREGIMTAR KRAHASUAR ME KOLIQIN DHE KAFKËN

(fq. 10)

TIMO FLLOKO

Pengu im: kinemaja u shua në moshën e pjekurisë profesionale më të epërt, atëhere kur priten veprat e mëdha.

Intervistoi LIRIDON MULAJ

Prej disa vitesh keni zgjedhur letërsinë si strehën tuaj. Së fundmi, lexuesi ka në dorë përmbledhjen tuaj me poezi "Trup e shpirt" nga botimet Onufri. A është kjo nje notë proteste ndaj artit skenik dhe kinematografisë e cila noton ende në ujëra të vakëta apo një stad i nevojshëm, një përkushtim dhe konsolidim i letërsisë suaj, së cilës keni vendosur t'i dedikoheni në vazhdimësi duke e mbivendosur në krye të angazhimeve tuaja?

Sigurisht nuk është protestë, edhe pse misioni i artit është ta përsosë botën dhe një nga mjetet është edhe protesta. "Trup e shpirt" është një përzgjedhje e dy librave të mi të mëparshëm ku janë përpunuar thuajse nëntëdhjetë përqind e poezive, si dhe poemat që janë në të, të cilat unë i çmoj. Sigurisht ka dhe poezi të reja. Poezia për mua është një art sa i thellë, koncentrik, aq dhe përfaqësues dhe përgjithësues, pra thelbi i artit; poezinë pra e kam siç ju e keni cilësuar në mënyrë metaforike një strehë, mënyrë për ta mbushur jetën, për ta pasuruar, për ti dhënë profesionit tim primar, atij të aktorit frymëzimin, nuancat , ato ngjyra që poezia i ka të fuqishme. Pse jo dhe konsizitetin, thellësinë, shtrirjen dhe hapësirën.

-Keni lindur në Pejë, jeni rritur në Vlorë dhe jeni formuar në Tiranë. Nga skaji në skaj dhe më pas në qendër. Bërthama juaj antropologjike është e formuar me lëndë dhe elementë të trevave të ndryshme shqiptare. Pra një kulture, një karakter dhe bindje të ngjizura për shkak të këtyre zhvendosjeve të herë pas hershme në etapa vendimtare të jetës suaj. A është kjo zanafilla e një universialiteti në profilin tuaj artistik? Si kanë ndikuar këto zhvendosje në formimin tuaj?

Këto tre qytete kanë kushtëzuar natyrën time si njeri e si artist dhe pa dyshim që kanë ndikuar. Linda në një klimë kontinentale. Në Pejë bie shumë dëborë. Në Vlorë kalova fëmijërinë, pranë detit, shijova të gjitha aromat bukuritë e tij, thellësinë, kaltërsinë, mbrëmjet me yje, gjithçka të bukur, që më ka frymëzuar më vonë për motivet e mia. Në Tiranë studiova dhe u formova si artist, në kuptimin profesional. Gjyshi dhe babai kanë qënë nga Gjirokastra. Unë edhe pse nuk kam jetuar asnjë ditë si banor i atjeshëm, veçse në mënyrë artistike, apo ëndërrore, duke luajtur disa role përfshi këtu dhe atë të Çerçiz Topullit. Gjirokastra është një qytet ndër më të bukurit e trevave shqiptare. Nga koha në kohë njeriu përfton përvoja emocionale nga më të ndryshmet dhe çfarë mbetet është ajo çfarë kujtesa e ruan me fanatizëm. Në jetën time, ka mbetur gjeografia e Pejës. Pas viteve '90 kam shkuar atje disa herë dhe kam përjetuar emocionet e hershme të atyre viteve, pra për aq sa jetova deri në moshën tetë vjeçare, dhe më kanë mbetur gjithë ato kujtime, që njeriu i përfton në fëmijëri dhe nuk i harron kurrë. Në Vlorë siç e fola më lart, kurse Tirana pastaj i zgjeroi hapësirat. Qyteti i katërt ku kam jetuar gjatë është Los Angelesi, ku u vendosëm në vitin '97 deri në vitin 2004; atje sot jeton ime bije, Linda me familjen e saj, qytet të cilin e vizitoj shpesh. Edhe Los Angelesi ndikoi, në një sens, sepse për artistin gjithmonë vlejnë lëvizjet e mëdha, ridimensionimet. Kam shkruar për Pejën një poezi në librin tim të parë, kam shkruar për Vlorën por në poemat e mija unë shkruaj për Parisin ku kam jetuar në kohë të ndryshme, dhe siç duket këto largësi më janë imponuar në një sens. Do doja të kisha shkruar një poemë për Tiranën a për Pejën por ja që nuk ka ndodhur. Ndonjëherë gjërat kanë fatin e vet, ndodhin ose nuk ndodhin.

-Jeni amalgamë e madhështisë me modestinë. E para e formësuar nga Timo artist, dhe e dyta nga Timo njeri dhe karakter. Si ja keni dalë t'i ndërlidhni bashkë dhe t'i përshfaqni në mënyrë strikte në momente të caktuara këto dy cilësi të rralla tek një personalitet i përmasave tuaja?

Nuk di ta dalloj këtë gjë, ndoshta kjo është një veti thjesht personale. Sigurisht e kam prirjen vetjake t'i respektoj të tjerët dhe të jem reflektiv ndaj punës që bëj. Mbase kjo është një arsye që më mban në fre, që të mos ndihem delir, gjë që e them tek "Rob i manive" ku e vendos veten midis dy skajeve, ndjesisë së madhështisë e thënë në thonjëza dhe asaj të inferioritetit sepse artisti ka up-set dhe down-set, pra ngritje dhe ulje. Asnjë artist sado i madh, sado narcizist të jetë, sado egocentrist në momentet kur është me veten i di avantazhet dhe disavantazhet e veta. Ndonjëherë mungesa e modestisë është formë e inferioritetit dhe unë në një farë mënyrë i jam kundërvënë këtij lloj inferioriteti, duke e parë në mënyrë racionale. Kam njohur shumë artistë të mëdhenj, aktorë të mëdhenj, dhe jo rrallë herë jam befasuar me modestinë dhe thjeshtësinë e tyre. E keqja siç duket qëndroka tek ndjesia e vogëlsisë. Nuk e quaj si virtyt tek unë aspak, por si diçka krejt normale. Kurse për artin na gjykojnë të tjerët pavarësisht asaj se çfarë mendojmë ne për veten tonë.

-Keni frymëzuar breza të shumtë artistësh drejpërdrejtë me artin tuaj e gjithashtu keni formuar në mënyre akademike breza të shumtë studentësh Jeni ndër aktorët më të mëdhenj që ka pasur dhe ka ky vend dhe përtej kësaj në kompleks jeni një figurë që publiku e sheh rrallë në televizion apo mediume të tjera. Në një kohe kur kultura , arti dhe kryesisht media kanë më së shumti nevojë për figura si ju, keni zgjedhur daljet e pakta. Eshtë një tërheqje me vetëdije si formë mos-përfshirje apo mendon se ndikimi i artistit varet nga ajo çfarë transeton dhe shpërndan, nëpërmjet veprës dhe mesazheve të saj dhe jo në daljet dhe ligjërimet e drejpërdrejta?

Mendoj se një artist e ka për obligim të shprehet në momente të caktuara, në jetën shoqërore dhe lëvizjet, ndryshimet dhe krizat që mund të pësojë shoqëria, sepse artisti është një person public, një model në sytë e njerëzve dhe ka impaktin e vet në shoqëri. Në rastin tim jo se u shmangem daljeve në ekran por kanalet televizive janë aq të shumtë sa humb edhe sensi i daljes shpesh në këto programe. Shkruaj në shtyp e shfaqem në television me raste, kur kam një arsye për tu shprehur siç ka ndodhur, për sa më takon të shprehem si artist, misioni i parë i të cilit është arti, roli në rastin tim si aktor dhe, më pas ai civil sigurisht. Në çdo rast kur e kam menduar të arsyeshme të dal në televizion, kam dalë si në për premierat e teatrit, të filmit, qoftë dhe kjo intervistë që po bëjmë bashkë ka si objekt librin, si arsye për të dale dhe jo për të mbushur hapësirën në ekranet e televizioneve. Edhe gazetarët që kërkojnë intervista, falë simpatisë që kanë ata për figurën e artisitit, më vjen keq kur i lëndoj ndonjëherë duke u thënë që nuk do ta bëjmë



intervistën ose do ta shtyjmë për një herë tjetër. Edhe unë e kam të vështirë t'ua kthej fjalën por detyrohem dhe ata më mirëkuptojnë. Sa i përket brezave, artisti është frymëzues, siç kam unë që në fillesën time, që kur ëndërrova dhe mendova të bëhësha aktor. Unë nuk kisha ndonjë besim kushedi se mund të bëhesha aktor por ndonjëherë ndodhin rastësitë, pse jo mrekullitë, që kthehen në "destin" në jetën e njeriut, si pranimi im në shkollën e aktrimit. Kam kërkuar letërsi por nuk me doli, e kam dashur shumë letërsinë, e kam adhuruar madje. Kam lexuar shumë libra; në fëmijëri shkruaja poezi dhe periudhën e plazhit në Vlorë, kohën me shokët dhe detin e ndaja me të shkruarit dhe kjo më jepte frymëzim dhe kënaqësi. Mendoj se ishte mirë që s'më doli për letërsi sepse do të kisha qënë një mësues gjuhe ose një autor i niveleve mesatare e thënë kjo jashtë modestisë. Gjykoj se jo se më mungon aftësia për të vështruar në emocionet njerëzore por këtu hyn dhe arti i aktorit, ku ndihem më mirë. Mbase kjo është arsyeja pse poezitë e mia konkretizohen në imazhe, figura sa herë të perceptueshme dhe pse jo të rëndomta, por jo hermetike. S'e kam per zemër poezinë që ia kalon shfaqjes në sy më shumë se ajsbergu, që shumë më tepër fshihet se ç'duhet. Një zhytje e skajshme e mbyt poezinë. Te Kadareja poezia ka transparencë të jashtëzakonshme.

- Në periudhen post komuniste, arti rendi drejt subjekteve dhe tematikave të komunzimit por tashmë parë dhe gjykuar nga një sfond disident. Në këtë mori veprash letrare, skenike dhe figurative të cilat disi e tejkaluan hapësiren e vlefshme që i rezervohet një gjykimi të shëndoshë dhe objektiv të asaj periudhe të errët, ka një portret dhe një sfond të paharruar për publikun; Agroni, i cili pas rënies së sistemit, i sapodalë nga një burg politik, takon persekutorin e tij dhe nëpërmjet lojes brilante aktoriale, na jep krejt panoramën e një metamorfoze makabre të marrëdhënieve të post sistemit. Fjala është për rolin ëmblematik te filmi "Vdekja e kalit" me regji të Saimir Kumbaros. Për publikun, është pika kulmore e një aktori shqiptar por dihet se jo gjithmonë aktori dhe publiku kanë të njëjtën qasje. Po për Timon çfare përfaqeson ai rol dhe ai mesazh qe dha ai film, parë nga gjykimi yt i brendshëm?

Vdekja e kalit bëri histori si filmi i parë në periudhën postkomuniste dhe filmi i parë antikomunist. Skenari i shkruar nga Nexhati Tafa, ishte interesant, dramatik. Regjisori Saimir Kumbaro më thotë, shiko, është një rol që do të pëlqejë, e di sa të shkon Timo. I them që do ta lexoj dhe vetëm pasi mbarova leximin i thashë vetes, uroj që Saimiri mos të ndërrojë mendje dhe t'ia japë dikujt tjetër këtë rol. Gjatë bisedës më pas ku i shpreha përshtypjet për skenarin dhe u vendos që rolin do e luaja unë, erdhi Niko Kanxheri dhe u bëmë një ekip shumë i mirë. Më pas dhe Fitim Makashi, Rajmonda Bulku që i dhanë një dimension të madh këtij filmi. Filmit kurrë nuk i dihet. Filmi është një enigmë. Kur kemi bërë Lulëkuqet mbi mure me Agim Qirjaqin kemi thënë, ç'është ky film për fëmijë, dhe nuk e dinim fundin. Ndonjëhre nisesh për diçka të madhe dhe nuk del në nivelin artistik që janë pritshmëritë. Ndërsa Vdekja e kalit u kthye në një sukses imediat gjë që më ka ndodhur në pak raste, si dhe te shfaqja "Pamje nga ura" në teatër. Rëndësi të dorës së parë ka skenari. Kur e pyetën Hitchcook-un se cili është komponenti kryesor në një film, ai tha skenari. Po pastaj i thanë? Skenari. Po pastaj? Sërish skenari tha. Ai ishte gjeni i kinemasë sepse roli behët kur ka skenar të mirë, kur ka dramacitet. Mendoni ti heqim Agronit momentet në burg apo ti heqësh finalen, pra këto janë momentet më dramatike, me peshë emocionale në film, që e lartësojnë lojën aktoriale dhe e anasjelltas. Pa recitimin e mësuesit të vargjeve të Nolit, te filmi Lulëkuqet mbi mure, pra nuk mbetet asgjë. Aktorët shqiptarë ndihen në pozitë të vështirë krijuese me role të dobët në skenar, imagjinoni se sa mundësi dramaturgjike u krijohen aktorëve të mëdhenj në botë, si De Niro, Al Paçino, etj., në rolet e tyre me situata e ndodhi të jashtzakonshme… Mua, (si dhe kolegëve të mij), më ka ndodhur që në role ku mund të jem munduar e investuar sa s'ka nuk e kam pasur suksesin e atyre roleve ku dramaturgjia më ka favorizuar. Agronin, sigurisht, e pëlqeva, drama e tij ishte ajo që duhej dhe në një sens ishte një homazh për të gjithë ato njerëz që vuajtën dhe u sakatuan nëpër burgjet e diktaturës komuniste. Drama e Agronit ishte në një kuptim drama e shumë shqiptarëve, një fatalitet masiv. Nëse nuk e kishe të dënuarin në familje e hasje të komshiu, në mos aty e kishe në shkallë, në lagje a diku më tej, veç faktit se të gjithë shqiptarët nën diktaturë jetonin një izolim të skajshëm e privim të lirisë, si dënim kolektiv. Ky realitet dhe ky dramaticizëm kushtëzoi suksesin e këtij filmi dhe të rolit të Agronit si personazh. Vdekja e kalit mund të mos jetë një film i përkryer nga ana teknike, por nga ana emocionale është tronditës në çdo dimension. Në rastet kur kemi shkuar me regjisorin në festival edhe jashtë, njerëzit e kanë ndjerë këtë lloj emocioni dhe dilnin nga kinemaja të tronditur.

-Staturë serioze. E qeshur me zemër dhe ndryshime të befta mimike. Mandej portret i zymtë, ecje e ngadaltë, por biseda të vrullshme dhe zë kumbues. Po rrekem të bëj një analizë



antropologjike të figures suaj dhe më rezulton në tërësi një figure fisnike, një njeri i përulur dhe një artist i madh. Ky është Timo në lupën e një admiruesi, pra Timo që njohim në publik. Pyetja që pason është: Kush është Timo në errësiren e studios ku shkruan? A ka shndërrime të forta të qënies (shndërrime të brendshme sigurisht) apo nuk ekziston në juve metamorfoza e artistit në çaste vetmie krijuese dhe artistit në publik?

Po e nis me profesionin tim. Arti i aktorit është arti i transformimit, ndërkohë po e lidh me pyetjen e pare, që më bërë për natyrën time të ndryshme. Aktori nuk luan veten por karakterin e personazhit, dhe unë e kam për detyrë të ndryshoj nga njëri rol në tjetrin jo për efekt kapriçioje por për shkak të përmbajtjes së tyre, transormohem në një person që s'është vetja. Transformimi është artistik, një konvencion pra nuk mund të ndodhë kurrë që ti të transformohesh në rol dhe të harrosh se kush je në të vërtetë përndryshe arti do të kthehej në patologji. Edhe në dramat më të mëdha qoftë në teatër qoftë në film, krijimi artistik mbetet i tillë, një shkrirje artistike jo patologjike me rolin. Siç thotë |Aristoteli, arti është imitim. Ndërsa në procesin e punës me poezinë, gjërat lëvizin dhe besoj se asnjë gjë s'mund të jetë një frymëzim motamo marrë nga realiteti kur ti Liridon je vetë shkrimtar poet, krijues, tregimtar dhe e kupton këtë proces. Merr ngacmime nga një realitet, figurë, fjali, shprehje, nga një fenomen apo një përjetim i caktuar që të çon tek ngjizja e një ideje për ta krijuar si poezi, një mesazh filozofik dhe emocional në vargje. Një poezi mund të jetë katër vargje por duhet të percjellë një varg-ide pa të cilin nuk do të shkruhej poezia, siç lexova së fundi në librin me poezi "Prilli hidhur", "Dy Zogj", të Bardhyl Londos:

"Dy zogj ndjekin njëri-tjetrin në qiellin e përvëluar nga etja.

Njëri është jeta, tjetri është vdekja…"

Poezia nuk kërkon mundin e prozës, që është një mund i madh. Poezia si process është më pak e mundimshme dhe pse jo më e lehtë për të qenë e arrirë. Të vjen një varg e shkruan, pastaj i shton një tjetër pra është më "kapriçioze", pa shumë e shumë faqe si romani, koncentrike. Veçse, nëqoftë se je i zoti ta krijosh e kryen, se mund të rrish me vite dhe të mos mundesh ngase lypset talent, sigurisht. E adhuroj poezinë, dhe pse e them shpesh që nuk jam poet por adhurues i poezisë, jo për mungesë modestie apo se për atë që botoj nuk jam pretencioz dhe pse vetë pandeh se ky libër që sapo kam botuar, në mos i gjithi, të paktën 50 përqind a ca më pak ia vlen besoj, se s'mund të kapen aq lehtë majat. Momenti im privat është një moment hulumtues, frymëzues.

-Disa nga njerëzit që ju kanë njohur, janë shprehur se larg Timos aktor, njohim një filozof dhe një poet thellësisht mendimtar. A keni menduar ta bashkoni artin e fjalës me atë skenik në një produkt 100 perqind tuajin?

Më llaston fakti që më shohin si filozof (!), dhe pse nuk e kam menduar këtë gjë. Poezia është një art që përcjell mendime të thella, metafora, simbole, maksima të cilat ndonjëherë mbeten për gjithe jetën në mendjen e lexuesit. Synoj të vështroj në thellësi, kur atje më çon frymëzimi dhe i ndjell a më shfaqen figurat dhe mendimet. Tërhiqem pas esenciales, që ka një arsye për t'u trajtuar, kur ka një dramë, kontraste dhe, ndoshta, shfaqja e kontrasteve u jep dhe thellësinë atyre që unë shkruaj. E kam dashur poezinë, e kam recituar. Më pëlqejnë poetët si Majakovski. Poema të tilla si "Re me pantollona" , "Flauti i shtyllës kurrizore", të cilat janë dëshmi të një arti të madh, çdo kohë e kanë fuqinë e tyre. Sigurisht jam ndikuar dhe nga leximi i poetëve të mëdhenj që nga Whitman-i, Neruda, Ricosi, Seferis e deri tek Kadareja e Agolli. Jetojmë në një botë informacioni të rrufeshëm. Edhe pse për fat të keq sot lexohet më pak, dhe nëse nuk shkon i riu te libri, atij i ofrohet mundësia që me një klikim në google të gjejë Letrën e Tatjanës drejtuar Onjeginit, të Pushkinit. Apo një poezi të përkorë si "Kristal" të Kadaresë, e cila është e brishtë e si një kristal për dashurinë në vetvete. Sot është dinamizuar çdo gjë dhe ke mundësinë të lexosh dhe të kërkosh. Përsa i përket idesë për një produkt timin kohët e fundit realizuam një koncert poetik me Ndriçim Xhepën dhe Eva Alikajn. Shkoi mjaft mirë. Kam menduar që një pjesë të poezive të mija ti recitoj. Nuk kam dashur deri tani se janë të mijat dhe ngre krye ajo sindroma e modestisë. Por një ditë do të dal me një program poezish të mijat siç e kam bërë Majin e shkuar te E diela shqiptare, te Ardit Gjebrea ku recitova një pjesë të poezive të mija dhe teksteve që kam shkruar. Aty recitova dhe poezinë për Covid-19 "Në emër të jetës" që është përfshirë në këtë libër. Ndërsa për skenar nuk kam menduar dhe pse mund të shkruaj nga përvoja e filmit prozë. Si profesor i aktrimit për shumë vite e njoh dramaturgjinë. Kam përkthyer drama dhe biografi. Por, nuk e di pse mbase kam mbetur "fanatik" në një sens, duke menduar se si aktor më tërheq servirja e "pjatës" më të përzgjedhur nga skenaristi profesionist. Nuk ka ndodhur të shkruaj skenar. Mbase është vonë të shkruaj një skenar, mbase jo, kurrë s'duhet thënë kurrë.

-Në poezite tuaja vërehet një raport i ndërlikuar me jetën e përtejme dhe portën e kalimit nëpermjet vdekjes. Hera herës ngjan sikur kërkoni të bindni dikë se ka jetë përtej dhe here-herë jepni imazhin e njeriut të pasigurtë ku përtej bindjes së të tjerëve, kërkon të bindë veten, t'ia heqë frikerat vetes. Cili është

këndvështrimi juaj mbi këtë raport jetë- vdekje dhe cili është definicioni juaj për këtë proces? A i trembeni formës me të cilën vdekja vjen apo thjesht e perceptoni si kapërcim në një tjetër dimension?

Jam i pasigurtë për veten. Ky është një mister që jo unë po askush nuk e ka zgjidhur ende. Nuk ka ardhur asnjë dëshmitar nga ajo botë që të na tregojë sesi është. Kam bërë një përkthim të librit "Shpirti" nga një psikiatër amerikan Brajan Waiss që shkruan mbi rimishërimin, pra kthimin e shpirtit në trupa të tjerë, libër i cili ka tërhequr vëmendjen. E përktheva për mesazhin që përcillte, se ishte libër që mund t'i fashitte ndjenjat tek njerëzit që humbasin dikë të shtrenjtë, apo të atyre në gjëndje krize për shkak të sëmundjeve të rënda, pra një libër që jepte shpresë. Në poezitë e mija ka disa dimensione, ku jeta, vdekja, dashuria, shtegtimi… shfaqjet a përleshja mes tyre, janë të gjitha përpjekje për ta sfiduar përkohësinë. Tek e fundit nuk di t'i jap një definicion vdekjes. Di që vdekja është një proces natyral i vijëmësisë së jetës, një transformim siç e thotë Stephen Hawking, vërtetë Zot nuk ka por ka energji dhe ne transformohemi nga kjo qënie dhe bëhemi pjesë e universit në formë të grimcëzuar, si pluhur. Por ama jemi pjesë e këtij universi. Kjo nuk është pak. A e dija unë para se të lindja se çfarë ndodhte në shekujt e shkuar, qysh nga krijimi i jetës?! Kush e di vallë apo e ka ditur veçse kur erdhi në këtë botë…?! Duke jetuar, ne jetojmë dhe të shkuarën me ndiesinë si të kishim lindur që në vitin zero deri në pafundësi. Thjesht momenti tani që po flasim në të dy iku, mbaroi është momenti më i gjatë i botës që nga krijimi i saj, kështu që fenomeni i jetës dhe i vdekjes duhet parë në mënyrë të relativizuar. Dikush thotë që jeta është një skutë në oqeanin e pafundësisë. Në idenë time vdekjen e gjykoj si një jetë tjetër, duke pranuar enigmën se ç'mund të jetë pas që askush s'e di. Besoj në fuqinë dhe misterin e krijimit të kësaj bote. Jam Hegelian në bindje dhe them që këtë botë e ka nisur diçka. Nuk jam besimtar motamo dhe pse i kam zili besimtarët që janë të shpëtuar dhe kanë parë me sytë e tyre një paqe të cilën ai që nuk beson nuk e ka. Është i bekuar ai që kthehet në besimtar dhe që beson në jetën e përtejme. Krishti është figura që unë adhuroj por e adhuroj në një sens artistik përtej besimit. Kam shkruar një poezi për Krishtlindjet dhe e kam recituar në një edicion organizuar për lindjen e Krishtit dhe aty e trajtoj pak a shume këtë. Shën Pali thotë se fuqia përsoset në dobësi. Le ta marrim dobësinë njerëzore dhe përkohësinë e jetës si një dobësi, ku fuqia jonë formohet në të. Nuk mund të jap një definicion final dhe pse është një temë që nuk mund t'i shmangesh, është krahas jetës dhe dashurisë, një trinom.

-"Mjerë kush ia shpërfill fuqinë të pambrojturit" ky është një varg-maksimë, shkëputur nga poezia "Në emër të jetës" një poezi që shfaq krejt frikën dhe trishtimin e kohëve jo të zakonta pandemike. Një himn për njeriun, që kapërcen çdo pengesë. Njeriu i zakonshëm që përtej mundimeve të kësaj ekzistence, nuk epohet, nuk bie, nuk dorëzohet. A keni ndjerë këto kohë njëfare apokalipsi të ngadaltë dhe të dhimbshëm të njerëzimit? A e menduat fundin si destin (fundin kolektiv të njerëzimit) kur gjithçka ishte ende në fillim, e panjohur dhe ne, të gjithë sëbashku, të pambrojtur?

Covid-19 është një fatalitet dhe katastrofë për njerëzimin por natyra e njeriut është e tillë që adoptohet me gjithçka. Siç pranojmë idenë që një ditë nuk do të jemi më, përndryshe po nuk e pranuam i bie të bëjmë vetëvrasje kolektive. Jemi mësuar të bashkëjetojmë duke e parë njeriun e afërt, mikun, shokun, të afërmin, mjekun që bën sakrificën më supreme, njeriun e shquar, njeriun e zakonshëm të iki nga kjo botë brenda një kohe krejt të shkurtër. Si një llotari e zezë që i bie njeriut për t'ia marrë jetën. E shkrova poezinë "Në emër të jetës" për programin e Ardit Gjebreas ku u ftova të bëja një homazh. Ndodhi që pas disa muajsh e kalova dhe vetë Covidin por lehtë, me ankth, sigurisht e bezdi, apati e dobësi. Thjesht mendimi dhe pasiguria në vete gjatë atyre ditëve, si një sëmundje tinzare ishte një ekuacion me shumë të panjohura, një luftë me një armik të padukshëm që të vret në mënyrë të pabesë. Fatlum kush e kalon. Mund edhe të mos isha. Shtetet e mëdha janë izoluar, përkundër ne shqiptarëve ku ngjan sikur jeta vlen më pak se gjithçka. Duhet të ndjekim rregullat dhe të besojmë se kur vjen e keqja është tepër vonë. Me këtë rast i bëj një homazh jetëve që janë shuar, dhe pse poezia titullohet "Në emër të jetës" dhe në një varg shprehem se "... me miliona e miliona jetë sikur të marrësh, nuk mund ta shuash kurrë njerëzimin". Covid 19 më lidh dhe më një moment tragjik, humbjen e një miku dhe skulptori të madh Arben Bajo, i cili pesë ditë para se të vdiste punonte në studio portretin tim, dhe tani, pas ikjes tragjike të tij, e kam derdhur në bronz si një kujtim të përjetshëm. Arben Bajon e kam njohur prej vitesh. Ishte pedagog në Akademinë Arteve. Nuk jam shprehur deri këtë çast pas humbjes së tij. Vdekja e tij tragjike më ra rëndë si plumb. Iku për më pak se dy javë… e paimagjinueshme. Nje skulptor i madh. Një Roden shqiptar për nga finesa, fuqia e shprehjes, karakteret që ai ka krijuar në artin e tij. Jetoi shume pak, 52 vjeç. Mendo se sa kohë do të kishte. Ishte në lartësinë e artit të skulptorëve më të mëdhenj shqiptarë që nga Paskali, Paço etj. Me aq sa e kuptoj unë artin figurativ mund të ishte po të jetonte, skulptori më i madh shqiptar i të gjitha kohërave. Humba një mik të vërtetë. Kishte njohje më të madhe se unë për kinemanë. Më befasonte me emrat e aktorëve, të regjisorëve, me librat që lexonte. Ishte një figurë poliedrike, një djalë i rrallë dhe një shpirt i butë e i pakrahasueshëm. Perkulem me nderim përpara madheshtisë së tij!

-Poezia juaj "Shkallë për në qiell" është një dyzim ku ndërthuren dy botë në kohë dhe hapësire krejtesisht të ndryshme të cilat bashkohen në një pike: kotësinë . Hapësira thuajse pa asnjë qëllim, që nuk të shpien askund pra një dimension bosh, në te shkuaren dhe në të ardhmen. . Jeni natyrë pesimiste apo nje realist që zgjedh ta ballafaqojë shpirtin me të vërtetat e dhimbshme pa tragjizma?

Poezia "Shkallë për qiell" është një nga poezitë e mija më të dashura. Edhe pse në poema unë e trajtoj hapësirën gjithmonë, shtegëtimi është një element që verëhet. Kërcimi në bosh është kërcim në hapësirë dhe në pafundësi, ajo që thoni ju por jo kotësia në kuptimin e vanitetit të rëndomtë. Për këtë poezi kam pasur një ngacmim nga monologu i pashait turk që ngjitet në shkallare tek romani "Kështjella" të Kadaresë; asnjëherë s'e di se ku të çojnë përfytyrimet... Ai monolog ma solli në veshtrim idenë e shkalleve. Kur shkrova poemën "Natë në Monparnas" në një moment më bënte digresion pra një lloj retrospektive poema "Llora" e Kadaresë. Si nje gjeni Kadareja është një hapësirë ndikimi të cilës nuk mund t'i shpëtosh. "S'ka fillim as fund ky bosht, nis e sos kur ta mendosh". Hapësira dhe koha kudo që të vendosesh janë njësoj të pafundme dhe, ti qëndron qëndron në mes të tyre nga shkaku i pafundësisë.

-"Sa herë i marr erë një luleje, druaj se pas shpine , thika më ngulet" Ky varg i shkëputur nga poezia "Rob i manive" vërteton atë çka keni shprehur në një dalje publike ku thoni se - : "Poezitë janë vizione të errëta që i pershfaqen poetit si kumt për njerëzimin" Parë nga situata globale qoftë si reflektim fizik por dhe shpirtëror, cila është frika juaj e madhe?

Errësira si ngjyrë pra e zeza është pjesë e natës dhe kontrastit me ditën. Ashtu është dhe ndjenja e errët në shpirtin e njeriut përkundër dritës që merr nga jeta dhe përditshmëria. Janë forca që lidhen me instinktet po të hymë në psikoanalizë. Në atë që ti ndonjëherë nuk e kupton pra janë reflekse të vetëmbrojtjes. Ky varg tani që po e analizojmë e kam menduar në atë kontrastin që në momentin tënd më të lumtur, e keqja mund të të godasë. Një formë paranoje apo ndjesie persekucioni. Duhet marrë në kompleksin e poezisë. Nuk mund të përjashtohet nga artisti ky lloj asosacioni i vazhdueshëm i një bote që vjen në mënyrë jo koshiente nëpërmjet errësirës dhe mendimit me ngarkesë negative. Nuk jam pesimist dhe nuk e shoh botën me dylbitë e kthyera mbrapsht por jam objektiv. Nuk jam as optimist, i pranoj të kundërtat. Ndonjëherë duke synuar të përsosurën bën gabim të shumëfishtë sepse së pari vërteton se nuk je i përsosur dhe e dyta kupton se ajo nuk mbërrihet kurrë. Në një fragment filmi kam parë ku një personazh i thotë një tjetri: Nëse kërkon përsosjen do çmendesh. Davidi i Mikelanxhelos, edhe pse në skaj të përsosjes, ndoshta, edhe pse i përsosur; përjashtimi fuqizon rregullin. Jam i ndjeshëm mbasë më shumë se të tjerët në një sens sepse jam në hullinë e poezisë dhe botës artistike krijuese por me vetitë e çdo njeriu në mënyrë të ndërsjelltë.

-Vargjet tuaja janë udhetime, përjetime nëpër kryeqytete botërore (Nju York, Paris, Vjenë) që kanë lënë gjurmë tek ju. Gjithashtu janë homazhe për figura të rëndësishme të artit botëror si Ajnshtajn, Van Gogh, Xhim Morrison. Kam një pyetje paksa intime. Si do të ishte një poezi dedikuar Timos në një qytet si Tirana. Pra një dedikim për një artist të madh që jeton dhe frymon po ashtu në një qytet të madh?

Më vjen keq dhe ndihem madje paksa xheloz se kam shkruar për Vienën dhe Parisin dhe s'kam shkruar për Tiranën. Ndonjëherë gjërat nuk dihen se si vijnë, mbase nga befasia kur has në një botë të re që nuk e ke njohur më parë. Mbresa dhe impresione të para që e trandin njeriun, kaotizmi herë herë, kontrastet, dramacitetet. Qoftë dhe madhështia apo bukuria e gjërave. Kur kam parë Parisin jam mahnitur dhe më pas dashuruar me të. Ai ma solli në mënyrë të natyrshme për të poemën programatike "Natë në Montparnasse". Sot zakonisht nuk shkruhen më poema dhe mua më vjen keq për këtë. Duhet të kthehet ajo kohë dhe ato vite kur shkruheshin poema pasi publiku e do poezinë dhe e ndjek me interes. Mbase nuk e lexon dhe aq por e dëgjon dhe e admiron kur është e recituar. Pra edhe poemën "Natë në Montparnasse" të cilën besoj se lexuesi serioz mund ta lexojë me dëshirë. Do doja të lexoheshin pasi aty mund të të them vërtetë se jam pretendues. Nëse nuk do të ishin poemat, mund të them se nuk do kisha botuar asnjë poezi. Për veten nuk kam menduar kurrë të bëj një poezi edhe pse në çdo poezi timen jam unë pra që flas në vetën e parë. Mbase në poemën "Përtej jetës" që është më filozofike se të tjerat, qoftë dhe te "Takim me të dashurën Mari…" unë jam vetja por i zhvendosur në botë të tjera, iki dhe kthehem, jam dhe s'jam. Kurse te "Përtej jetës" ngjan si një kalvar, është jeta biologjike por edhe e njeriut e artistit në kohëra, edhe them që mire do qe të ishte një poemë për Tiranën por siç e thamë gjërat nuk komandohen. Varet se si të vinë.

-. Dhjetëra role kinematografike, dhjetëra role në teatër, tre vepra poetike, keni marrë dhe rolin e përkthyesit nga letërisa e huaj . Jeta juaj artistike shumëdimensionale është një frymëzim për brezat e rinj. Pas kaq vitesh ndërtimi të ketij panteoni të rrallë vlerash artistike dhe njerëzore, a keni ju ende një një peng?

Artisti ngaherë synon dhe kur synon dhe ëndërron do të thotë që ka diçka që e dëshiron. Mund ta quajmë peng mund ta quajmë dëshirë pse jo edhe pse ndonjë peng të adresuar nuk kam. Pengu i madh nëse mund ta them janë vitet kur humbi kinemaja këtu dhe nuk pati produktivitet dhe vlera dramaturgjike. Humbi kinemaja, u shua në moshën e pjekurisë profesionale më të epërt, ku priten vepra të mëdha. I shikojmë filmat amerikanë ku kinemaja është industri, levizjet e aktorit nga roli në rol pa bërë ndonjë shenjë barazimi dhe krahasimi ata luajnë deri në shuarje të jetës. Ndërsa ne na u shua arti përpara se të mbarojë jeta. Kam bërë role por jo në kontiuinitet por sa shumë do ishin rolet e mija dhe të kolegëve të mi nëse do funksiononte me prodhimtari kinemaja. Për fat, edhe pse me pak filma në numër në vite në tranzicionin e tejzgjatur, kinemaja nuk është shuar krejt, sepse janë bërë disa filma të suksesshëm. Kjo më ka bërë ti afrohem teatrit më shumë. U ktheva nga Amerika e cila, pa odiseun e së ciles, nuk do kisha shkruar poezi, madje as nuk do të kisha luajtur role në teatër pasi unë isha pedagog dhe aktor kinemaje. Por Amerika t'i zmadhon hapësirat, te përgatit mentalisht, të ridimensionon kurajon për të provuar dhe guxuar. Dhe nuk pata një paradigmë kur erdha dhe mendova se nuk ka film, ok, do luaj teatër. Dhe e nisa me "Një stinë e mërzitshme në Olimp" të Kadaresë. Një diskurs që e vuri regjisori Gëzim Kame në skenë në vitin 2003. Pastaj bëmë një projekt tjetër me Ndriçim Xhepën "Për një fjalë goje" të Natali Saro, autore e romanit modern, me regjisor të Arben Kumbaros. "Pamje nga ura" të Arthur Miler, me regjisor Albert Minga që ishte një sukses i madh. Vazhdova me "Shtrigat e Salemit" me regji të Spiro Dunit. Edhe ky një sukses dhe para dy vitesh me Equus-in nën regjinë e boshnjakut Dino Mustafiç. Kështu që iu dhashë teatrit sepse doja të plotësoja atë hapësirën bosh. Hapësirën e qiellit që I takoj, teatrit…

Padyshim që çmimet e Akademisë "KULT", janë vlerësimi më serioz që akordon një institucion privat shqiptar, duke dhënë një ndihmesë të çmuar në evidentimin e arritjeve kulturore dhe artistike gjatë një viti.

Në edicionin e saj të XVI, kjo Akademi e themeluar dhe drejtuar nga një biznesmen si zoti YLLI SULA, i cili si rrallëkush nga bota e biznesit në Shqipëri ka investuar në vite për kulturën dhe artin, në pamundësi të organizimit të mbrëmjes së madhe kulturore të ndarjes së çmimeve, shpalljen e të nominuarve dhe të fituesve e bëri nëpërmjet faqes online të Akademisë Kult, revistës InfoKult, rrjeteve sociale dhe të gjitha mediave të tjera informative.

Juria e Nderit, e përbërë prej 184 anëtarësh ka bërë përzgjedhjen për fituesit e këtij viti. Këtë vit pjesë e Çmimeve "KULT" ishin 11 kategori arti.

MINISTRIA E KULTURËS E NDEROI ME ÇMIMIN **"AUTORI I VITIT 2020"** PËR ROMANIN **"DIKTATORI NË KRYQ"**, AKADEMIA KULT ME ÇMIMIN **"PËRKTHYESI I VITIT 2020"** PËR ROMANIN **"NJËQIND VJET VETMI"** TË G. G. MARQUEZ

Trofeu i dytë i Mira Meksit

POR FITUESI I VËRTETË ËSHTË LEXUESI SHQIPTAR I CILI TANI MUND TA LEXOJË TANI KRYEVEPRËN E LETËRSISË BOTËRORE "NJËQIND VJET VETMI" TË PËRKTHYER PËR HERË TË PARË NGA ORIGJINALI

Këta janë fituesit për secilën prej kategorive:

KËNGA E VITIT:
Marsela Çibukaj – "Thërrime Dashurie"

INTERPRETUESI LIRIK I VITIT:
Ivana Hoxha – Azucena tek opera "Trovatore"

BALERINI/A I/E VITIT:
Lori Bala dhe Rovena Shqevi – Baleti "Annunciation" nga Angjelin Preljocaj

INSTRUMENTISTI I VITIT:
Klajdi Sahatçi – Violinë, Mendelson & Brams, Koncert me Orkestrën Simfonike të RTSH

AKTORJA E VITIT:
Ema Andrea – Ljubov Andrejevna tek "Kopshti i Qershive"

AKTORI I VITIT:
Indrit Çobani – Belize' tek "Engjëjt e Amerikës"

REGJIA E VITIT:
Arben Kumbaro – "Engjëjt e Amerikës"

LIBRI ARTISTIK I VITIT:
Tom Kuka – Me Romanin "Ora e Ligë"

LIBRI STUDIMOR I VITIT:
Artan Fuga – "Shoqëria Piramidale"

PËRKTHIMI I VITIT:
Mira Meksi – "100 Vjet Vetmi" të Gabriel Garcia Markez

ARTISTI PAMOR I VITIT:
Gazmend Leka – Pikturë, Ekspozita "Dhoma e Hapave të Humbur"



NJË PROZË E PANJOHUR E FAIK KONICËS "Mendimet e Filopimin Trukuleskut"

nga Sevdai Kastrati

Poligloti dhe eruditi Faik Konica është, pa dyshim, një prej shkrimtarëve të rrallë në historinë e letërsisë shqipe. Ai është shkrimtar me dhunti të madhe krijuese, ndërsa proza e tij mbetet e veçantë për bukurinë e gjuhës dhe përmbajtjen e saj. Me të drejtë është thënë se Konica është një nga stilistët më të mirë të shqipes. Faik Konica është i veçantë në mënyrën e të shkruarit që e ka përvetësuar duke lexuar letërsinë botërore dhe falë kulturës së gjerë që ka marrë në vendet ku ka studiuar e ku ka jetuar, si në Francë, Belgjikë, Angli, SHBA, Austri, Zvicër, Itali dhe prapë në SHBA, ku vendoset përgjithmonë më 1921.

Faik Konica më 17 gusht 1934 nis botimin e një proze satirike me titullin *Mendimet e Filopimin Trukuleskut* përmbi ca dukje në Shqipërinë e viteve '30. Proza u botua në vazhdime (24 gusht e 14 shtator) dhe, mjerisht, u ndërpre botimi i 'fantasirave letrare' të paralajmëruara nga redaktori i "Diellit". Po ashtu, lexuesve të gazetës u bëhet me dije se autori i 'fantazirave letrare' është një shqiptar i njohur si dhe një mik i Vatrës. Ndërsa pseudonimi 'Haju' siç mund të shihet në vijim, është krijuar sipas përmbajtjes së prozës që në shqip-kucovllahisht është për 'Ay'. Megjithëse në këtë mënyrë mistifikohet autori, prapëseprapë stili dhe gjuha[1] e tij na bëjnë të pohojmë se autori është vetë Faik Konica. Më poshtë do të ndalem në katër burime që na kanë ardhur në ndihmë për të përcaktuar saktë se proza i takon Konicës:

E para, për të mbështetur idenë se autorësia e *Mendimet e Filopimin Trukuleskut* i takon Faik Konicës do të ndalem me dy fjalë përmbi vllehtë. Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, kur shqiptarët filluan të emigrojnë në Amerikë edhe vllehtë u vendosën krahas tyre në lagjet e qyteteve si St. Louis, New York, Bridgeport, Southbridge, Boston etj. Ashtu sikurse kishte ndodhur më parë edhe me arbëreshët tanë që jetonin në ato qytete ku jetonin edhe italianët. Për dallim nga vllehtë, arbëreshët marrin pjesë në jetën kulturore dhe shoqërore të italianëve. E vetmja gazetë e përditshme italiane që botohej në Amerikë *L'Eco d'Italia* (1888-1891) kishte për botues Felice Toccin dhe kryeredaktor Guiseppe Cadicamon. Ky i fundit (kushëriri dhe miku i Jeronim De Radës) themelon më 1891 kolegjin Dante Aligheri në Long Island City të Queens-it (NY)[2]. Ndërsa vllehtë, sipas Konicës, në Amerikë rrinë larg shqiptarëve, bëjnë propagandë kundërshqiptare, në mbledhjet e tyre pranë flamurit amerikan vënë jo flamurin e Shqipërisë, por flamurin e një mbretërie tjetër të Ballkanit[3]. Përsëri, disa vjet më vonë, Faik Konica në veprën postume *Shqipëria – kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, kur flet për vllehtë thotë se "kjo popullsi nuk ka gëzuar një nam të mirë".

Gjatë viteve '30 në gazetën "Dielli" botohen një sërë shkrimesh përmbi vllehtë, duke i akuzuar për armiqësi ndaj shtetit shqiptar. Përkundër mendimeve të tilla, Fan S. Noli mendonte ndryshe. Në një shkrim polemik *Përgjigja jonë për disa kritika dhe këshilla*, të botuar në gazetën "Republika" të Bostonit më 1930, thoshte se "Vlleht' e Shqipërisë janë aqë të pakë dhe aqë të shtypur sa është një shaka të thuhet se kanë lojtur atë roll nefast që u ngarkon Dielli"[4].

E dyta, toponimin *Shkalla e Tujanit*, e hasim te romani i papërfunduar *"Dr. Gjëlpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit"* në tre raste.

E treta, h-ja sipas Konicës është shenjë masonike me anën e së cilës shqiptari njeh shqiptarin. H-në e ndeshim në dy raste, kur Faik Konicës i shkruajnë Koli J. Dallto nga Youngstown i Ohio-s dhe Loni P. Peristeri nga Marlboro i Massachusetts-it.

Letrën e Dalltos e boton më 10 nëntor 1925 në gazetën "Dielli", në rubrikën e tij *Shtylla e Faik Konicës*, të cilën e boton pa i hequr e pa i shtuar gjë. Në mbështetje të tezës sonë po sjellim një fragment të letrës:

Kur qënka hashtu Aere pse si Boton Dhe Letrat e Hanës tjatër që të Barabiten dhe të Provojnë të thënat e Tuha?... ato që thoshe dije hapo këto që Thuha Sot.

Siç mund të shihet ahere bëhet aere, kurse ashtu, apo, anës, thua bëhen hashtu, hapo, hanës, thuha.

Për dallim nga letra e Dalltos, që është e shkruar si shkas e një letre që përgëzohet Konica për vijën politike që mban ndaj Zogut, Peristeri në letrën e tij të shkurtër, e botuar më 12 dhjetor 1925, kërkon nga Faik Konica që të heqë dorë nga djallëzitë dhe të dorëhiqet si kryetar i Vatrës:

"Ne hje hatdhetar, iq dore nga dijallezite... Jep demicien."

Më poshtë po e japim të plotë përgjigjen e Konicës për të vërtetuar hipotezën tonë:

"Hunë hhjam hazër të 'eq dorë, siç më hhjep hhurdhër Qir Peristeris, hhi cili hhe do hhaqë shumë Vatrën sa 'arón që s' hhësht hhas hhanëtar hhi Vatrës. Po hhjam gati me një shart vetëm: që Qir Peristeris të më hhjapë zotimin me të shkrojtur se ka për të nxënë cilat fjalë marin h në gjuhën shqipe, cilat jo".

Sa i përket letrave të mësipërme, nuk mund të dimë nëse janë shkruar apo jo? Sa i besueshëm do të jetë Konica në botimin e tyre, apo letrat janë thjesht fantazi e tij? Në qoftë se e mbajmë parasysh shkrimin *Dokra dhe fantasira*, të botuar në "Dielli" më 22 janar 1925, kur shkruante për një kandidat për ministër që di alfabetin gjer te shkronja s, pa dyshim, mund të dyshojmë se Konica mund të jetë autori i letrave të mësipërme. Në atë shkrim thoshte se: "Kandidaturën e tij e vë me letrë; mirë po duke mos ditur edhe letrat t th u y v x xh z zh, si do t'a shkruaj? Imaginova pra letrën kandidaturë që vazhdon:

"Sodi Kroeminisdër, - Kam nderin dë fë kandiadorën

d'ime për minisdër. Dëshëroj dhe onë dë mar pjesë në kabined, në çfarëdo degë që në qofdë. Jam miafd i didor; alfabedin e kam ncënë gjer de ledra s. Përfeç kësaj, ikij frap dë madh, di dë bie me nod mirë, dhe di dë ngas një anie me modor: ashdu që, po dë bëhed nonjë kroengridje e papridur, jam gadi dë çdukem me një herë. Për këdo arësoe, kam shpresë se kandidadora ime do të meret nër so. Mbedem me nder dë madh, HOP SHTASA."

Në fakt, të dy të lartpërmendurit janë përkrahës të Nolit dhe në shumë raste të tjera ai do t'i quajë kundërshtarët e tij si: grekomanë ose "epiriotë", çobanë dhe maqedhonas që hiqen si "shqipëtarë".

E katërta, Faik Konica është shkrimtari i vetëm në historinë e kulturës shqiptare që ka filluar shumë vepra dhe nuk i ka përfunduar:

- Nga 4 mars 1910 deri më 10 shkurt 1911 Faik Konica kërkon mbështetje nga shqiptarët e Amerikës[5] për botimin e vëllimit "Kondili i kuq", 'një libër i vogël me copa letrare, pralla dhe vjersha: shumica të botuar në revistën "Albania", ca të tjera edhe të pabotuara' që nuk e pa kurrë dritën e botimit.

- Librin "Jeta e Skënder Beut" e boton si nënfletë historike në gazetën "Dielli" nga 8 gusht deri më 17 tetor 1912, gjithsej në nëntë numra. Në botën e studimeve letrare është thënë gabimisht se libri është botuar në njëzetepesë vazhdime në gazetën "Dielli", nga 8 gushti 1912 deri më 17 nëntor 1918. Së pari, është thënë nga Jup Kastrati[6], autori i monografisë mbi jetën dhe veprën e Faik Konicës; së dyti, të njëjtin mendim e merr edhe Nasho Jorgaqi[7], njohës i mirë i trashëgimisë së Konicës dhe, së treti, të njëjtin mendim e ka marrë nga Jup Kastrati edhe Shyqri Galica[8], i cili ka mbrojtur tezën e doktoratës me titull "Faik Konica – eseist dhe kritik letrar" në Universitetin e Tiranës, më 1997.

- Faik Konica më 1 tetor 1913 nis botimin e ca fragmenteve në revistën "Hylli i dritës" të Shkodrës të 'një libri filozofi popullore: shënime dhe mendime mbi jetën e njerëzve'[7] që sipas tij për disa arsye, nuk vazhduan.

- Faik Konica gjatë qëndrimit në Lozanë të Zvicrës më 1915 mban shënime të përditshme mbi ngjarjet dramatike të luftës. Ditari fillon nga 21-25 shtator 1915 dhe nis të botohet në gazetën "Dielli" më 13 dhjetor 1915. Mbas vazhdimit të dytë ditari u ndërpre së botuari.

- Faik Konica më 25 maj 1921 u propozon dy të rinjve, Sotir Noke e Konstantin Demo, botuesit e gazetës "Shkëndija" në Watertown, që të botojnë kujtimet që nga Lufta Ballkanike e deri në ikjen e princ Wied-it nga Durrësi (1912-1914). U bën me dije se libri do të ketë rreth 300 faqe në një formë me "Othellon" e Fan Nolit. U propozon në fillim ta botojnë në gazetën e tyre nga 16 faqe në çdo 15 ditë dhe më pas në formë libri me një tirazh 4000 copë. Ndërsa sa i përket çmimit, po ashtu u propozon $1.50 ose $ 2.00 për copë, ndërsa për vete kërkon 0.50 centë. Po ashtu, Konica bën me dije se pjesën e parë të dorëshkrimit e kishte gati dhe me të pranuar ofertën do ta dërgonte menjëherë në postë. Në mungesë të letërkëmbimit të mëtejshëm, sot për sot nuk jemi në gjendje të dimë se si ka përfunduar dorëshkrimi i këtij libri dhe ku mund të ndodhet?

- Faik Konica më 4 mars 1922 nis botimin në gazetën "Dielli" të prozës satirike Katër pralla nga Zullulandi botohet vetëm e para Një ambasadë e Zulluve në Paris. Dy vjet më vonë, më 8 mars 1924, Konstantin Tashko na bën me dije se Konica është duke përgatitur për botim Katër pralla nga Zullulandi.

- Komedia inédite Mustaqet është shkruar enkas për "Grupi Theatral"[8] nga Faik Konica për ta vënë në skenë të hapur më 9 shtator 1923 në piknikun që do të mbahet "Te ferma e Zikos" në Marlboro.

- Faik Konica më 15 shtator 1923 na bën me dije se prej disa muajsh është duke bërë përpjekje për të shqipëruar komedinë Twelfth Night [Nata e dymbëdhjetë] të Shakespear-it për "Grupin Theatral" të Bostonit. Përsëri, tre vjet më vonë, 15 korrik 1926, gazetarja e Associated Press na bën me dije se Konica tani po përkthen në shqip komedinë Twelfth Night [Nata e dymbëdhjetë] të Shakespear-it dhe bën fjalë për vështirësitë që ka në përkthimin e saj.

- Më 8 mars 1924 K. Tashko na bën me dije se Konica është duke përgatitur për botim romanin Tryeza e fshirë, pra një roman me motiv shoqëror dhe filozofik.

- Veprën Themelet e gjuhës shqipe, me gjasë një përmbledhje me artikuj gjuhësorë e paralajmëron, po ashtu, K. Tashko më 8 mars 1924 në gazetën "Dielli".

- Sipas një shënimi (Dielli, 29 korrik 1924, f. 8) thuhet se romani Dr. Gjëlpëra zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit është shkruar tre muaj më parë[9] dhe falë ndërhyrjes së ca vatranëve Konica do ta botojë në vazhdime në gazetën Dielli. Romani filloi të botohet nga 16 gushti deri më 1 nëntor 1924, gjithsej 21 vazhdime: 6 në dy javët e fundit të gushtit, 9 në shtator, 5 në tetor dhe 1 në nëntor.

Siç mund të shihet romani ka pushuar së dali më 1 nëntor e jo, siç është thënë nga studiuesit e Konicës: nga Qerim Panariti te Nasho Jorgaqi, nga Sabri Hamiti te Jup Kastrati, nga Thanas Gjika te Shyqri Galica, në fund të dhjetorit[10]. Po ashtu, deri më sot është thënë nga studiuesit e Konicës se romani u ndërpre për shkak të ardhjes së regjimit të Ahmet Zogut në fuqi. Nuk do të ndalem në hipotezat e shprehura prej tyre se romani u ndërpre për shkaqe politike, sepse në asnjë rast ata nuk sjellin të dhëna dokumentare bindëse. Një gjë është e sigurt: arsyeja e ndërprerjes së romanit janë konferencat dhe udhëtimet[11] që Faik Konica do të mbajë anekënd kolonive shqiptare të Amerikës si në vijim:

Më 11 tetor është në Goodyear (CT), kurse më 12 tetor mban konferencë në North Grosvenordale. Boton udhëpërshkrimet më 16 dhe 21 tetor, kurse konferenca botohet më 18 tetor. Më 18 tetor ndodhet në Worcester (MA) ku takohet me çamët, një ditë më pas ndodhet në Webster (MA) dhe Rochdale. Udhëpërshkrimet i boton më 23 tetor. Më 24 tetor është në Lewiston (ME); i boton shënimet për Lewiston dhe Auburn më 30 tetor. Dy ditë më pas do të flasë në Biddeford (ME), kurse përshtypjet për Biddeford-Saco i boton më 1 nëntor. Më 2 nëntor ndodhet në New York City dhe qëndron 5 ditë për organizimin e degës së Vatrës. Më 9 nëntor flet para një pakice vatranësh për rreth një orë në Manchester (NH); konferenecën e boton më 22 nëntor, kurse udhëpërshkrimin më 9 dhjetor. Më 16 nëntor flet në Waterbury (CT) dhe konferenca botohet e shkurtër më 19 dhjetor. Më 18 nëntor ndodhet në New York, sepse të nesërmen do të jetë i ftuar nga publicisti Hamilton Holt që do të themelojë Shoqërinë Friends of Albania. Më 21 nëntor ndodhet në Atlantic City (NJ), kurse udhëpërshkrimi botohet me vonesë, më 15 janar. Dy ditë më pas është në Philadelphi (PA) ku flet përpara vatranëve dhe udhëpërshkrimi botohet më 22 janar. Më 30 nëntor flet në New Bedford (MA) dhe Londsdale (RI) dhe i boton udhëpërshkrimet gati dy muaj më vonë, më 27 janar. Më 14 dhjetor flet në Southbridge (MA), kurse udhëpërshkrimin e boton më 29 janar. Dy javë më vonë Konica do të flasë në Worcester (MA); ndonëse konferenca do të mbahet në një kohë kritike

për Shqipërinë nuk e pa dritën e botimit, veçse boton shënimet e takimit më 31 janar. Më 4 janar do të flasë në koloninë e vjetër të Natick-ut, ku marrin pjesë dhe shqiptarët që jetojnë në Marlboro dhe Hudson. Më 14 janar do të flasë në Boston, në sallën e Kishës "Shën Gjergji" dhe kjo do të jetë konferenca e fundit për shqiptarët e New England-it. Në kryeqendrën e shqiptarëve të Amerikës do të qëndrojë deri në fund të janarit dhe do të fillojë udhëtimin në kolonitë shqiptare më të largëta të Middle West-it. Më 1 shkurt flet në Jamestown (NY), më 8 shkurt flet në Niles-Youngstown (OH), më 15 shkurt flet në Massillon (OH), më 22 shkurt Detroit (MI) dhe konferencën e fundit do ta mbajë në East Pittsburgh (PA) më 1 mars. Faik Konica kthehet në Boston më 9 mars nga udhëtimi i dytë, kurse në një shënim të botuar në "Dielli" më 12 mars, kur flet për rastin e Ahmet Zogut, ndër të tjera thotë: "Në ka një gjë të shigurtë në botë, ajo është që populli shqipëtar nukë do njerëz si Fan Noli dhe si mua, do njerëz si Zogun dhe Mufidin".

Pavarësisht këtyre të dhënave të mësipërme, Faik Konica do të flasë në katër raste (shih nën a e d, çka na ndihmon për të mbështetur hipotezën tonë) për romanin Dr. Gjëlpëra:

a) Në një shënim për Dramën e Mamurrasit (Dielli, 15 nëntor 1924, f. 2) ndër të tjera shkruan: "Sa për rrënjët e thella të dramës së Mamurrasit, ato i përkasin më tepër psikologjisë se sa kanunit, dhe nga kjo pikëpamje Pralla ime e Dr. Gjëlpërës (të cilën udhëtimet për konferenca më bënë t'a vonoj pakë) ka për të shtënë një dritë të veçantë".

b) Faik Konica përmend një konferencë që shkrimtarja amerikane Zona Gale mban në Boston, më 25 janar 1925 me temën: The Novel as a Medium for the Advancement of Social Ideas [Romani si një mjet për përparimin e mendimeve shoqërore]. Ai bën me dije se shumë nga lexuesit e Diellit patën mirësinë ta çmojnë romanin Dr. Gjëlpëra, roman i cili me të vërtetë futet në kategorinë e përshkruar nga Zona Gale dhe i siguron lexuesit se romani 'do t' vazhdojë dhe do t'shvillohet në një mënyrë që kam shpresë se do të fitojë dhe ca më tepër pëlqimin e tyre'.

c) Faik Konica më 7 korrik 1925 pohonte se "nuk do ta lë romanin për gjysmë: është një pushim, por jo një dorëheqje."

d) Një vit më vonë, pikërisht më 12 qershor 1926, Konica nuk e përmend më vazhdimin e romanit, veçse bën me dije se romanin nuk e la përgjysmë për shkaqe politike.

Siç mund të shihet më lart në pikat (a), (b) e (c) premton se do ta vazhdojë romanin. Pra, është në kundërshtim me parimin e tij, sepse ai e kishte shprehi që një vepër të ndërprerë nuk e vazhdonte më[12].

- Faik Konica më 9 tetor 1924 pohon se kur erdha n'Amerikë më 1921, shumë vatranë më çfaqnë dëshirën t'u "jap nj' a dy libra". Ashtu kur kam patur nge, natën, në shtëpi, kam shkruar nga nonjë faqe, dhe pas ca kohe katër libra muarnë formë. Në fakt, këto janë librat që ka paralajmëruar K. Tashko më 8 mars 1924: Katër pralla nga Zullulandi, komedia Mustaqet, romani Tryeza e fshirë dhe vepra gjuhësore Themelet e gjuhës shqipe.

- Faik Konica më 7 korrik 1925, duke folur për mungesën e librave, pohonte se një komb që s'ka literaturë nuk mund të quhet komb. Ashtu siç kishte pohuar edhe një herë më parë se "duhet të kuptojmë një her' e mirë se një komb s'munt të shvillohet e të përparojë po s'pati shpirt: dhe shpirtin munt të j'a japë vetëm një literatur' e vërtetë".[13] Më pas tregon se ka përgatitur 5-6 libra, një prej tyre është "Dr. Gjëlpëra", kurse nga K. Tashko vijnë të dhënat për katër librat e tjerë.

- Vetë Konica më 30 janar 1926 na bën me dije se: Ca muaj më parë, një grup Shqipëtarësh në Boston më proponuan t'u shes një libër letrar me gjithë të drejtat e zotimit (copyright). Suma e proponuar ish modeste; po me që pata nevojë të madhe t'u bëj ballë disa billeve, pranova dhe j' u-vura punës duke mbetur përpara tryezës nga nonjë herë gjer më 3 të mëngjezit (jam nga ata që për fat të zi punojnë më mirë natën.) Pa shkuar shumë ditë, u-lajmërova se, për shkak t'ideve politike të mia, njeri prej të pesëve u-nda nga shokët. Pakë më von, mora vesh se u-hoq nga kumpania dhe një shok

i dytë, gjithë për ato arësye. Kur mbarova gjysmën e librit, qe larguar dhe një shok i tretë. Pakë pastaj, na la shëndet i katërti. Dhe me që kish mbetur besnik te marëveshja një i vetëm nga të pesët, puna natyrisht mori funt prej vetiu. Sipas Konicës libri nuk u përkrah për arsye se të lartpërmendurit ishin adhurues të Nolit. Edhe fati i këtij libri të mbetur në gjysmë nuk dihet hëpërhë?

- Në vitin 1927 Konica na bën me dije se do të botojë veprën Themelet e gjuhës shqipe. Kjo vepër, me gjasë një përmbledhje me artikuj gjuhësor të botuar më parë te revista "Albania" (1897-1907) dhe te gazeta "Dielli" (1909-1912) dhe (1921-1926) nuk doli në dritë edhe pse ishte përkrahur në Kuvendin XVI të Vatrës. Në të vërtetë, kjo vepër ishte paralajmëruar tre vjet në parë edhe nga K. Tashko.

- Më 25 maj 1928, gazeta "Dielli" na bën me dije se Faik Konica do të botojë së shpejti veprën Të vëna ré të gjuhës shqipe, që nuk e pa dritën e botimit.

- Faik Konica më 26 mars 1929 nis botimin në gazetën "Dielli" të veprës Shqipëria si m' u-duk; pas 25 vazhdimeve u ndërpre, edhe pse "Vatra" e kishte marrë përsipër për ta botuar në formë libri. Për dallim nga veprat e tjera të mbetura në gjysmë, Konica për këtë vepër kishte paralajmëruar edhe kapitujt vijues: VI. Mandarinët ose njerëzit që i japin më tepër rëndësi diplomës se sa diturisë dhe karakterit. VII. Refugjatët politikë; VIII. Shtypi i huaj. IX. Për Zotërit e Dheut. X. Pseudo-aristokratët.

Më 10 qershor 1930 botohet në gazetën "Dielli" një letër e Fuad I. Babametos, kryetari i Shoqërisë "Drita" të gjirokastritëve nga East Pittsburgh-u (PA), ku na bën me dije se Faik Konica nuk e kishte bërë gati librin e blerë nga Shoqëria "Drita", sepse e patën penguar "shumë punëra serioze që ka patur, dhe do t'ketë për një kohë të shkurtër". Po aty mësojmë se Konica i pati kthyer të hollat si paradhënie që i kishte marrë dhe ai pati premtuar se librin 'do t'ja dhuroj "Dritës" darovisht kur t'a përgatitë'. Se për çfarë libri bëhet fjalë dhe se a ka mbetur për gjysmë sot për sot nuk mund të dimë.

Faik Konica më 21 nëntor 1935 nis letërkëmbimin[14] me botuesin e njohur Robert M. McBride për të botuar *A Short History of Albania* [Një histori e shkurtër e Shqipërisë]. McBride nuk ishte vetëm botues, ai ishte themelues i disa revistave në New York. Po ashtu, ishte autor i librave për disa vende evropiane, si Anglia, Spanja, Suedia, Norvegjia, Finlanda dhe Çekosllovakia. Sipas një letre që mban datën 18 shkurt 1936, Konica e parashikon librin të përfunduar në fund të korrikut. Në fakt, libri mbeti i papërfunduar dhe nuk e pa dritën e botimit në gjallje të autorit. U botua më 1957 nga Qerim Panariti me titull të ndryshuar Albania: *The Rock Garden of Southeastern Europe and Other Essays*[15] (Shqipëria: kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore dhe ese të tjera).

- Në vitin 1936 Konica bënte me dije se është duke përkthyer tragjedinë Mbreti Lir të Shakespear-it.

- Më 2 janar 1952 në gazetën "Dielli" botohet një letër e Faik Konicës. Në këtë letër (mungon datimi dhe emri i marrësit) Konica njofton se është duke e shkruar një libër M[b]i gjuhën shqipe. Nuk e dimë nëse Konica e ka shkruar këtë libër apo ka mbetur thjesht si ide.

Për disa nga këto vepra nuk njohim as titujt e as përmbajtjen, për disa si Çetelet, Tryeza e fshirë, Themelet e gjuhës shqipe, Të vëna ré të gjuhës shqipe, M[b]i gjuhën shqipe, njohim vetëm titujt, por jo përmbajtjen, kurse për komedinë Mustaqet njohim përmbajtjen, e jo tekstin e veprës. Ashtu sikurse nuk dimë nëse veprat janë përfunduar, ose kanë mbetur në gjysmë dhe ku mund të ndodhën sot? Kërkimet tona të herëpashershme nuk kanë dhënë ndonjë rezultat për zbulimin e ndonjërës prej këtyre veprave. Përkundrazi, kemi bërë një zbulim në anë të kundërt: romanet "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka" - të konsideruar nga një numër studiuesish si romane të Konicës - për fat të keq nuk janë në autorësinë e tij.

Në fund, bazuar mbi çka u tha më lart, i japim të drejtë Fan S. Nolit[18], kur thoshte: Faiku niste një vepër dhe e linte në mes. Po ashtu, i japim të drejtë Fan S. Nolit[19], kur shkruante për veprën e Konicës se jemi të gëzuar që e kemi qoftë edhe në trajtën e paplotë.

Shënime

1. Edhe ky shembull na ndihmon në çështjen e autorësisë: "Kafenét' e Shqipërisë janë vënde të fëllíqura e të mërzítura; dhe asnjerí me mëndje të hollë s' munt të kërkojë atjé dëfrím në mes të týmeve, të pshtýmave, dhe të zhurmës... Kur u-shtrua herën e parë në Kafené të Erzenit dhe porositi një të pirë të cilën natyrísht nuk e ngau, dhe hodhi një sy mi turmën e palarë e të parojtur – kumarxhínj të ngrysur, spiunë sy-çakáj, politikanë që bisedojin jo vetëm me gojë po dhe me duar e me supe – kuptój se ndodhej në një botë të re, një botë fare të ndryshme nga ajó që kish njohur gjer ahere. Një zhurm' e mbytur, e përgjíthëshme, si e nonjë pazari të ngjeshur me njerës, mbushte erën": Faik Konica, Dr. Gjëlpëra zbulon rënjët e dramës së Mamurrasit, "Dielli", 3 shtator 1924, nr. 2759 (302), f. 4.

2. Nuk është vendi këtu për t'u ndalur për kontributin e arbëreshëve të Amerikës në historinë e kulturës shqiptare, ku në një të ardhme mund të jetë temë më vete.

3. Faik Konica u kujton vllehve (nënshtetas shqiptarë) të Amerikës për trajtimin diskriminues që u bëhet vllehve në Serbi dhe Greqi. Në qoftë se në Greqi vllehtë burgosën, kur kërkojnë të drejtat e tyre, në Shqipëri ndodh e kundërta: qeveria nuk i kundërshton, përkundrazi i inkurajon. Shih Faik Konica, Southbridge, Massacuesets. "Dielli", 29 janar 1925, f. 2.

4. Shih Sevdai Kastrati, Lufta e penave, Botimet Toena, Tiranë, 2002, f. 397.

5.Lidhur me këtë kemi një letër të Konicës dërguar Nolit që mban datën 15 nëntor 1910 e që ia vlen të lexohet: Shumë herë, atdhetarët më janë qarë që s'i kam dhënë letrëtyrës shqipe nonjë librë, të cilit, për arësyet që do të rëfej në parëthenie, i dhashë emrin Kondili i Kuq, dhe hapa qe dhjetë muaj te gazeta një radhua për të mbledhur të hollat e nevojshme për botimin. Pas shumë mundimesh, arrijta të mbleth gjysmën e sumës që duhej, dhe naturisht s'kam në dorë t'a shtyp librin, para se të kem me se t'a paguaj bill-in e shtypësit. Po ca nga nënëshkronjësit, pa kuptuar mirë pse i dhanë të hollat dhe ç'do me thënë një radhua për të botuar një librë, më shkruajnë për ditë që "ku është Kondili i Kuq?" etj. Këto kërkime janë të paarësyshme. Nuk është miaft që një auktor ësht' i shtrënguar të lipij, po duhet tani të hapë dhe një zyrë për të biseduar me ata që i dhanë 50 senca! U lutem të gjithëve të kenë durim. Në mos daltë libri, do t'u kthej paratë. Në daltë, dhe pa dyshim do të dalë, do të shohim në gazetë që "Kondili i Kuq dolli", dhe ahere, në qoftë se ata që paguan s'marin copën që kanë të drejtë ta presin, le të qahen. Duke iu referuar një shënimi në një vend tjetër (Shih Faik Konica Një udhëtim gjashtë javësh në "Dielli e flamuri", 20 janar 1911, f. 4), ku ndër të tjera është thënë se janë mbledhur 695 dollarë (500 dollarë në St. Louis, 121 në Jamestown dhe 74 në Syracuse) për revistën "Albania", për gazetën "Trumpeta e Krujës" dhe për "Kondilin e kuq". Vite më vonë, më 9 tetor 1924, Konica ngatërron shumën: përmend vetëm dyzet e shtatë dollarë.

6. Në këtë mënyrë shpjegon J. Kastrati: "Mbeti pa u njohur në masën e gjerë të lexuesve për dy arsye kryesore. E para, sepse u botua gjatë periudhës midis dy luftërave: Luftës Ballkanike (1912-1913) dhe Luftës së parë Botërore (1914-1918), kur shqiptarët ishin në një gjendje tepër të mjeruar, të varfër e të vështirë dhe nuk i binte ndër mend të ndiqnin shtypin periodike e atë letrar. E dyta, sepse punimi në fjalë u botua në një gazetë, e cila nuk vinte rregullisht në Shqipëri për shkaqe të censurës ushtarake dhe të rrugës tepër të gjatë që përshkonte: Nga Bostoni i Amerikës në Shqipëri." (Jup Kastrati, Faik Konica, Gjonlekaj Publishing Company, New York, 1995, f. 280).

7.Shih Faik Konica, Vepra 5, Botimet Dudaj, Tiranë, 2001, f. 434.

8. Shih Shyqri Galica, Konica – moderniteti, eseistika, kritika, GR, Prishtinë, 1997, f. 12. Po ashtu, të njëjtin mendim e ka marrë nga Jup Kastrati edhe Moikom Zeqo në artikullin Faik Konica i pavdekshëm (2015): "Në 1912 nisi të botonte te "Dielli" fragmente të një libri "Jeta e Skënderbeut", sipas Barletit, (deri më 1918 botoi 25 fragmente të tilla me interes shumë të madh)."

9. Siç duket e ngatërron me Kondilin e kuq.

10. Faik Konica, Një proponim i z.t Aqile Tasit, "Dielli", 8 shtator 1923, f. 5.

11. Ky grup teatror është krijuar prej tij (njëherit është edhe aktor) dhe më 4 korrik 1923 në "Arlington Theater" të Bostonit ka vënë në skenë tragjedinë Othello të Shakespir-it të përkthyer nga Fan Noli.

12. Kristaq Jorgo është i vetmi nga studiuesit e Konicës që e ka vënë re se romani është ndërprerë më 1 nëntor. Shih Kristaq Jorgo, "Dr. Gjëlpëra" – romani i (pa)përfunduar i Konicës, "Shqip", 12 gusht 2007, f. 42-44.

13. Ky shënim na bën të mendojmë se është shkruar nga vetë Konica, sepse editori Aqile Tasi ndodhet me pushime. Ndërsa për shënimin e lartpërmendur Th. Gjika, në studimin e tij Doktor Gjëlpëra - romani i parë realist i letërsisë shqipe, mendon se është shkruar nga editori Bahri Omari, në të vërtetë numri i fundit si editor i "Diellit" për B. Omarin është 3 nëntor 1919.

14. Do ta jap si shembull një shënim të Faik Konicës më 10 dhjetor 1921 kur thotë: duke qenë se kam qenë dy javë n'udhëtim, s'kam pasur nge të shkruajë gjësendi për "Diellin".

15. Përpos në dy raste e kemi vënë re; po jap të parin: Nota mi udhëtimin t' im janë ndërprerë më 12 qershor 1923 dhe janë vazhduar më 13 tetor.

16. Shih Idriz Lamaj, Letra dhe shënime të Faik Konicës - rreth përpjekjeve për botimin e librit të tij Një histori e shkurtër e Shqipërisë. "Dielli", korrik-shtator 2003, nr. 3, f. 10, 11.

17. Nelo Drizari (mik dhe bashkëpunëtor i Konicës) e kishte lexuar librin në dorëshkrim dhe me rastin e botimit të librit nga Panariti e quajti masakrim. Mbetet detyrë e studiuesve të Konicës për të gjetur dorëshkrimin dhe për të vërtetuar hipotezën e Drizarit.

18. Shih Fan S. Noli, Vepra 5, Botimet Dudaj, Tiranë, [2003], f. 435.

19. Shih Introduction by Bishop F. S. Noli, në: Faik Konitza, Albania: The Rock Garden of Southeastern Europe and Other Essays, "Vatra", Boston, 1957, f. xv.

NJË PROZË E PANJOHUR E FAIK KONICËS

Mendimet e Filopimin Trukuleskut

I

"Kafeneja Madhështore Boulevard Saint Michel" ish vëndi ku mblídheshin të gjithë njérëzit me rëndësí në Tiranë. Ora ish nj' a pesë pas dreke. Kafeneja Madhështore – e palarë, e shtruar me mobilla të shëmtúara dhe të vjetërúara e të lódhura, e mbuluar si prej një mjégulle të ndyrë nga qenefi gjysm' i hapur dhe kurrë i zbrazur e i spastruar – ish plot gjallësí dhe jetë. Këtú kuvëndojin, atjé kërcisjin zaret në tavllë, më tutje qeshjin; dhe përmi tërë zhurmën, dëgjohej zëri i mbrehtë i shërbénjësve që po porositjin të pira. Menjëherë u-bë një pushím i përgjíthështm. Dikush pështpëriti: Vjen Zoti Filopimín Trukulesku!

I zoti i kafenesë, Barbajanesku, u-sul përpara dhe me një të përulur tha, "Misarthtë, Dómnule Filopimín!" edhé fshiu një tryezë. Njeriu i ardhur ish i gjatë, i mbushur nga trupi, me fytyrë të verdhë, móllëzat e fáqeve të hédhura. Nxori kapellon edhé u-duknë flokë të zeza e të rrúdhura. Një shërbénjës i mori kapellon dhe bastunin, edhé Filopimin Trukulesku u-ul. Nga shumë tryeza të tjera u-afëruan njerës t' a përshëndoshin me nderím, se Zoti Trukulesku ish i fuqishmë, një nga dritat e Shqipërisë së re. Nga një fjal' e tij varrej fati i shumë njérësve. Zoti Trukulesku i priti të gjithë me një kryelartësí mbrónjëse dhe me një njohje të shkurtër, se e kish mëndjen në dy njerës të huaj që kishin ardhur me të. Këtá ishin dy gazetarë, njëri Inglíz, tjatri Amerikán. Dukej se që të tre kishin patur një bisedím të gjatë, i cili édhe po vazhdonte. "Po", thosh Trukulesku, "Shqipëria është vënt i paqyetëruar, i ndyrë, i vogël, pa rëndësí, pa historí, pa të pritme. Shqipëtarët janë të poshtër. Po pak-nga-pak do të ndrohen të gjitha." – "Më ndjeni", pyeti njëri nga gazetarët të habitur, "ju vetë Shqipëtár jini?" Zoti Trukulesku qeshi. – "Pëllëria mësi! jam më Shqipëtár se çdo Shqipëtár tjatër. Po më pëlqén e vërteta. Shqipëria s' është gjë fare, né Shqipëtarët jemi të liq e t' egër. Po me ndihmën e ca miqve, si Rumania, do të vemi mbarë."

Të dy gazetarët u-ngritnë dhe múarnë leje. – "There is something strange about this fellow", pështpëriti njëri. "Let us go to that delightful Albanian inn 'TE SHKALLA E TUJANIT' and talk it over", tha tjatri; edhé dúallnë që të dy.

Në këtó e sipër, një njerí i veshur me një farë uniforme j' u-afërua Zotit Trukulesku me një zarf të math në dorë, edhé j' a dorëzój me fjalët: "Zoti Filopimín, kju hështë një shkrím gaj Kryeministru. Hështë rezervát." Zoti Trukulesku e hapi t' a këndojë. Shërbénjësi Aristoteli ndodhej prapa fronit, dhe unji kokën të këndojë bashkë me Zotin Trukulesku. Pastáj u-largua dhe vajti nga fron në fron duke thënë, "Është rezervát!" e duke pështpëritur sicilitdo ca fjalë në vesh. Më në funt u-afërua pranë tezgës ku ndodhej një "megaphone", një zë-madhonjës nga Amerika, edhé e mori në dorë.

II

Johanica Celingesku kish arrirë dy vjet më parë nga Amerika në Shqipërí me qëllimin të hapë një shoe-shine për të fshirë këpucët e Tiranës me mënyrën e bukur që i ka hie një kryeqyteti. Kish prurë përvéç vúrcave dhe fróneve të prëhështme, edhé një megaphone për të thirrur shkónjësit. Se Jehonica Celingesku ish bootblack i mbaruar. Kish punuar tre vjet në shoe-shine-in e Jim Smith-it në Conny Island, pranë New York-ut, një llustraxhihane me çkëlqím dhe me famë, të cilën i zoti, stërnip i vërtetë i Barnum-it, e quante me emërin gjëmonjës The Conny Island Academy of Applied Science. Jim Smith-i mburej se në "Akademí" të tij këpucët "shëróheshin" me diturinë ekspertësh që dijin cilësít' e çdo soj lëkure edhé diljin andéj të përsërítura posi trupi i një njeriu me lëngatë del i spastruar dhe i ngjallur nga Spitali i një Universiteti të mirë. Dhe si gjith' Amerikanët e kthiellt, Jim Smith-i ish zëmërbardhë: sillej mirë me punëtorët e tij, të cilët i quante "nxënës", students; dhe në funt pas tre vjetsh, posa tregojin zotësí dhe kujdés në "mësimet", u jipte një dipllomë Doktori të Diturive Praktike. Një të tillë dipllomë kish fituar me kryelartësí edhé Johanica, të cilin këtéj e tutje do t' a qúajmë Doktór Celingesku.

Me t' arrirë në Tiranë, e para vizitë e Doktór Celingeskut qé për Filopimín Trukuleskun, të cilit i kish prurë edhé një dhuratë. – "Dómnule Filopimín, hardha të hy çfaq nderimet he mia. Hy lutem të pranoni këtë dhuratkë të vogël. Hunë dëshërój të 'ap një dyqankë në Tiranë, hedhé tërë shpresën t' ime he kam tek hyve." Me këtó fjalë e paraqiti veten e tij Doktór Celingesku; edhé duke parë pritjen e pëlqyer të Filopimín Trukuleskut, j' u-ngroh zëmëra dhe nxori nga xhepi një zarf ku ish palosur diplloma. Zoti Filopimín e mori dhe e këndój:

THE CONNY ISLAND ACADEMY OF APPLIED SCIENCE
NEW YORK STATE

This is to certify that Johannitza Tselingescu, born at Moschopolis, Albania, in 1902, has been granted, after extensive studies and severe examinations, the degree of Doctor of Applied Science. Specialization: The care of leather.

Conny Island, N. Y., the 30th of June, in the year 1931 of Our Lord.

Dick Brown	John Smith
Dean	President
(Këtú Vula e Akademisë)	

Filopimín Trukuleskut i ndritnë sytë. – "Thé se do të hapsh një dyqán? Bizérika! Miku im Johanicë, ti flet si i çmëndur. Me një dipllomë si kjo, unë munt të çaj për ty një udhë të bukur. Shqipëria ka nevojë për diturí dhe për talént. Ti jé i paçmuar. Do të shkoj me këtë dipllomë të madhe që këtë çast te një mik i fuqishmë, edhé nesër do t' emërohesh nënë-prefékt në qark të Jugë-Lindjes. Është një pikë me rëndësí, se atjé hyn malli nga Maqedhonia në Shqipërí. Mëmëdheu ynë i dashur, Shqipëria, ka nevojë për njerës me ndienjën e detyrës, të cilët kanë sytë të hápura për kontrabandë." Këtú Filopimín Trukulesku pushój një minutë, shikój Doktorin e Conny Island-it në sy, afrój pakë fronin, dhe vazhdój duke ulur zërin: "Natyrísht, vëllá Johanicë, miqësia është miqësí, dhe detyra s' ka nevojë të jet' e ashpër. Nga nonjë herë, munt të vijë nonjë deng për nonjë mik t' onë: S' prish punë sikur të mbyllen sytë. Kuptove?" Doktor Celingesku nënëqeshi: – "Dómnule Filopimín", tha "hunë do të jem hajú më besniku njerí tek hyve. Detyra hime hështë dhe do të jetë t' u kënáq hyve". – "Vëllá Johanicë, puna ësht e mbaruar!" tha Filopimín Trukulesku, dhe u-ndamë.

Të nésërmen fletët kishin emërimin e Zotit Doktór Johanica Celingeskut si nënë-prefékt, me lëvdata për diturinë, për zotësinë, për drejtësín' e tij, edhé për mundimet e tij për mëmën Shqipërí. Celingesku i shiti fronet dhe vurcat, edhé megaphone-in j' a fali Barbajaneskut, i cili me një kryelartësí të madhe e vuri në tezgë. Këtë megaphone mori në dorë Aristoteli.

III

"Zotërínj!" tha Aristoteli duke pshtetur buzët në vërën e megaphone-it, "letra e fshehtë, ose 'rezervát' në 'shqipen' e re, çfaq se u-bë një përpjekje në kufí të Sërbisë, po puna u-ndreq para se të mahiset". Filopimín Trukulesku u-hoth më këmbë. – "Aristotél!" briti, "mos u-prishe mëntsh? kush të dha guximin të nxjersh në shesh të fshehtat e Guvernës? Barbajanesku, pa eja këtú: Nuk më thua, ç' janë këtó turpe?" – Barbajanesku u-krus me një dukje lútëse: – "Domnule Filopimín, më vjen shumë keq. Haristotél, mblith plaçkat hedhé hu-çporr këtéj! Në hu-duksh prapë këtú, bizérika! hunë jam hajú që do t' thyej kockat." Aristoteli u-largua pa folur, shkoj në magjërí, me Barbajaneskun pas.

Kafeneja Madhështore Boulevard Saint-Michel pushój në heshtje: të gjithë prisjin se ç' do të ngjiste. Pakë më von u-kthye Brabajanesku edhé diç i pështpëriti në vesh Filopimín Trukuleskut, i cili u-ngrít, dhe që të dy hynë brënda. – "Dómnule Filopimín", zuri të thotë Barbajanesku, "hu thirra të hurdhëroni këtú se ka ngjarë një gjë he tmerrshme. Haristoteli hështë një njerí haqë hi poshtër sa nuk beso'et. Më tha njëqínt he një të shara. Më thirri 'qeratá çobán'; hu-mburr se hajú hi ka sytë 'ápura hedhé hi ka kuptuar gjithë punët t' ona; tha se jemi 'ajdutë hedhé kontrabandierë, spiunë hedhé tradhëtorë, njerës harmíq të vëndit që hi thëthihim gjakun Shqipërisë hedhé hi ngulhim thikën në kurríz. Kur hi thashë hunë se, Në qënke haqë patriót sa thuha, psé hi çfaq me megafón gjërat rezervát të Guvernës, hajú më tha se s' ka gjë të fsh'ët në Tiranë, se 'qeraténj çobanët' janë tellalë të paguhar për të nxjerë të gjitha në pazár, se të fshe'tat du'et të mba'en në zyrat dhe jo të dërgo'en në kafenetë, hedhé shtoj se hajú duke për'apur shkrimin rezervát deshi të japë një mësím si me të tallur. Tha hedhé shumë të tjera. Në një fjalë, Dómnule Filopimín, hajú hi poshtër na ka përgjuar si harmík që hështë, hedhé kam frikë se do na bëjë dëm."

Filopimín Trukuleskut i ndritnë sytë. E shikój Barbajaneskun me zëmërim: – "Fajin më të math e ke ti, Barbajanesku!" – "Hunë, Dómnule Filopimín?" – "Da, ti, dobitókule! Pse mer Shqipëtarë në shërbím tënt?" – "Më ndjehni, Dómnule Filopimín, po hyve vehtë më kini porositur të mos 'arrój se këtú hi thonë Shqipërí hedhé du'et për sy-he-faqe nga donjë'erë të hi jap punë hedhé donjë Shqipëtari." – "Porosinë t' ime, Barbajanesku, e kuptove shtrëmber. Të porosita, dobitókule, t' i japësh punë nonjë Shqipëtari të fjetur, jo një dhélpëre." – "Po ku t' i njósh, Dómnule Filopimín? Hatá, mámalor! duken të gjithë budallénj hedhé të bindur kur kërkojnë punë; pastáj, kur vjen okaziúnea, he 'eqin maskën hedhé bë'et hajó që hu-bë sot."

Filopimín Trukulesku u-ngrit dhe nisi të shëtitë anë mb' anë t' odës, i dalldisur në mendime. Qëndrój më në funt dhe j' u-kthye Barbajaneskut: – "Dëgjó. Shko mer-e me të mirë Aristotelin edhé sill-e këtú se dua t' i flas."

Barbajanesku e gjeti Aristotelin në magjërí, të shtruar përpara një shishe konjaku. – "Trajaske kálea Dobrobántsilor!" briti Aristoteli me të parë Barbajaneskun. I zoti i Kafenesë Madhështore fshehu hidhërimin dhe nënëqeshi: – "Djali him, Haristotél, të kam dashur kurdo'erë. Gaj muha s' ke parë donjë të keqe. Po ti, pa marë në sy has miqësinë has vërsën t' ime, tallesh me muha. Ke punuhar dy vjet në Rumaní hedhé ke mësuhar ca fjalë të cilat hi përdór hedhé kur nuk he do okaziúnea. 'Trajske kálea Dorobántsilor' hështë sikur të thuhash 'Roftë hudha he Dúrrësit!'; s' ka donjë kuptím fare." – "Më pëlqen tingëllimi i fjalës, Çobán, pa le të jëtë pa kuptím: Është si një e krisur topi." – "Pastáj, djali him", vazhdój Barbajanesku pa vënë re të thënat e Aristotelit, "kush të dha leje të pish konják?" – "Më plasi shpirti, Çobán, desha një të pirë, dhe zgjodha më të mirën; s' jam i marrë të pi cujkën a rakinë që e bën ti vetë për të helmuar botën." – "Le të hi lëmë shakatë taní, djali him Haristotél. Dëgjó. Zoti Trukulesku të lutet të vish me muha se ka një fjalë me tynë". – "Më lutet?" nënëqeshi Aristoteli; "Më lutet! Ha-ha, më duket sikur Shqipëria zuri të fitojë. Hajdé të shkojmë të shohim se ç' dëshërón njeriu i math."

Flurans Ilia

MIGJENI TREGIMTAR KRAHASUAR ME KOLIQIN DHE KAFKËN

Jemi mësuar prej vitesh tashmë të adhurojmë poezinë e Migjenit. Ngaqë aty, te vargu i tij, janë përputhur ide, forma, shpërthime, e kryesisht elementë jashtë letrarë që e bëjnë Migjenin qysh në gjenezë të konsiderohet një nga poetët më të fuqishëm të shqipes. Kjo si rrjedhojë edhe e pritshmërisë që lexuesi ynë ka kundrejt poezisë në veçanti. Që Migjeni ishte një nga novatorët më të mëdhenj të letërsisë tonë të viteve tridhjetë, kjo as që vihet në dyshim. Me plot gojë do e konsideronim edhe si një nga pionierët e parë të letërsisë moderne në gjuhën shqipe. Migjeni edhe sot konsiderohet si një risi për epokën kur shkroi. Duke e parë Migjenin të mbështjellë në këtë lloj aureole, padashje, kemi lënë në dritëhije prozën e tij.

MIGJENI
Puthja e cubit

(1936)

Edhe një prendverë ka ardhë. Prendvera e 17-të për Dilen, e cila, e shtrime në bar, ndjeu se ka tamam, as ma pak as ma tepër se 17 vjet.

- Nano! Sa vjet kam? – pyeti nanën në shtëpi.

- Tashti i mbushe 17, bijo! – i tha nana me një dorë n'ijë e me tjetrën mbi sy, për m'u mprojtë nga rrezet e diellit.

Edhe Dila, e shtime në bar, ndjeu se ka tamam 17 vjet. Ashtu e shtrime, shikon qiellin e kaltërt dhe ndigjon cingaret, një të dashit të grigjës ma e hollë, dhe tjetra e lopës me za ma të trashë. Çohet herë herë e shikon bagtinë dhe prap shtrihet, me një dëshirë të vogël në gji. Sa fort Dila që i ndjen të 17 vjetat në vete! Kur në të kapërthyemit e dëshirës, ven shplakët nën krye dhe ma fort shtrihet, ndjen si nder veshë dhe nder tamtha i rreh gjaku me rrjedhje të forta dhe ban me ndie edhe me dishrue ma tepër. Atëherë Dila mbyll sytë. Ashtu me sy mbyllë pret diçka. Buzët e saja të lagta e të çeluna për gjysë e terte flladi i lehtë ...

***

Para ksaj prendvere bani një dimën acar. Bora që tashti shifet si kunorë vetëm nder bjeshkët e nalta, në dimën kish mbulue mbarë tokën. E stuhia e tmershme s'kish lanë pa e futë borën deri ndër shpella mali dhe zgavrriqe drujsh. Në këtë acarim dimri dhe bishët e malit zbriten nepër katunde, te njerzit, por kta nuk i priten mirë. Bashkë me bishët e malit zbriti dhe Cubi, i cili ishte tmera për ata që kishin ndigjue për të e që nuk e njifshin. Në besë, në buk'e krypë, i ati i Dilës e mbajti Cubin si mik. Dhe gjatë një mueji sa ndenji Cubi në shtëpi të saj, Dilës iu ba se ky Cub nuk asht ai Cub për të cilin flitshin se vret, grabit, përdhunon. Me të vërtetë po at emen kishte; por jo, nuk ishte ai. Cubit mik njëzetekatërvjeçar i buzqeshej nana, i buzqeshej Prenda, e shoqja e re e vllaut, baba i fliste me za të butë e vllauu këndonte me te. Cubi-mik ishte i mirë dhe të gjithë e nderojshin, Dila kanjëherë me dashje e pa dashje e shikonte në sy dhe kuqej, kanjëherë me dashje e pa dashje, tue bamë punë nëpër shtëpi, në të kaluem e prekte me krah dhe nga ajo prekje iu rritshin gjitë.

As nga armët e tija, rrypat me fyshekë, pushka dhe revolja nga të gjitha këto Dila s'kish frigë. Një ndjesi e fshehtë rritej në zemrën e Dilës dhe sa ma shum' ditë kalojshin aq ma e madhe bahej. Dhe ndiesia e ba dëshirë, dëshirë që të len pa gjumë.

Por një ditë, kur dielli sa një pare e madhe sermi u çfaq në qiell, Cubi shkoi. E Dila mbet vetëm me dashuninë për Cubin.

***

Asht e flakët dëshira e Dilës në një ditë të shkëlqyeshme prendvere kur, e shtrime në bar, ndjen se si i rreh gjaku ndër dej. Asht edhe ma e flakët dëshira e Dilës kur i ka syt' e mbyllun e me andrim vezullues don me krijue ate që s'ka. S'ka... Nuk u pa ma Cubi. E 17 prendvera të saja janë 17 thirrje të nxehta të heshtuna drejtue Cubit.

Ashtu e shtrime dhe n'andrim Dila nuk desht t'i çeli syt' edhe se ndjeu mbi trupin e vet një peshë dhe të dihatunit e një mashkulli e mbi buzët e veta të përvlueme nja njomsi. S'i çeli sut'. Ndoshta kish frigë të mos prishi ekstazen në të cilën kishte ramë ... e kur ndjeu lehtësimin e trupit i çeli syt. Por aty s'pa kend. U hodh në kambë. S'ish kush. Shikoi për qark. Vetëm që pau djathtas në bar gjurma njeriu që vazhdojshin mbi bar nga ana e majtë. Dila u drodh. «Ai asht! Tha – Cubi!» dhe u vue në ndjekje të gjurmës majtas. Si e dehun, n'ekstazë, ecte Dila, dhe as nuk e pa bariun që ndenjun buzqeshte. Ecte Dila, vazhdoi edhe pa gjurmë dhe gjithënjë n'ekstazë. La grigjen, as që i binte ndër mend, pse kërkonte Cubin. Doli në rranxë të malit shkëmbuer. E thirri me emën, por bashkë me kambët e saja që përplaseshin prej shkambit në shkamb, q'ashtu dhe thirrjet e saja u përplasëshin- kot.

Kur erdh muzgu i mbramjes nepër livadhe dhe nepër shkambijt ndigjoheshin thirrje plot idhnim dhe dhemje:

«Dilooo! Dilooo ! Dilooo ! ».

1. Kuteli, Koliqi dhe Migjeni

Dy janë eksploratorët e parë të tregimit të shkurtër në gjuhën shqipe. Ernest Koliqi dhe Migjeni, të cilët e thyen akullin e traditës së të rrëfyerit gjer në atë pikë sa hapën shtegun e parë të tregimit modern në ujërat e letërsisë shqipe të fillimit të Shek. XX.

Është përmendur shpesh me të drejtë emri i Mitrush Kutelit në këtë kategori. Por nga kronologjia e botimit, Mitrushi kishte botuar veç një libër në atë kohë. Netë shqipëtare (1938) - një botim i pa fat, libër i shkatërruar aksidentalisht nga zjarri, por që e bën superior emrin e Kutelit në aradhën e njërit prej stilistëve më të mëdhenj të të gjitha kohërave në gjininë e tregimit. Duhet theksuar se Kuteli nuk ngeli vetëm në kufijtë e pionierëve të modernitetit në letërsinë tonë, por ishte diçka më tepër se kaq.

Duke ndjekur rrjedhën kronologjike, Ernest Koliqi ishte i afirmuar tashmë në këtë periudhë me botimet e tij: Kushtrimi i Skanderbeut (1924), Hija e maleve (1929), Gjurmat e stinëve (1933), Tregtar flamujsh (1935), Pasqyra e Narçizit (1936), Symfonia e shqypeve (1936), etj.

Ajo çka konsiderohej si letërsi gjer atë çast në Shqipëri ishte poezia, jo tregimi.

Dhe ja tek shfaqet Migjeni. Tetëdhjetë e pesë vite më parë, një mësues fshati i prekur nga tuberkulozi në lulen e rinisë, ndoshta ende i virgjër në trup por jo në mendje, çvirgjëroi magmën e asaj që gjer në atë çast burimin e kishte nga poezia.

Duhet të ketë qenë ekstremisht e vështirë për Migjenin shkëputja tërësisht nga poezia përgjatë lëvrimit të tregimit. Por ky është një çast vendimtar për tregimin si gjini. Për këtë arsye proza e tij ka nuanca dhe ngjyrime të theksuara poetike. Është një përpjekje, "alternativë", "dilem", "fragmentet e jetës", "fragment rruge", "rrota e jetës", "novelzë" sikur vet ai i ka përcjellë te lexuesi, profilizuar me dorën e tij novelzat : Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun?, Ose... ose... , Tragjedi apo komedi?, Një refren e qytetit tem, Novelë mbi krizë, Moll' e ndalueme, A do qymyr, zotni?, Në kishë, Ngjarje pa lëvizje, Vetvrasja e trumcakut, Luli i vocër, Zoti të dhashtë!, Program i një reviste, Qershijat, Idhujt pa krena, Legjenda e misrit, Bukuria që vret, Urime për 1937, Gogoli, Të korrunat, Zeneli, Puthja e cubit, Në sezonen e mizave, për të mbërritur së fundmi te Novela te qytetit të veriut ku Migjeni shfaqet për të parën dhe të fundit herë me portretin e plotë të prozatorit.

Ashtu sikur Mitrush Kutelit i takon merita si publikues i parë i poezisë së Lasgush Poradecit. Ernest Koliqi me Revistën "Illyria" të cilën e kishte themeluar, do të bëhej përcjellësi i parë i tregimtarisë së Migjenit.

Ernest Koliqi ishte i ushqyer me formën dhe stilin e tregimtarisë perëndimore, më veçantë me klasikët e gjuhës italiane. Formimi i Migjenit si prozator vjen kryekëput nga lindja, kryesisht nga romani rus, ku ndikim të pashmangshëm ka patur padyshim Dostojevski.

Ernest Koliqi dhe Migjeni kanë një emërues të përbashkët. As njëri as tjetri nuk do të ishin këta që janë sot, pavarësisht formimit të tyre letrar, po qe se platoja ku frymon vepra e tyre nuk do të ishte Shkodra. Ka ndodhur ekzaktësisht ajo që ndodhi me Kutelin dhe Poradecin, ku sinori i emëruesit të përbashkët letrar është Pogradeci.

Shkodra, ky qytet emblematik ku ajka intelektuale e shqipërisë moderne po kristalizohej, si të thuash u bë supernova më të habitshme në qiellin e letrave shqipe në vitet tridhjetë.

2. Kafka dhe Migjeni

Shkrimtari i vetëm me të cilin Migjeni ka një ngjashmëri të frikshme është Franc Kafka. Nuk e kam fjalën vetëm si fizionomi, por edhe duke krahasuar tekstet e tyre .

Të dy i përkisnin një origjine të ndryshme nga gjuha në të cilën e shkruan veprën. Të dy ishin minoritarë. I pari hebre në Pragë. I dyti ortodoks me origjinë sllave në Shkodër. Të dy ishin jo të njohur me libër të botuar për së gjalli në skenën letrare. Por, mjaft të njohur në rrethet letrare të qyteteve respektivë nga vinin dhe krijuan. I pari e shkroi në gjermanisht veprën e vet. I dyti në shqip. Veprat e tyre të plota u botuan pas vdekjes. Kafka dhe Migjeni vdiqën të rinj nga po e njëjta sëmundje. Dyshoj nëse Migjeni i ka lexuar tregimet e Kafkës. Por ngjashmëria midis tyre është magjepsëse.

Franc Kafka aplikon për të parën herë metaforën e drejt për drejtë në trajtën e prozës. Migjeni është poezi e drejtë për drejtë e kësaj forme. Çeku është një figurë lëvizëse e modernitetit prozaik të rrugëve të Pragës. Shkodrani është rrëfimtari më realist që dritëhijet e Shkodrës kishin njohur gjer në atë çast. Aq sa po të shkëmbenim si në një lojë shahu tregimet e tyre, do të kishim një rrëfimtar realist dhe një Migjen akoma më kulmor në majat e tregimit, çka edhe do ta dëshironim si lexues, me shumë forcë. Si kronologji nga koha e shkrimeve çeku daton një dekadë më parë se tregimi migjenian. Dyshoj nëse autori shqiptar kishte qenë në kontakt me tregimet e Kafkës. Së pari ngaqë ndër gjuhët që kishte studiuar Migjeni, nuk bënte pjesë gjermanishtja si gjuhë. Së dyti hapësira e njohjes ishte teje e ngjeshur për të njohur njëri-tjetrin nëpërmjet teksteve. E ç'mund të thuhet tjetër? Ajo çka bashkon natyrën e tregimeve të Migjenit me Kafkën është sëmundja. Brishtësia e tyre poetike e zbritur në terrenin e ashpër të letërsisë i takon veç fatit, pa të cilin nuk besoj se do ishin të aftë të shkruanin në këtë formë ndjesore, të veshur me pahun e përtejshëm dhe fisnik të vdekjes.

3. Binjakë me një tregim të vetëm

Ndodh edhe kështu, tregimet t'i ngjajnë frikshëm njëri-tjetrit, dhe autorët të mos kenë asnjë pikë takimi të përbashkët. Në një nga numrat e mëparshëm të ExLibris është botuar një tregim i Ernest Hemingueit me titull Sipër në Miçigan. Përgjatë përkthimit të tij më habiste ngjashmëria që rrëfenja e Hemingueit kishte me tregimin Puthja e cubit të Migjenit. Ishte e vetmja pikë e parë në vështrimin krahasues të letrave që i jep një krejt tjetër kumt tregimit migjenian, edhe që na bënë të mendojmë se po, tregimi i tij ishte në lartësinë e kohës, edhe pse jo, letërsia shqipe në vitet tridhjetë sapo hynte në të njëjtën suazë krijimtarie letrare si ajo e pjesës tjetër të botës, pa asnjë shenjë inferioriteti. (Të njëjtën teori krahasimi sjell si shembull Aurel Plasari për novelat Vjeshta e Xheladin Beut të Kutelit dhe Vjeshta e patriarkut të Markezit.) Një tjetër shembull ky nga teoria e letërsisë krahasuese që dëshmon se letërsia shqipe ka hyrë me individualitetin e vet në letërsinë e përbotëshme.

Heminguei e shkroi Sipër në Miçigan në Paris në vitin 1921 kur ishte 22 vjeç. Migjeni e shkroi Puthja e cubit diku aty nga Maji i vitit 1936 kur ishte 24 vjeç. Tregimi i Hemingueit u refuzua nga botonjësi dhe do e shihte dritën e botimit shumë më vonë nga koha kur u shkrua. Tregimi i Migjenit nuk u botua asnjëherë në të gjallë të tij por qarkulloi dorë më dorë i daktilografuar gjer në botimin e veprës së tij të plotë pas luftës në vitin 1954. Heminguei e shkroi tregimin e vet pas Luftës së Parë. Migjeni vetëm pak vite përpara Luftës së Dytë. Tregimi i Hemingueit ka për teh «aktin seksual» në një formë kontradiktore përdhunimi. Puthja e cubit është tërësia përvëlonjëse e tehut të «dëshirës seksuale». Të dy tregimtarët flasin me sytë romantik, të dlirë, të pafajshëm të heroinave përkatëse, çka universalizon gruan si protagoniste. Gruan e cila ngadhnjen në trajtën e lirizmit. Të dy tregimet kanë një fund tragjik. Një fund pa fund. Një fund që vazhdon gjatë sepse e mban lexuesin të lidhur aty.

Është befasuese se si mundet vallë të ngjajnë kaq shumë, Dila me Lizën dhe Xhim Gilmori me Cubin? A thua se janë pjellë e një mendje të vetme? Sipër në Miçigan kap skajin më verior të Amerikës. Puthja e cubit zhvillohet në Malësi. Klima është e ftohtë dhe atmosfera e njerëzve po ajo. Mentaliteti dhe të dhënat karakteristike janë identike. Ngjarjet në po të njëjtin fill subjekti. Xhim Gilmori përhumbet pyjeve dhe Cubi e gjen strehën në mal. Liza dhe Dila që presin njësoj të ndodh diçka në realitetin e ëndrrave të tyre. Kur në realitetin e përbashkët asgjë nuk ndodh, veç të treguarit me realizëm.

Këto dy tregime sikur kanë bërë një pakt të fshehtë me kohën, atë të djeshmen kur janë shkruar, dhe këtë të sotmen kur i lexon. Kanë po atë freski sikur i njëjti frut i këputur pak orë më parë në dy kontinente të ndryshëm. Ndoshta ky është sekreti përse të dy tekstet ngjasojnë. Koha e pjekjes së frutit ka qenë e njëjta.

Montréal, Janar 2021



"Të fshehtat e treguara" të Rexhep Qosjes -një roman postmodern

nga Feride Papleka

"E kam thënë dhe e kam përsëritur që për mua "postmodern", nuk do të thotë fundi i modernizmit, por një tjetër raport me modernitetin".
J.-F. Lyotard (Réécrire la modernité, Paris, Les cahiers de philosophie, N°5, 1988, p. 64).

Ka romane që e pasurojnë letërsinë, sepse hedhin një dritë të re edhe me anë të teknikave strukturore të shkrimit. Duke paraqitur metarrëfimin si mjet për të shmangur kontrollin e përhershëm të autorit që doemos çon në një kuptim të vetëm, ata kthehen në një parodi për epokën apo për disa dukuri dhe karaktere të saj.

Romanet moderne dhe postmoderne krijuan shkëputje me realizmin e shekullit XIX ku ngjarja tregohet duke u nisur nga një objektiv dhe një pikëvështrim i caktuar. Të dy tipat e romaneve e shfrytëzojnë fragmentin dhe unin për zhvillimin e rrëfimit, por krejt letërsia moderne i përdor këto elemente, duke i çuar në tejskaj si krizë ekzistenciale, në një konflikt që duhet zgjidhur. Përkundrazi, romani postmodern, tregon se kaosi është i pakapërcyeshëm dhe autori "i pafuqishëm", dhe si rrjedhojë, i vetmi shpëtim ndaj kësaj "rrënoje" është të luajë me këtë kaos.

Letërsia postmoderne në Francë, sipas studimeve të Jean-François Lyotard-it, Jacques Derrida-s dhe Jean Baudrillard-it përzien në rrëfim edhe shumë elemente të jashtme të kulturës. Vepra të veçanta me prirje postmoderne ka pasur që herët, madje edhe shkrime teorike, por shekulli XX, si të thuash i analizoi dukuritë e kësaj letërsie duke bërë përgjithësime, edhe i nisur nga shfaqjet postmoderne në arkitekturë, në artet plastike e në fusha të ndryshme që i përkasin krijimtarisë.

Rexhep Qosja, një nga personalitetet më të shquara të kulturës e të historisë së letërsisë shqipe, në prozën letrare ka zhvilluar një shkrimtari moderne dhe postmoderne, duke shtuar vëmendjen dhe duke nxitur diskutime në rrethet intelektuale, në kritikën letrare e te lexues të ndryshëm.

Romani postmodern Të fshehtat e treguara ka një titull provokues që krijon në vetvete një oksimor. Gjithashtu, teksti nis në një mënyrë provokuese. Aty thuajse gjithçka jepet në kuptimin e kundërt. Huysmans, një shkrimtar francez i shekullit XIX, ka një roman me titull *À* rebours (Së prapthi) ku nuk ndodh pothuajse asgjë dhe tërë rrëfimi i tij përqendrohet te personazhi kryesor, një antihero. Edhe romani i Qosjes integrohet natyrshëm në universin heteroklit të postmodenizmit dhe i jep atij një ngjyrim dhe tingëllim origjinal me elementet atipikë dhe me vështrimin e mistershëm të rrëfimtarit dhe shkrimtarit.

Palimpsest

Nuk është e lehtë të bësh analiza kritike, pa u kthyer disi prapa në historinë e shkrimtarisë sonë që të shohësh pragun apo shkallën e kapërcyer. Sidoqoftë, letërsia një lloj rrezatimi shqiptar, po e quaj, është vazhdim i dritës që lëshojnë brezat paraardhës letrarë, që nga De Rada, Naimi e Pashko Vasa, e duke vazhduar me Migjenin e Fan Nolin dhe më tej me Koliqin, Kadarenë e ndonjë tjetër, dhe një lloj rrezatimi ndërkombëtar me emra autorësh të shekujve të ndryshëm letrarë. Me të drejtë një nga studiuesit e shquar të letërsisë franceze, Gérard Genette e quan krijimin letrar "palimpsest", figurativisht mbivendosje; fjala vetë vjen nga palimpsestus, pergamenë, në të cilin është fshirë një shkrim për të shkruar një tjetër.

Qosja si prozator sa herë që merr penën në dorë, ka një vullnet për t'i përzier gjinitë me qëllime letrare, për t'i ngatërruar perspektivat, dhe madje për të gjetur sekretin e lëvizjes së përhershme që mban gjallë ligjërimin dhe na mundëson ta shoqërojmë leximin e veprës duke shpikur një ligjërim të ri.

Intriga e romanit Të fshehtat e treguara është në të vërtetë shumë më e thellë nga sa duket: mospajtim duke përqeshur që përmblidhet në jetën e një antiheroi të ditëve tona, të quajtur Bardh Dynjaja, një funksionar arkivist dhe përkthyes, pa histori, me një anomali psikologjike tip, që shpalos një jetëshkrim banal.

Autori i shoqëron me buzëqeshje njerëzit që shndërrohen në personazhe dhe tregon se mediokriteti dhe madhështia e rreme janë rrezik real për shoqërinë. Mund ta fillosh romanin ku të duash, sepse të lexuarit e tij është fillim dhe vazhdim, një lloj pesimizmi muzgor dhe ironie të tërthortë, tragjikomedi e rënies së personalitetit.

Proza e Qosjes paraqet shkallë të ndryshme interpretuese duke e vendosur analizën e botës në një teksturë të re rrëfimtare:

"Edhe historia e Tokës ruhet në arkiva.
[...]
O, sa shumë do të doja të isha specie njerëzore e atij trupi qiellor, emri i të cilit ende s'dihet, që do të përshkruante në vepra letrare, do të filmonte në filma artistikë e do të pikturonte në piktura gëzimet e dhembjet, shpresat e dëshpërimet, ngadhënjimet e tokës me njerëzimin e saj të përmortshëm.
Qoftë i përjetshëm emri yt, Tokë!" (f. 42).

Në romanet postmoderne ajo që duket nga afër ose nga larg nuk përbën më një tërësi të qëndrueshme e të rregullt, në kuptimin tradicional. Dhe kjo ndodh se ata i braktisin me qëllim disa lidhje kryesore, për t'i vënë në pah me mungesën e tyre. Megjithatë, në fillimet e vrullshme postmoderne të romanit që në kritikën franceze shënohen si vitet '70 të shekullit të kaluar, parashtesa post u përdor për të treguar gjithçka që lidhej me kulturën pasindustriale e me ultraliberalizmin (liberalizmi i skajshëm), të ardhura nga kontinenti i ri si: post-teori, post-histori, post-ekzotizëm. Në shkrime kritike fillimisht u shmang përdorimi i drejtpërdrejtë i fjalës. Madje një ese e asaj kohe, botuar në një të përjavshme letrare mbante titullin Barbari postmoderniste. Por më vonë disa autorë e akuzuan kritikën si të paaftë për të studiuar ndryshimet themelore në strukturën e prozës. Jean-François Lyotard u dha fund këtyre dyshimeve e hamendësimeve me librin La Condition postmoderne dhe bashkë me Perry Anderson dhe Fredric Jameson, që të tre studiues të shquar të letërsisë dhe kulturës bashkëkohore që vijnë nga tri vende të mëdha të zhvillimit të kulturës dhe letërsisë siç janë : Franca, Anglia dhe Amerika, e kanë shpjeguar postmodernizmin të lidhur ngushtësisht me kontekstin historik të shoqërisë së hapur si një logjikë kulturore, një paradigmë estetike.

Postmoderniteti në letërsi është vëzhguar sidomos te romani, mbreti i prozës, i cili ka fushë të gjerë për ta përdorur transtekstualitetin. Hipoteza që u hodh ishte e dyfishtë. E para: romani postmodern u quajt kapërcyell letrar. Dhe e dyta: romani postmodern u quajt simptomë kalimtare. Në Francë, disa autorë, madje, kundërshtuan të quheshin postmodernë, pavarësisht nga shenjat e dukshme të mungesës së një vazhdimësie klasike të ngjarjes dhe pavarësisht nga përdorimi i citimeve si dhe i elementeve të tjera formaliste në veprat e tyre. Pra, me gjithë ndërtekstin dhe nëntekstin e larmishëm.

Tërë lënda e romanit Të fshehtat e treguara që është pothuajse ana e prapë e realitetit, formon një oksimor me anën e mbarë, të nënkuptuar ose të fantazuar nga lexuesi, ashtu si dhe titulli, dhe kjo përbën një risi në letërsinë shqipe. Megjithatë ky pohim do të merret në mënyrë relative se është e vështirë të njohësh gjithë prurjen në prozë, të paktën në këta njëzet vjetët e fundit, pas rënies së kufizimeve në formë e përmbajtje dhe pas shkrirjes së akujve që krijonte autocensura (vetëcensura).

"Fillo të shkruash! Rrëfe për veten fare pak dhe rrëfe për të tjerët, shumë, për disa tepër të njohur, disa më pak e disa aspak të njohur ende. Mos u sikleto nëse do t'i bëjë të njohur apo të çnjohur rrëfimi yt dhe rrëfimi mbizotërues i protagonistit tënd" (f. 12).

Autori i qaset një forme që e ndryshon lehtësisht drejtimin, madje që të shtyn edhe për hipoteza të ndryshme. Përmes lojës ndërtekstuale ai e ndriçon ndonjëherë tunelin, por edhe peshën e padukshme që rëndon mbi krijimtarinë e një shkrimtari me artin për të pohuar dhe me artin për të mos pohuar, sipas shkrimtarit Samuel Beckett.

Fragmentarizmi

Në veprat postmoderne shkrimtarët i kushtojnë kujdes rrëfimit fragmentar. Fragmenti letrar është shfaqur qysh në Antikitet kryesisht me Karaktere të Teofrastit dhe Fabula të Ezopit, ka vazhduar me Mendime të Mark Aurelit, me fabulat e Lafontenit, me esetë e Montenjit me Karakteret të La Bruyère-it, me fragmentin romantik të shkollës së Ienas, me fragmentin klasik të Francës. Sot, Pascal Quignard, me një vepër nga më të rëndësishmet e letërsisë bashkëkohore franceze, mbahet si mjeshtër i shkrimit fragmentar. Libri i tij Hijet që enden, i kurorëzuar me çmimin më të madh letrar, Goncourt 2002, është botuar edhe në gjuhën shqipe.

Autori i fragmentit dëshiron që teksti i tij të përftojë ngjyrime të shumta, të cilat shkojnë drejt një kuptimi të projektuar. Fragmenti në një farë mënyre kalon mbi kufijtë e gjinive. Është në natyrën e tij të jetë i paqëndrueshëm, i vetvetishëm, ironik. Sipas kritikës franceze ai lidhet edhe me melankolinë, sepse të kujton thyerjen, është një ligjërim me reliev, në të cilin pjesa nënkupton të tërën. Roland Barthes për fragmentin thotë se ai prodhon efektin e një vetëtime që tërheq vëmendjen dhe mbetet në kujtesë. Barthes-i flet edhe për një shkrim imagjinar.

"Imagjinarja e shkrimit" është vënia në përdorim për qëllime stilistike i korrespondencave gjuhësore dhe i shenjave shkrimore si kaligramet, anagramet, këmbimi i shkronjave të drejta e të pjerrëta, i kllapave, i vijave, i vendeve bosh midis paragrafëve... e që formojnë në vetvete një seri shënjuesish të shndërruara në sistem. Qëllimi i autorit është që ta bëjë për vete lexuesin për të hyrë në labirintet e kuptimit të veprës së tij. Ai mund të jetë transpozimi në stil i një bote. Sigurisht, fragmenti në vetvete e shfaq unicitetin e tij me tekstin, kur pasqyrohet brenda një tërësie dhe fiton domethënie duke krijuar marrëdhënie të figurshme apo edhe të thjeshta me fragmentet e tjera të rrëfimit. Ai është edhe një lloj fryme dekadente ku intriga shfaqet në formën e ironisë:

"Dua frymën, ajrin, kur s'e ndien fare, kur s'e sheh fare, kur s'lëviz fare, kur fryn fort, kur bëhet shtrëngatë, kur është valë, kur të zë frymën, kur të merr me vete, kur bëhet shtjellë e të mbështjell si të ishe leckë, si të ishe leckë, që fluturon me të e nuk e di se ku do të çojë - në qiell lart a në tokë thellë! Në xhenet a në xhehenem!" (f. 76).

Të shkruarit e një romani është ajo kohë e çuditshme përpara faqes së bardhë në vetmi, kur bota uturin si një stuhi në largësi. Merret me mend se ai që shkruan jeton me iluzione duke ngritur dekore, duke organizuar mendimin spontan, duke përshkruar emocione. Me anë të fragmentit një autor postmodern arrin të krijojë një botë me fjalët e një subjektiviteti të pastër dhe ndonjëherë lirik të rrëfimtarit, protagonistit, autorit, citimeve nga vepra të ndryshme, që i flasin subjektit. Lexuesi zbulon vazhdimisht territore imagjinare për një gjetiu ose siç e quajnë anglosaksonët hinterland dhe kështu realizohet një vepër e hapur. Autori e vendos subjektin në realitet dhe bashkëbisedimi i heshtur me lexuesin shndërrohet herë-herë në një meditim rreth raporteve tona me botën që na rrethon dhe mbresave të shumta që sjellin vëzhgimet e holla. Si rrjedhim tabloja e pjesshme e një epoke shkrihet me historinë e transfigurimeve që sjell ajo. Kontrasti midis reales së romanit dhe imagjinares së lexuesit sjell ndjesinë e një ëndrre me sy hapur. Dhe kështu arrin të krijohet një moment i jashtëzakonshëm. Lexuesi e imagjinon si rrënohen iluzionet lirike të cilitdo, në një epokë pa ideale të larta njerëzore. Autori dhe narratori bëjnë një pakt për të qenë atje ku nuk i pret. Ata hedhin një vështrim ironik mbi botë, e cila zbulohet nëpërmjet fuqisë së rrëfimit. Protagonisti i romanit tonë, Bardh Dynjaja shfaqet edhe si shkrimtar mediokër, nga ata që krijon përditë mendësia konsumiste, e cila nuk lë që të zhvillohet origjinaliteti, por në më të shumtën e rasteve promovon (përuron) mediokritetin. Ai merret edhe me grumbullimin e materialeve të disa jetëshkrimeve. Ja se çfarë thuhet në njërin prej tyre:

"Garipi ka një fytyrë të rrumbullakët, ndoshta jo bash si topi i futbollit, por si e thonë miqtë e tij si kungulli i Misirit, i ka sytë e mëdhenj, të zinj futë, vetullat e trasha të harkuara bukur lart mbi sytë, si telat e poçave elektrikë..." (f. 254).

Teksti pasurohet me copëzimet stilistike, të cilat mund të vihen re edhe në nëntitujt: Kush sot e kush nesër; Ata që i shkruajnë letra vetvetes; Përpjetë e teposhtë; Këtu e atje, brenda të cilëve lulëzon një ndërtekst i pasur me dialogë e fjalime; me letra e biseda; me kaligrame; me citime nga Martin Luter King, Vargas Losa, Gynter Gras, Filip Rot, Konrad e të tjerë. Kodet e padukshme shndërrohen në të dukshme e anasjelltas. Kufijtë midis imagjinares dhe reales doemos që mjegullohen në një realitet të shformuar.

Autori nuk harron të krijojë edhe një lidhje formaliste me romanin e tij të parë duke përmendur emrin e Xhezairit të Gjikës:

"U zgjova i frikësuar mos do të përsëritet prapë! Ëndrra!

Dhe, mos sundimtari do ta shpjegojë jo si ishte po si do të dëshirojë vetë, për nevojat e veta, ëndrrën time. Siç kishte shpjeguar vetë, siç kishte dashur udbashi ëndrrën e Xhezairit të Gjikës në vitin 1972! (f. 140).

Me një stil të përpunuar Qosja vendos që jetën familjare të protagonistit ta japë nëpërmjet një dialogu të herëpashershëm që shkon deri në fund të tekstit, si një vijë e vazhduar, në të cilën shfaqen përgjithësisht katër anëtarët e familjes Dynjaja, çifti: Bardh / Hava dhe dy fëmijët: Lik / Anila. Stili minimalist i dialogut plotëson kuadrin e jetës intime të protagonistit dhe këtu tërë romani ngjason me një pasqyrë të thyer, sepse duhet lexuar edhe ajo që është e padukshme midis rreshtave.

"NXENESIT
Njëzëri: Për ty mësuese na këndojmë,
Sepse kurrë nuk të harrojmë.
Emrin tënd në zemër e kemi.
Në Europë, në Amerikë kur të vemi.
HAVAJA
Kush, kush ua ka mësuar këtë këngë?
NXENESIT
Njëzëri: Mësuesja Arbnorë. Mësuesja Arbnorë. Mësuesja Arbnorë" (f. 146).

Me një shikim të hollësishëm ky dialog, që sigurisht ka dy funksione: së pari ta bëjë sa më të larmishme formën shprehëse të romanit, por edhe të plotësojë në mënyrë sa më të përmbledhur e më elegante një anë të jetës së protagonistit, është nyjëtim dramatik, domethënë një teatër, me ngjyrime të theksuara komike brenda romanit:

"HAVAJA
E çka s'të bie ty prej dorës?
BARDHI
Nuk ndodh të më bjerë prej dorës gota me ujë, me qumësht apo pjata me sarma! E sidomos alltia!
HAVAJA
E çka megjithatë ndodh të të bjerë prej dorës ty?
BARDHI
Ndodh të më bjerë prej dorës shtatorja e vogël plastike e Haile Selasit (f. 64).

Autori shkon larg në konstatime me prekje të lehta, por që herë-herë bëhen të pamëshirshme. Përfundimi filozofik se ne i ngjajmë shumë epokës, transmetohet në mënyrën më elegante, me ironinë, karakteristikë thelbësore e prozës postmoderne. Në tekst me parashtrimin, në të cilin rrëfimtari flet për qëllimet e shkrimtarit dhe për disa veçori të subjektit, pjesë të veçanta të romanit kthehen në leksion. Pistat, për arsye stilistike këmbehen dhe herë flet krijuesi, herë krijesa e tij dhe herë rrëfimtari. Në tërë lëndën vihet re një forcë vëzhgimi për probleme që nuk u vihet rëndësi në jetën e përditshme. Larja e padukshme e trurit dhe mjegullimi i së ardhmes shoqërohen me idenë e hidhur se koha jonë nuk ka vend për pyetje dhe kjo po kthehet në një sëmundje të pashërueshme. Autori do të donte t'i kontrollonte personazhet e tij, por ata vazhdojnë jetën e tyre "pavarësisht" nga ai.

Sigurisht kritika do të zbulojë në këtë roman një shqetësim letrar dhe një dëshirë për ta bërë lexuesin për të qeshur, por edhe për ta shtënë në mendime. Aty hasen edhe njerëz të vërtetë që shndërrohen në personazhe. Shkrimtari nuk është restaurues (ndreqës) i realitetit. Ai është vrojtues. "Kur gjërat flasin vetë nuk ka ç'bën autori", thoshte Balzaku.

Me një përmbledhje mendimesh prej disa faqesh, kuptohet, nuk mund të përfshihen pesëqind faqe roman, por duhet theksuar se libër pas libri në prozën letrare Qosja si strukturalist e përpunon shumë skemën. Kur ke përpara një subjekt të madh të përbërë nga dhjetëra minisubjekte të hedhura nëpërmjet fragmenteve si një yjësi shumëngjyrëshe, mund të vihet re edhe ndonjë përsëritje në strukturë. Sidoqoftë, vepra të tilla shpesh ngjasojnë me një ëndërrim që synon bashkimin e pjesëve në një të vetme. Këtu qëndron edhe poetika e fragmentit. Romani i Qosjes Të fshehtat e treguara mund të quhet sot manifest i shpirtit dekadent shqiptar në fillimet e shekullit XXI, ashtu siç u quajt dikur romani *À* rebours i Huysmans-it.

P. S.:

1. Rexhep Qosja, në një shkrim të botuar në Gazeta shqiptare e dhjetorit 2020, pyeste dhe pastaj shtronte një ide që duhet t'i shqetësojë kritikët dhe administratën kulturore në Shqipëri. Kur është fjala për të analizuar veprat e letërsisë shqipe, koncepti duhet të jetë gjithëpërfshirës, vepra të shkruara nga shkrimtarët shqiptarë kudo që ndodhen, pra, edhe në Kosovë. Kosovë, Shqipëri, vërtet jemi dy shtete, por jemi një komb. Kuptohet, ose duket saktësuar më tej terminologjia ose duhet ndryshuar struktura e mendimit kritik. Ndonjë kritik letrar e ka të qartë këtë ide, por me një lule s'vjen pranvera.

2. Romanet e Qosjes nuk janë nga ato vepra që kanë kryesisht vlera kombëtare, por ato kanë ngjallur interesin e lexuesve e të studiuesve ndërkombëtarë. Në Universitetin e Venecias, më 11.12. 2020 u bë përurimi virtual i romanit të tij Vdekja më vjen prej syve të tillë, përkthyer në italisht nga Anila Alhasa, profesore dhe përkthyese e njohur e letërsisë shqipe në italisht. Konferencën e përurimit e udhëhoqi profesoresha e Universitetit të Venecias Giuseppina Turano. Në këtë ngjarje morën pjesë edhe Anselmo Roveda, profesor i letërsisë së përgjithshme, i cili ka shkruar pasthënien e librit si dhe Alessandro Scarsela, profesor i letërsisë krahasuese, i cili foli për veçantinë e romanit të përkthyer duke theksuar sidomos karakteristikat e tij postmoderne. Në përurim, ndër të tjerë, morën pjesë edhe dy studente, njëra prej Shqipërisë dhe tjetra prej Kosovës.

Në një vidiokonferencë autori iu përgjigj që nga Prishtina disa pyetjeve që iu bënë prej të pranishmëve.

Kur letërsia shqipe përfiton nga "përkthyesi i padukshëm"

Bisedë e gazetares Mimoza Hasani Pllana me autoren skoceze **MORELLE SMITH**

Mimoza Hasani Pllana

Morelle Smith

E nderuar Morelle Smith, ju jeni shumë i interesuar për letërsinë e popujve të ndryshëm, çfarë ju motivoi për letërsinë dhe gjuhën e popullit shqiptar? Çfarë është e veçantë për këtë letërsi dhe gjuhë krahasuar me gjuhët e tjera në Ballkan dhe Evropë?

Shqipërinë fillova ta njoh përmes jetesës dhe punës aty gjatë vitit 2000. Njerëzit, mënyra e jetesës, peizazhi, të gjitha këto më magjepsën. Si shkrimtare mbaja revista të kohës time në Shqipëri, dhe disa nga vëzhgimet e mia i ktheva në shkrimin fiksion dhe jofiksion për këtë vend. Mua më intereson letërsia e vendeve tjera, sidomos vendeve evropiane, por veçanërisht të një vendi që ishte bërë aq i afërt me zemrën time. Letërsia e një vendi tregon shumë për atë vend dhe njerëzit që jetojnë aty, duke pasqyruar në mënyrë të pashmangshme historinë. Historia e Shqipërisë është e pasur, komplekse dhe e larmishme, me temën, stilin dhe gjuhën e përdorur. Lexova letërsi në gjuhën shqipe aq shumë sa kisha mundësi të përktheja në gjuhën angleze dhe frënge.

M.: *Si i mbani kontaktet me vendet ku flitet gjuha shqipe (Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi? Cili është burimi kryesor i angazhimit tuaj për të ruajtur njohuritë e gjuhës shqipe?*

M.S.: Unë mbaj kontakte me miq shqiptarë, si me ata që jetojnë ose kanë jetuar në vende tjera, veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, dhe ata që jetojnë në Shqipëri dhe Kosovë. Shqipërinë e vizitoj rregullisht dhe gjithmonë kjo është një kënaqësi e imja e madhe. Gjithashtu, kam pasur fatin të jem e ftuar si folëse në konferencat letrare në Tiranë dhe Prizren (Kosovë). Që nga vizita ime e parë në Shqipëri më ka bërë shumë përshtypje aftësia e njerëzve për të folur gjuhë të huaja, (greqisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht etj.), dhe që të përkthejnë nga gjuha e tyre amtare në këto gjuhë. Përkthimi në përgjithësi do të thotë shumë për mua, unë e di që letërsia do të lulëzojë dhe do të përfitojë nga përkthimi, që shkrimtarët në gjuhë më pak të njohura do të fitojnë nga leximi i gjerë, dhe qasja në letërsinë e këtyre gjuhëve në përgjithësi është e dobishme. Qasja në art promovon mirëkuptimin, tolerancën dhe harmoninë e popujve; është më i lehtë komunikimi me forma arti joverbale të tilla si: piktura dhe muzika, por letërsia kërkon këtë përpjekje shtesë përmes përkthimit.

M.: 2. *Gjuha shqipe është unike dhe nuk është e lehtë për t`u mësuar për të folur dhe për të shkruar. Është vlerësuar si e vështirë edhe në procesin e përkthimit. Sigurisht, që në këtë pikë, tanimë ju keni përvojën tuaj, kryesisht në redaktim, meqë keni redaktuar vepra të poetëve e prozatorëve të njohur shqiptarë, si e vlerësoni këtë proces? A është e vështirë të redaktosh poezinë shqipe në gjuhën angleze dhe cila është metodologjia juaj?*

M.S.: Letërsia i detyrohet shumë përkthyesve. Shkrimtari i madh austriak Stefan Zweig ka shkruar për rëndësinë e përkthimit, jo vetëm për sa i përket qasjes që u jep lexuesve, por edhe për vetë shkrimtarët. Përmes sfidës së përkthimit të frazave më idiomatike të një gjuhe tjetër, në gjuhën tuaj të parë, ai thotë se jep një kuptim më të thellë, më krijues të frymës së gjuhës amtare të tij/saj. Po, përkthimi na paraqitet me shumë sfida. Një mik i imi përkthyes më tha se qëllimi i përkthyesit është të bëhet i padukshëm, me fjalë tjera përkthimet më të mira lexohen si origjinale në vetvete. Këto ditë kam kënaqësinë të them se përkthyesit po fitojnë më shumë merita për atë që bëjnë, sepse ata po krijojnë një vepër tjetër arti në vetvete dhe disa çmime letrare për vepra të përkthyera ndahen njësoj midis shkrimtarit origjinal dhe përkthyesit. Sfida kryesore është gjetja e fjalëve ose frazave më të mira, më të përshtatshme në gjuhën që përktheni, të cilat veprojnë më së miri nëse ajo gjuhë është gjuha juaj amtare. Atëherë ju e dini nëse një fjalë është e përshtatshme ose jo, ju i njihni nuancat e fjalëve të ndryshme dhe kur përdorimi i një fjale mund të çojë në paqartësi. Por, një përkthim i mirë kërkon më shumë se rrjedhshmëri në gjuhën tuaj amtare. Gjithashtu, është e nevojshme të kuptuarit e rregullave të gramatikës, strukturës së fjalisë dhe origjinës së fjalës (për shembull shumë fjalë në anglisht kanë origjinë greke ose latine). Folësit në gjuhën amtare angleze i bëjnë disa gabime të zakonshme, të cilat lindin sepse rregullat e gramatikës nuk janë kuptuar dhe ndryshimet në drejtshkrimin e homonimeve nuk janë mësuar. Si mësimdhënës i anglishtes si gjuhë e dytë, unë zbuloj se nxënësit e avancuar të gjuhës angleze mund të kuptojnë më mirë gramatikën angleze sesa disa folës vendas, sepse atyre u janë mësuar rregullat. Por, përveç rregullave gramatikore, përkthyesi ka nevojë të njohë përdorimet idiomatike dhe frazat e gjuhës në të cilën përkthejnë, çka tingëllon mirë, çka është le mot juste (fjala e duhur), çka rrjedhë mirë, pse të shmangni përsëritjet dhe fjalitë e ngathëta ose të avancuara. Leximi i përkthimit tuaj me zë të lartë është gjithashtu një mënyrë e mirë për të përcaktuar nëse ka kuptim dhe rrjedhë normalisht. Përkthimi i poezisë është më i vështirë sesa i prozës, sepse ashtu si për kuptimin e fjalës– dhe nganjëherë mund të ketë më shumë se sa një interpretim – duhet të keni parasysh përdorimet e rimës, ritmit dhe të tingullit, dhe nganjëherë luajtjen e kuptimeve dhe tingujve të fjalëve, dhe asociacioneve të ndryshme. Këtu përkthyesi është më i lirë të përshtatë sipas të kuptuarit të tyre dhe të asaj që nënkupton shkrimtari origjinal, dhe kështu përkthimet e poezisë nganjëherë quhen versione më shumë sesa përkthime të sakta, pasi mund të ketë mundësi të shumta. Por, me redaktimin e poezisë së shkrimtarëve shqiptarë në tekstet e përkthyera tashmë në anglisht, përpiqem të mbajë stilin, siç janë ritmi, gjatësia e rreshtit, përdorimi i shenjave të pikësimit, etj. të të shkruarit. Mua më duhet që të zbuloj se çfarë nënkuptohet me fjalët (mund të ketë më shumë se një kuptim) brenda kontekstit të poezisë dhe nganjëherë duhet të zgjedh fjalë krejt të ndryshme dhe disa shprehje idiomatike

angleze, për ta përcjellë më mirë kuptimin, ashtu si e kuptoj.

M.: *Sipas jush, sa është e njohur letërsia shqipe në Britaninë e Madhe?*

M.S.: Britania në përgjithësi nuk ka regjistrime të mira, me vetëm një përqindje shumë të vogël të librave të botuara që janë vepra të përkthyera. Vendet tjera Evropiane, veçanërisht Franca, botojnë një numër shumë të madh të librave të përkthyera. Por, në vitet e fundit, disa botues të vegjël të pavarur kanë dalë në Mbretërinë e Bashkuar, të përkushtuar për botimin e librave të përkthyer, përfshirë disa autorë shqiptarë. Ismail Kadare është i njohur, por në anglisht ne nuk kemi libra nga Fatos Lubonja, Elvira Dones, Fatos Kongoli, Pajtim Statovci etj. Kam lexuar libra në gjuhën frënge nga Besnik Mustafaj, Bessa Myftiu, dhe Ornela Vorpsi, por kemi kaq pak përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe shumë shkrimtarë të mirë mbeten të panjohur në Mbretërinë e Bashkuar. I ndjeri Robert Elsie i vetëm bëri një punë të mrekullueshme të përkthimit të shkrimtarëve shqiptarë dhe të shkrimit për historinë e Shqipërisë. Për më shumë se dy dekada Dr. Bejtullah Destani ka punuar pa u lodhur, për të sjellë popullin, letërsinë dhe historinë e Shqipërisë në publikun anglishtfolës. Ai më porositi të përktheja Gratë në Lindje (Les Femmes en Orient) të Dora d'Istria's në anglisht dhe përmes hulumtimeve të tij në arkiva të ndryshme, ka redaktuar dhe prodhuar disa libra të lidhur me Shqipërinë dhe historinë e saj si Edward Lear në Shqipëri: Albania: Zhurnali e një piktori të peizazhit, (Journals of a Landscape Painter), Scanderbeu i Harry Hodgkinson, Letrat shqipe të Arthur Evans, (Albanian Letters), Shqipëria dhe shqiptarët të Edith Durham "Shqipëria dhe shqiptarët" (Albania and the Albanians), letrat e Margaret Hasluck etj.

A besoni se konferencat, seminaret dhe tryezat e rrumbullakëta të organizuara në Kosovë dhe Shqipëri janë të domosdoshme dhe se ato ndihmojnë në përkthimin dhe prezantimin e shqipes, letërsisë dhe kulturës në gjuhë të ndryshme botërore?

Konferencat për letërsi dhe tryezat e rrumbullakëta janë të paçmueshme për të bërë letërsinë shqipe më të njohur për një botë më të gjerë dhe formojnë një mjet të domosdoshëm që shkrimtarët e kombësive të ndryshme të bashkohen për të njohur më mirë punën e njëri-tjetrit. Përmes takimeve të tilla bëhen lidhje, formohen lidhje dhe miqësi që qëndrojnë në kohë. Takimet publike janë jetike, për vet shkrimtarët (të shkruarit është një profesion aq i vetmuar) dhe për të ndarë mendimet dhe punën e tyre, gjë që do të çojë në bashkëpunim midis tyre, në publicitet dhe në vepra të përkthyera dhe të botuara.

A mund të flasim për projektet tuaja aktuale që ndërlidhen me letërsinë shqipe?

Aktualisht jam duke punuar në përkthimin /redaktimin e një teksti tjetër nga Dora d'Istria, transkriptimin dhe redaktimin e më shumë letrave të Edith Durham, dhe transkriptimin dhe redaktimin e eseve nga Harry Hodgkinson (në M Edith Durham, dhe udhëtimet i saj në 1936 përgjatë bregdetit Adriatik në Shqipëri).

MORELLE SMITH ka botuar disa libra me poezi, prozë, ese. Ajo ka punuar në Ballkan si mësimdhënëse e gjuhës angleze, organizata humanitare. Ajo ka fituar disa çmime si "The Audience Award" në Terra Poetica Festival në Ukraine, 2014), the Autumn Voices Competition (2017), dhe ka qenë nominuar për Pushcart Prize (2018). dhe vepra e saj është përkthyer në frëngjisht, gjermanisht, shqip, rumanisht, kroatisht, si edhe në bullgarisht.

Në gjuhën shqipe Morelle Smith është e njohur vetëm me librin e saj me tregime "Rrugët e Tiranës prag pranvere", botuar nga shtëpia botuese "Ora", Tiranë, 2004.

MINIATURA
nga Shazim Mehmeti

PA FRIKË

Pa frikë. Pa fare frikë.

Ç'prej se e ka hedhur hapin në jetë, ai bën përpara. Siç bën përpara çdo krijesë e gjallë e mangët. Siç bën përpara çdo krijesë e gjallë e mangët sa një njeri. Mangësia e bën të lumtur. Mangësia e bën të shohë larg, larg përpara tij, pa i shkuar mendja aty afër, një hap përpara vetes, aty ku e ka fundin.

S'e shihni, ë? Ai ecën pa frikë, pa fare frikë! Sepse është i mangët dhe i lumtur, sepse nuk e di se jeta është një varr lëvizës që gjithëherë të rri një hap përpara këmbësh.

1995

ZËRI I JETËS

Ai sapo ndjeu prapa vetes një zë. Ktheu kokën prapa, por kot. S'pa gjë, përveç hijes së vet që i nisej nga thembrat dhe i mbaronte tutje.

Teksa ndërdyshej për këtë, prapa vetes një tjetër zë i erdhi. I njëjtë me atë të parin, si i dalë nga e njëjta gojë. Ai ktheu kokën prapa, lëvizi dhe këmbët për një çast, u ndal. S'pa gjë, përveç hijes së vet që i nisej nga këmbët dhe i mbaronte tutje.

Ai akoma ndërdyshet, por s'mund të mbarojë. Zëri i jetës gjithandej e përplas me shpejtësi maramendëse, pa e lënë të kuptojë për hiçësinë që i ndodh.

Unë e di: ky njeri, një ditë do të vdesë i pikëlluar. Dhe zëra e zëra do t'i vihen prapa për t'i thënë, se sa me fat qëlloi që jetoi i paditur. Por, do të jetë vonë: Ai, as do t'i dëgjojë...

1995

PASQYRAT

Nuk di si, por atë mëngjes qëndrova pak më gjatë para pasqyrës. Kisha fytyrë të bukur. Kisha fytyrë çuditërisht të bukur, dhe e prekja me gisht. Vetullat si dy harqe, më binin përposhtë ballit pa asnjë defekt. Sytë e mbushur me një masë të përzjarrtë, më shikonin si asnjëherë më parë. Faqet, veshët, hunda, me një gjallëri të përpiktë ma stolisnin fytyrën. Buzët, goja... Goja?...Goja u hap për një çast, ma këputi gishtin!

Pa masë ndjeva dhembje, por kjo lojë për mua qe joshëse çuditërisht, sa ngrita gishtin tjetër dhe e vura mbi ballë. Preka vetullat, që si dy harqe më binin përposhtë ballit pa asnjë defekt. Preka sytë e përmbushur me një masë të përzjarrtë që më shikonin si asnjë herë më parë. Preka faqet, veshët, hundën, që me një gjallëri të përpiktë ma stolisnin fytyrën. Preka buzët, gojën... Gojën?... Goja që për një çast u hap, ma këputi gishtin tjetër.

Si i humba dy gishta u zjarrmova edhe më.

Preka fytyrën me gishtin e tretë dhe e humba!

Preka fytyrën me gishtin e katërt dhe e humba!

Preka fytyrën me gishtin e pestë dhe e humba!

Preka fytyrën me të pesë gishtat e dorës tjetër dhe i humba!

Gjaku më rrodhi curril.

Tashti që ora ra, unë ngris kokën ta rishoh fytyrën time në pasqyrë. Por, shoh një fytyrë tjetër që largohet prapa saj, kurse qelqi shfaqet përballë meje i vdekur dhe i akullt. E kam të qartë se është vonë, se është tepër vonë, ndaj kot së koti vetëveten e pyes: Kush i shpikë këto pasqyra që na hanë?!...

1995

QENKËLYSH

Këtë krijesë, për herë të parë e takova te varret. Një pasdite janari, kuptohet, derisa rregulloja ca gurë mbi varrin e tim gjyshi. Më erdhi prapa veshi si një zë, ose më mirë të them, si një cingëllimë. Ishte një cingëllimë që pushoi, kur ktheva kokën dhe e pashë. Rrinte ulur mbi këmbët e mbrame dhe më shikonte drejt në sy, pa asfarë ngurimi.

U përkula, mora një guralec mbi varr dhe provova ta qëlloj. Por, çuditërisht, dora m'u ndal dhe kafsha buzëqeshi.

(vijon në faqen 17)

Absurdi i politikës në vëllimin "Prill i hidhur" të poetit Bardhyl Londo

nga Kujtim Mateli

Poezia e Bardhyl Londos ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e lexuesit, jo vetëm për librat që ka shkruar në këto vitet e fundit, por për krejt krijimtarinë e tij. Lexuesi dhe kritika letrare kanë qenë vazhdimisht të interesuar. Tashmë kemi nëpër duar librin e tij më të fundit poetik "Prill i hidhur", hedhur në treg nga Shtëpia Botuese "Onufri".

Poezia e Bardhyl Londos është realiteti në të cilin jetojmë, realiteti që prekim dhe e përjetojmë çdo ditë, prej të cilit provojmë gëzimet apo hidhërimet, është realiteti i botës shqiptare që ne trashëgojmë nga njëri brez në tjetrin, me shpresën dhe dëshirën për ta ndryshuar në të mirë të familjes dhe të shoqërisë sonë, por jo kurdoherë kemi arritur atë që kemi dëshiruar. Shkrimtarët dhe artistët kërkojnë ta pasqyrojnë në veprat e tyre për të komunikuar natyrshëm me brezin e tyre, por dhe për brezat që vijnë. Ndërsa shumë autorë realitetin shqiptar e kthejnë në vepra artistike duke u pozicionuar nga një pikë kulmore e kategorisë estetike të së madhërishmes, Bardhyl Londo është pozicionuar në krahun e kundërt të kësaj pike, nga ku vështron shoqërinë shqiptare që, në një pjesë të rëndësishme të rrugëtimit të saj, është endur brenda rrathëve pa dalje të absurdit. Që në fillimet e krijimtarisë së tij, ndërsa shumë shkrimtarë dhe artistë shikonin suksese dhe parada suksesesh, Bardhyl Londo shikonte absurditetin e politikës së kohës, paradoksin e këtyre sukseseve.

Kjo prirje e tij për të depërtuar në thellësi të fenomeneve të shoqërisë, e bëri poetin Bardhyl Londo, që në fillimet e krijimtarisë së tij, mik të lexuesit të zakonshëm dhe të padëshiruar për pushtetin e kohës. Ky libër është një arritje e kësaj prirjeje artistike e cila zbulon se qenia njerëzore, kur ndjen rrezikun e ekzistecës së vet, futet për t`u mbrojtur në rrathët e absurdit: "qesh kur duhet të qajë, duartroket kur duhej të protestonte."

Ky pozicionim i autorit ka ardhur natyrshëm për të parë ato dukuri shoqërore dhe politike që nuk e lartësojnë shoqërinë shqiptare, madje e vendosin në kuota që asnjë shqiptar nuk do t`i dëshironte. Për t`i pasqyruar artistikisht këto dukuri të shoqërisë sonë, autori ka sjellë dy figura të njohura historike: Gjergj Kastriotin dhe Hamza Kastriotin. Deri më sot i kemi parë si dy figura të kundërta që e përjashtojnë njëra-tjetrën. Skënderbeu, Heroi ynë Kombëtar ka frymëzuar të gjithë brezat nga koha e tij deri në ditët e sotme, kurse Hamza Kastrioti përfaqëson figurën e tradhtarit me emrin e të cilit janë damkosur të gjithë ata që kanë bashkëpunuar me pushtuesit.

ABSURDI I PARË

Te poezia "Skënderbeu" jepen përmasat e tij reale si figurë historike. Përballë kësaj figure madhore, ne pasardhësit e tij, ishim të rrënuar ekonomikisht dhe fizikisht, qenia jonë ishte e drobitur, kurse shpirtërisht ndodhej në mjegullnajën e netëve mitologjike.

Në këtë hapësirë gjeografike dhe shpirtërore të atdheut tonë, poeti zbardh paradoksin që ekzistonte në jetët tona. Në vend që të ishim vazhdimësia e Heroit tonë, ishim kthyer e kundërta e tij. Absurdi përcaktonte ekzistencën tonë fizike, i kishte dhënë formë botës sonë shpirtërore.

Në sheshe, stadiume apo tribuna e kishim vendosur statujën e heroit tonë jo për të lartësuar historinë tonë kombëtare, por për veten tonë. Historia ishte rrudhur deri në skajin më fundor, aty ku ndodheshe Ti dhe Unë. Sa më lart në shkallët e pushtetit, aq më e madhe hipokrizia. Ishim qenie fatkeqe që lëviznim brenda rrathëve të absurdit për t`u bërë të famshëm nga mundësia që kishim për të qenë sa më pranë Heroit në mitingje apo kuvende. Sa më shumë na jepej mundësia për të qenë pranë bustit të Heroit tonë Kombëtar, aq më i shpërfyturuar dukej portreti fizik dhe moral.

Nga busti i heroit kumtohej për publikun bashkimi, kurse nga klounët e tribunave kumtohej përçarja nëpërmjet luftës së klasave.

Nga busti i heroit kumtohej dashuria për njëri-tjetrin, kurse nga klounët e tribunave kumtohej urrejtja klasore.

Nga busti i heroit kumtohej mirësia për njëri-tjetrin, kurse nga klounët e tribunave përbuzja klasore. Ligjërues dhe dëgjues, në të njëjtin mjedis: të ndarë në të mirë dhe të këqij, në atdhetarë dhe tradhëtarë, në komunistë e kulakë. Ecnim bashkërisht brenda rrathëve të mjerë të absurdit: dikush kokëlartë për merita që nuk i meritonte, dikush kokëluar për faje të pabëra. Si shenjë besnikërie për popullin e vet, klounët e rregjimit përdornin figurën e Heroit tonë Kombëtar:

"Të thurnim këngë./ Në të vërtetë,/ i bënim hosanara vetes,/ mezi prisnim përvjetorët e tu/ që të lartësonim deri në qiell veten."

Ky rit vazhdon ende edhe sot. Në forma të ndryshme, ëndërrojmë që t`i afrohen figurës së Skënderbeut, por ndodhen shumë larg prej tij.

Poezia "Skënderbeu" e Bardhyl Londos ka origjinalitet të spikatur që e dallon qartë nga dy mijë krijimet artistike dhe veprat e artit që janë krijuar për të deri në ditët e sotme, të cilat e kanë vlerësuar si simbol i qëndresës dhe i lirisë. Poeti duke e vlerësuar figurën e tij madhore na jep raportet e tij me pasardhësit e vet të trojeve arbërore deri në ditët e sotme.

Pasardhësit e tij, fatkeqësisht, duke iu shmangur cilësive të tij të larta në disa segmente kohore të historisë sonë, kanë rrëshqitur në vorbullën e absurdit duke e zëvendësuar qëndresën skënderbejane me nënshtrimin, kurse lirinë me robërinë, edhe kur popujt e tjerë të Ballkanit u shkëputën nga perandoria otomane.

Edhe pas Shpalljes së Pavarësisë, absurditeti shqiptar u thellua më tej duke e parë përçarjen nëpërmjet luftës së klasave, si bashkim. Ky absurditet, ende vazhdon në ditët e sotme, ndonëse shoqëria shqiptare ka bërë shumë për të dalë nga vorbullat e absurditetit duke ecur drejt rrjedhave normale të bashkësisë evropiane. Mirëpo segmentet kohorë të absurdit në historinë dhe jetën e një populli janë segmente të vdekur ku shoqëria ka ngecur në vend. Segmentet kohorë të absurdit, në historinë e popullit shqiptar, janë më të shumtë se ç`mund të prodhojë jeta reale njerëzore. Poezia e Bardhyl Londos është thirrje që shoqëria shqiptare të mos e përsërisë kurrë të shkuarën e saj të hidhur.

ABSURDI I DYTË

Poezia "Hamza Kastrioti" është një tjetër poezi ku shpaloset absurdi që ekziston në shoqërinë shqiptare. Hamza Kastrioti, nipi i Heroit tonë Kombëtar, ka përfaqësuar tradhëtarin, njeriun e pabesë që ka bashkëpunuar me pushtuesit osman kundër Skënderbeut, për t`u bërë trashëgues i fronit dhe vasal i pushtuesit. Me këtë imazh u edukuan brezat deri në ditët tona për të damkosur tradhëtarët, sa herë ata shfaqeshin në krahë të pushtuesit apo bashkë me pushtuesin kundër vendit të tyre:

"Herë na shfaqeshe/ si qen i ngordhur në Sfetigrad,/ herë vërtiteshe si fantazmë e frikshme/ në kalanë e Beratit,/por asnjëherë askujt s`i the një fjalë."

Po absurdi qëndron në faktin se sa herë, kur dikush kërkonte të rrëzonte dikë për t`u ngjitur në vend të tij, bëhej edhe ai vetë Hamza. Periudha e diktaturës është e mbushur me shembuj se si ai që indentifikohej me Skënderbeun, i shihte ata që i kishte në oborrin e vet si hije të Hamza Kastriotit apo dhe vetë Hamzain. Pak nga pak kjo ndjenjë se kishte rrotull një Hamza që përpiqej t`i rrëmbente fronin u shtri në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, nga qendra në rreth, si dhe nga rrethi në bazë, pra në çdo qytet dhe fshat të Shqipërisë. Kryeqyteti, qytetet dhe fshatrat kishin Hamzain e tyre. Hamza ishte cilido që shihej i mundshëm të zëvendësonte në fron të parin e njësisë administrative:

"Vonë e kuptuam:/ duke u marrë me hijen tënde,/ ne merreshim me veten." Absurditeti i të marrit me veten vazhdon deri në ditët e sotme. Absurditeti se në shoqërinë shqiptare do të ketë kurdoherë një Skënderbe dhe një Hamza dhe në veçanti në politikë, ka bërë që ndërrimin e qeverisjes në ditët e sotme ta shohin jo si alternativë që ta jep demokracia, por si forca e dhunës dhe për këtë kërkojnë dhe ndihmën e kancelarive të huaja.

" Vonë e kuptuam,/ti ishe vetë ne,/ne ishim ti." Të kuptuarit e demokracisë në mënyrë absurde, të kuptuarit e demokracisë si raport Skënderbe-Hamza, ka bërë që ata që i shembëllenin Hamzait të ishin të shumtë në shoqërinë shqiptare:

"Emri yt, më i madh se zjarri/ që shkrumboi Bibliotekën e Aleksandrisë,/ na digjte të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen."

Edhe sot, poezia "Hamza Kastrioti" vazhdon të jetë guri i rëndë në qafën e politikës shqiptare.

ABSURDI I TRETË

Absurdi i tretë qëndron ndaj atyre që dhanë jetën për atdheun. Për princat, rapsodët ngrinin këngë. Ngriheshin varre madhështorë, kurse monumentet lartësoheshin buzë rrugëve kryesore. Mijëra të



rënë në fushë të betejës përmblidheshin nën emrin e përbashkët: "ata". Ata që ndalën me gjokset e tyre sulmet e armiqve. Po ku janë ata? Mbetën brinjave të maleve nën akullin e ftohtë të dimrave apo luginave të lulëzuara ku s`gjendet një dorë t`u vendosë një tufë me lule mbi krye. Kujtohemi për ta kur ecim grykave të ngushta të luginave:

"të vetmuar në muzgun e vonë,/ një nga eshtrat tuaja ndodh të dalë nga toka,/ një eshtër çengel të varim ndërgjegjen tonë."

Po absurdi i kapërcen kufijtë e vet dhe në një marramendje kolektive bëhemi të gjithë pjellë e tij. Në vend që të ndërtojmë varreza për të rënët tanë, ndërtojmë varreza për të huajt, për pushtuesit, për vrasësit e të parëve tanë:

"Dhe përralla vazhdon. E pamëshirshme, e hidhur./ Për ushtarët e huaj vëmë pllaka, ngremë lapidarë./ Vetëm ju dergjeni të huaj në tokën tuaj,/ Të heshtur, të pazëshëm si më parë."

ABSURDI I KATËRT.

Poezia "Një lumë mespërmes qytetit" tregon absurditetin e kohës që jetojmë. Mendimi ynë absurd, i shoqëruar nga veprime absurde, ka bërë që një lumë të shpërfytyrohet deri sa të humbasë identitetin e vet: tani lumi është kthyer në një kanal që mbart ujërat e zeza të qytetit. Tani lumi është tjetërsuar dhe:

"... nuk figuron në asnjë hartë të botës/... nuk e përmend asnjë atlas gjeografik." Vetë ne, me duart tona dhe mendjen e ndryshkur, e kemi vrarë atë. E vrasim përditë sapo prek me kaltërsinë e tij periferinë e qytetit. Rrjedha e tij e kaltër njolloset e nxihet nga llumi i ndërgjegjes sonë. Tashmë, i vdekur dhe i kthyer në një kanal, askush nuk ka parë në rrjedhën e tij:

"... qoftë dhe një lloj peshku/ që mund të gjallojë brenda tij,/ madje thonë se askush nuk ka parë/ qoftë dhe një bretkosë sykërcyer."

Absurditeti ynë ka bërë që ta vrasim nga pak përditë vetveten duke vrarë natyrën e bukur, shpresën tonë të ringjallur, besimin tonë që përtypet në nofullat e egra të absurdit. Nuk dimë të sillemi jo vetëm me njëri-tjetrin, por dhe me lumin e vetëm që kalonte dikur mepërmes qytetit tonë, i dehur nga bora e bardhë kur shkrinte majave të maleve. Ishte dikur, kurse sot është :

"I dënuar të mos provojë delikatesën e një pulëbardhe/ Sipër trupit të tij ujor,/ Por vetëm pllaquritjet/ E minjve të gjirizeve."

Absurdi i kohës sonë. Në vend që syri i lodhur të çlodhej mbi valët e kaltra të valëve, zemë hundët me dorë dhe ndjekim njëri-tjetrin në vrapin e një të marri. E vramë lumin e vetëm të qytetit tonë për të përcjellë në brigjet e shekujve marrëzinë tonë kolektive dhe që nipat e mbesat tona në vend të krenarisë, do të ndjejnë keqardhje: Sa të paaftë! - do të thonë.

ABSURDI I PESTË.

Ndodh që në momente të caktuara e gjithë shoqëria të futet brenda rrathëve të absurdit, si një strehim ndaj një fatkeqësie që i ka ardhur së jashtmi. "Kovid 19", kjo sëmundje që u përhap në çdo kontinent dhe nuk la pa prekur asnjë shtet të botës, i dha çdo populli fatkeqësi duke e mbyllur brenda në shtëpi një pjesë të mirë të kohës gjatë 24 orëve. Në këtë mbyllje globale, Shqipëria pati veçoritë e veta.

Tek poezia "Qyteti i karantinës" është ndërprerë jeta njerëzore, më shumë të vdekur se sa të lindur: "Këtu rrugën e maternitetit e ngatërrojnë, të varrezave e gjejnë symbyllur."

Planetet kanë ndryshuar krahun e lëvizjes : " Në këtë qytet, dielli lind më mbrëmje dhe perëndon në agim."

Liria e ka humbur kuptimin e saj si liri fizike e qenies njerëzore: "Këtu burgun e quajnë liri dhe lirinë burg."

Në këtë qytet, karantina i ka ngujuar brenda mureve të shtëpisë dhe dita nis ndryshe: "këtu flenë gjithë ditën, natën bëjnë punët e shtëpisë."

Kanë harruar ritet e besimit fetar: " Këtu të krishterët falen në xhami, myslimanët në kishë."

Ky qytet i mbyllur në burgun e karantinës, ka ndryshuar natyrën e banorëve të saj: "Këtu çmendinën e kanë disko dhe diskon çmendinë." "Këtu merren vesh me gjithë botën, njëri-tjetrin s`e kuptojnë kurrë."

PËRFUNDIM

Vëllimi poetik "Prill i hidhur", shënon një tjetër pikë kulmore në krijimtarinë e Bardhyl Londos prej nga ku vështrohet estetikisht realiteti shqiptar në të gjithë dimensionin e vet historik e kulturor, politik e shoqëror, shpirtëror e material, filozofik e fetar, prej nga ku përfitohen krijime poetike të një niveli të lartë artistik, ku secila prej tyre, me një bukuri të pashoqe, vrapon për të gjetur lexuesin e vet. Këmbëshpejta poezi e Bardhyl Londos është e kudondodhur: sa në çantën e emigrantit që lë aeroportin e Rinasit dhe mësyn qiejt e botës, aq dhe në katedrat e universiteteve ku profesorë dhe studentë zhyten në universin londian për të zbuluar misterin që e bën poezinë e tij kaq familjare me lexuesin. Shumë poetë komunikojnë me lexuesin nëpërmjet vëllimit poetik, kurse Londo komunikon me lexuesin nëpërmjet çdo poezie duke krijuar ura komunikimi që kanë mbetur dhe do të mbeten të përjetshme.

Poezitë e Bardhyl Londos që lidhen me absurditetin e politikës shqiptare janë poezi që reflektojnë përjetime të thella të autorit mbi realitetin shqiptar, përjetime që i kanë shkaktuar dhimbje dhe zhgënjime gjatë gjithë jetës së tij. Ato nuk kapin vetëm harkun kohor të jetës së autorit, por shtrihen përgjatë gjithë historisë së popullit tonë, sidomos të këtyre dy shekujve të fundit. Ky përjetim i thellë dhe i gjithanshëm, ka bërë që nga pena e tij të dalin krijime brilante që i kanë dhënë letërsisë shqipe krijime të krahasueshme me perlat e letërsisë botërore, që janë bërë pjesë e strukturës së kësaj letërsie të këtyre dy shekujve të fundit.

(vijon nga faqja 15)

Ka ca vite që më ndjek ajo krijesë, ashtu butë dhe sjellshëm, ndaj ka filluar të më pëlqejë. Është krijuar një si harmoni mes nesh, që na bën ta kërkojmë njëri tjetrin. Nuk është qen, nuk është këlysh. Është i verdhë, i hequr dhe i hollë. Është përherë i urritur. Ka tri këmbë të shëndosha dhe një të thyer që e tërheq zvarrë. Ka bisht të gjatë të bardhë, që e mban lëvarur përtokë, si një përtokëzim që e shpëton nga përqiellzimet e mundshme. Është as qen as këlysh.

Është qenkëlysh, dhe banon te varret.

1996

QENÇE

Ka rënë një mjegull e dendur dhe e rëndë. Qielli që është i trishtë, e kullon atë pak shpirti të mbetur përmes një shiu të imët dhe të ftohtë. Natë është, asfarë zëri s'dëgjohet. Dëgjohet vetëm rapëllima e çizmeve të mia, teksa shkeli pamëshirshëm mbi qentë e vrarë që kanë mbushur rrugët. Tashmë gjithçka është e qartë, beteja ka mbaruar. Qyteti ka fituar mbi qentë e vet. E dëshmojnë këtë edhe fotografitë e shumta të heronjve të gjallë që më buzëqeshin nga vitrinat e dyqaneve. Kuptohet, u buzëqeshem edhe unë, por, se si trishtohem më një çast teksa hetoj se më buzëqeshin qençe!...

«Mjerë qyteti», them dhe bëj një të vjellë në mjegull. Seç më vjen që më shumë t'i nderoj qentë e ngordhur se heronjtë e gjallë!...

MANÌ

Jam bërë si kasapët. Gjithnjë mbaj ndër duar ndonjë mjet që është i përshtatshëm për vrasje. Ky trekëndësh, për shembull, që më shërben për të bërë projektimet, por që ka ca maje të mprehta spic. Ky kompas, i dedikuar për rrathë koncentrikë, por që është kaq i përshtatshëm për një vrasje. Kjo thikë, që ditën e mbaj në xhep, e natën nën jastëk.

Por ama, nga të gjitha këto mjete, kam përdorur vetëm një laps. Me te, sa herë më rrotullohet ndonjë merimangë, e godas. E godas për vdekje, dhe si një maniak, e marr ndër duar, e vë në pjatën mbi tavolinë. Pjata ime është prej letre, dhe merr sa të duash merimanga. Prandaj, godas edhe një tjetër, edhe një tjetër, derisa pjata mbushet përplot.

Kah mesnata, kur lodhem së gjuajturi e uritem si një kafshë, i marr të tërat dhe i ha. Sado i hollë qoftë një krah merimange, nuk e lë pa ngrënë. Çuditërisht, bëhem rehat vetëm pasi i ha të gjithat. Nuk ka përmasë që më dekoncentron nga kënaqësia e ngrënies. Merimangat janë ushqimi im i preferuar i mesnatës...

1996

MAJAT

Ta themi qysh tani. Tri lloje njerëzish ka:

– njerëz torollakë, që janë të shumtë;

– njerëz më pak torollakë, që janë mesatarisht të shumtë;

– dhe njerëz të paktë, që s'janë aspak torollakë.

Të parët, për të cilët që në fillim thamë se janë torollakë dhe s'u bie ndër mend për majat, janë të prirë të hanë e të pinë, të flasin e të qeshin, të mos ankohen fare, madje as të mos qajnë edhe atëherë kur rëndohen nga një gravitacion i çuditshëm shpirtëror.

Të dytët, që janë më pak torollakë e mendja u pjell për majat, por që çuditërisht, përpara u del një pengesë që s'mund ta përballojnë, dhe, sipas një gravitacioni të çuditshëm shpirtëror, bien e ngriten të këputur, pa arritur kurrë të prekin një majë.

Të tretët, që s'janë aspak torollakë, fare lehtë arrinë tek majat, por e kanë të vështirë të qëndrojnë më gjatë, sepse, sërish sipas një gravitacioni të çuditshëm shpirtëror, trupat u rëndohen përposhtë dhe të zinjtë e ullirit heqin për t'u mbajtur atje lart.

Kur e bëri këtë lloj klasifikimi, zoti bëri mëkat, sepse siç e shihni edhe vetë, vetëm të parët janë të lumtur.

1995

BOSH

Një natë janari, në njërën nga dhomat e fjetjes së shtëpisë së tij mondane, mbase në ëndërr, iu fut në shtrat AJO: e re, e ngrohtë, e dashur, e këndshme, gjithë aromë...

«Oh, zemër», bëlbëzoi në gjumë ai, dhe zgjatoi trupin ta përqafë. Por duart i mbetën bosh, aq sa u ngrit në këmbë dhe filloi të thërriste si i çartur nëpër dhomë... «zemër!,... zemër!,... zemër...!», ndërkohë që boshësia e dhomës s'i përgjigjej, po vazhdonte të heshtte si ngaherë: e errët, e lagësht, e ftohtë,... e vdekur si vetë AJO!

1998

DILEMË

Dal i menduar. Në një kënd rruge, sytë sikur më zënë një njeri të shëmtuar. E në po atë kënd rruge më fiksohet një vajzë, e bukur pa masë, e veshur me një robë mëndafshi paksa të shkurtër dhe të bukur mrekullisht. Mban në dorë një tufë lulesh, që janë me gjasë, karanfila të kuq. Është si e magjepsur pas atij njeriu të shëmtuar (sytë e saj të ndezur flasin për këtë), zgjat duart e bardha e mundohet t'i japë një karafil, në çastin që ai i vë duart mbi supet dhe e shtyn me forcë, e flak me përbuzje si një leckë në trotuar. Vajzës i përgjaken gjunjët, qan me lotë, ngritet, i hidhet në qafë me gjithë trup, dhe si e çartur klith: të dua, të dua, të dua!.., ndërkohë që unë tmerrohem, kthej kokën në tjetër anë, i shkoj prapa hapit tim dhe vras e vras mendjen duke u munduar të kuptoj, nëse vërtet e pashë këtë pamje makabre, apo vetëm isha i menduar si ngaherë ?!...

1998



RRUGA E GJATË

tregim nga

AJKUNA DAKLI

- Nuk kam gjë jo, mirë jam, – zëri nga ana tjetër e botës dukej shumë i lodhur.

- Nëse nuk je mirë më thuaj, – u përgjigj ajo, – që të vij.

- Është rrugë e gjatë – tha ai në një formë retorike pa ia aprovuar po as mohuar mundësinë e ikjes.

- Më thuaj të vërtetën, si je?

- Mos u bëj merak, – tha ai. - Kështu e ka kjo puna ime tani. Pleqëri hesapi.

- Mirë atëherë. Tani po nisem për punë po do të të marr prapë më vonë. Të puth fort!

- Mirë, – tha zëri po aq i drobitur,- të puth edhe unë. Puthi fëmijët.

Është rrugë e gjatë, mendoi ajo me mollëzën e gishtit mbi qarkun e kuq mbi celular. Kush e mendonte që 7,595 km mund ta komplikonin jetën kësisoj?

Kur kishte ikur i qe dukur me të vërtet larg. Sikur nuk do ta shihte më kurrë atë copëz dhé që kishte lënë pas. Kthimi i parë iu kishte dukur si ëndërr. Ishte me fëmijën e saj të parë motak të cilin ai nuk e kishte parë akoma. Ca nga të qarat e fëmijës në avion dhe ca nga llomotitjet e siçilanit ngjitur, që mundohej ta ndihmonte, nuk e kishte kuptuar si ishte gjendur në Romë.

Në Rinas gjithë ai burrë i madh që mundohej të mbante veten, ia kishte marrë fëmijën nga krahët, duke e mbajtur si të ishte prej kristali me frikën se mos i thyhej. Ajo e kishte parë paksa e çuditur dhe kishte qeshur me të, babush bëhu trim i kishte thënë, ti je marrë me fëmijë gjithë jetën.

Më pas kjo vajtje-ardhje ishte bërë zakon, diçka që e priste me padurim gjithë vitin. Nuk dukej më aq larg. Vetëm tetë orë në një kabinë avioni, gjysmë përgjumësh, një tjetër aeroport krejt i ndryshëm nga ai që kishte lënë pas, një orë tjetër në një kabinë tjetër avioni ku gjuha e saj flitej e përzier me gjithfarëlloj gjuhësh të tjera dhe ja ku ishte ai gjithnjë duke e pritur në aeroport. Sikur ishin ndarë një ditë më parë. Ca ditë që iknin më shpejt sesa kishin ardhur, një pritje tjetër njëvjeçare që dalngadalë kishte filluar gjithsesi ta humbiste atë ngjyrën e padurimit. Rruga po bëhej diçka si zakon madje deri diku, po këtë ajo nuk ia thoshte kurrë vetes, edhe bezdi.

Jeta ishte e shpejtë kësaj ane të oqeanit, koha e çmuar, pushimet të shkurtra.

E mbërtheu një gulç pasigurie. Kishte kaluar vetëm një orë nga biseda po vendosi t'i binte celit të tij prapë.

Zëri nga ana tjetër i kumtoi se ai sapo ishte shtruar në spital. Pati një keqësim të papritur po tani është më i qetë. Të nisem, pyeti ajo prapë. Nuk di ç'të të them, i tha zëri, është rrugë e gjatë. Merr pas ndonjë ore.

Rrugë e gjatë. Sa e gjatë duhet jetë rruga që të bëhet e pamundur për t'u marrë mendoi dhe kush e ndan këtë dreq kufiri?

E dinte që nuk do ta kishte fort të lehtë të merrte leje në punë dhe nëse merrte leje dhe shkonte kot nuk merrte dot leje kur.....

Ndaloi befas në rrugë pak hapa para qiellgërvishtësit ku punonte, shkroi me ngut një mesazh dhe u kthye nga erdhi. Të gjithë avionët për Tiranë niseshin pasdite dhe nëse shkonte herët në aeroport, mund ta gjente një biletë për atë natë.

.....

Kur kaloi pikën e fundit të kufirit ishte vonë. Në anën tjetër të oqeanit nuk duhej të kishte zbardhur akoma po ajo e formoi edhe njëherë numrin me shpresë se ai mund të ishte zgjuar dhe lajmi i ardhjes së saj do t'i bënte mirë.

- Babai po fle, – nga ana tjetër iu përgjigj prapë zëri i një të afërmi. – Po duket si më i qetë.

- Thuaj që po nisem, – tha ajo. – Kam një ndalesë të gjatë në Romë, po nga darka do jem aty.

- Patjetër, – tha zëri. – Udhë të mbarë!

Mbërtheu rripin e sigurimit ndërsa avioni u ngrit dhe u ndie më e qetë. Të paktën po shkonte. Sido që të vinin punët do ishte aty. Duhet të ishe nisur më parë, i tha vetes.

Shëndeti i tij kishte disa vjet që lëkundej me ca rënie të forta po pastaj ai e merrte veten prapë. Kishte rënë shumë gjithsesi. Kur u ndanë herën e fundit ai nuk pati fuqi ta përcillte në aeroport si zakonisht. E përcolli deri te porta e shtëpisë së madhe dhe kur e përqafoi, asaj i ngeli në krahë ndjesia e shpatullave të gjëra të përkulura si një parzmore e fortë kockore e lodhur tashmë nga gjithë betejat e tij të humbura për të cilat ai nuk fliste kurrë. Po ai është si një ushtar i paepur, mendoi ajo, që do luftonte deri në pikën e fundit. Ai kurrë nuk do t'i kishte kërkuar as të mos ikte aq larg dhe as të vinte vetëm për të. Është rrugë e gjatë.

Nuk i flihej. Dritat e kabinës ishin ulur, provoi të ndiqte një film po nuk përqëndrohej dot. Ngriti pak kapakun e dritares dhe vështroi jashtë. Avioni ishte akoma mbi oqean por në lindje përvijoheshin brigjet e Evropës. Qielli ishte i pastër dhe ajo pa Anglinë që shtrihej e qetë dhe e përgjumur. Në horizont dukej shenja e parë e lindjes, një thua i hollë drite që ndante qiellin me oqeanin e errët poshtë. Ai thua i hollë drite e gërvishte thellë sa herë e shihte. Ishte nga lindja, nga një vend ku edhe drita po edhe errësira vijnë më herët.

U zgjat të shquante më mirë. Një dritëz shkëlqeu mbi vijën e horizontit dhe ajo e kuptoi që nuk ishte një avion po një meteor që binte.

.....

I zgjati me padurim pasaportën nëpunësit italian të aeroportit i cili e pa me vëmendje.

- Canadese?

- Yes, – iu përgjigj ajo anglisht pa dashur ta zgjaste bisedën.

E lehtësuar që as ai nuk e zgjati, nxitoi të gjente një vend nga ku mund të telefononte e qetë. Kohë kishte boll po telefonata po i dukej e vështirë. U ndal para një ekrani të madh dhe kërkoi me sy portën ku do të merrte avionin tjetër. Aeroporti ishte i zhurmshëm dhe rrëmujë siç është gjithnjë Fiumicino në mesditë. U vërtit disa minuta pa ditur ç'të bënte. Pastaj me një lëvizje të vendosur nxori celularin nga xhepi, ndaloi dhe i ra numrit.

- Është vështirë për mua të ta them, – ishte i njëjti zë burri më të cilin kishte folur një natë më parë. – Babai ndërroi jetë në mëngjes, pak pasi u nise ti. Ju pastë lënë uratën!

- Oh, – ajo heshti një hop pastaj pyeti, – e mori vesh që u nisa?

- Besoj se po, – tha burri, – ia thashë dhe ai tundi kokën. Besoj se e ka kuptuar. Pastaj u duk sikur po flinte. Shkoi i qetë. Ju pastë lënë uratën!

- Falemnderit, – tha ajo.

Shtypi me mollëzën e gishtit tregues ekranin e vogël dhe e futi celin ne xhep.

Vuri syzat e diellit për të fshehur ndonjë lot të mundshëm. U ul në një cep e hutuar dhe solli prapë ndërmend të atin. Nuk ishin gjithnjë në një mëndje, mbase ngaqë ishin të dy kokëfortë dhe të drejtpërdrejtë. Po në fund ai përherë i hapte rrugë. Ishte marrë vazhdimisht me të kur vinte fjala për shkollë ose libra. Nuk ka rëndësi çfarë mendojnë të tjerët për ty, i kishte thënë dikur, e rëndësishme është ç'mendon ti për veten. Pikërisht, babush, mendoi, pikërisht këtë nuk e kam fort të qartë tani.

Lotët nuk po i vinin. I duhej të gjente portën për avionin tjetër megjithëse kishte kohë dhe nuk e dinte nëse ky ishte një vendim i mirë. I trembej mendimit se në atë portë të vogël në katin e parë të aeroportit ku niseshin të gjithë avionët për qytetet e lindjes mund të takonte dikë të njohur. Aty mblidheshin të gjithë ikanakët si ajo të zbrazur nga avionë madhështorë për t'u takuar pikërisht në këtë sallon të vogël aeroporti, që gjithnjë i kujtonte se sa i vogël dhe i parëndësishëm për botën ishte ai vend me dy pëllëmbë tokë ku ajo kishte lënë më shumë se gjysmën e jetës së saj.

.....

Ishte vonë kur arriti në shtëpinë e madhe. Në hajat po e prisnin. Funeralin e kemi lënë për nesër, i thanë, që të jesh edhe ti. Nuk ishte hera e parë që kishte përcjellë dikë të afërm nga ky hajat dhe e dinte përmendësh gjithë ritualin. Ai ishte në moshë tashmë, vdekja nuk kishte pasur në vetvete asgjë të papritur ose të parakohshme. Kishte për të qenë një përcjellje e qetë, një drekë disi e zhurmshme pas funeralit dhe pastaj bisedat e njerëzve që vinin për ngushëllim do ishin gjithashtu disi të zhurmshme me keqardhje, po asgjë tragjike.

Këmbët e çuan drejt dhomës se pritjes, e dinte që trupi i të atit duhet të ndodhej aty. Disa gra që ndodheshin në dhomë i hapën vend ndërsa ajo iu afrua shtratit në mes dhe e pa qetësisht. Fytyra e tij dukej në paqe nën të verdhën e pazbërthyeshme të vdekjes. Dikush i vuri krahun në sup, eja të shlodhesh, i tha, je e lodhur, ka qenë rrugë e gjatë.

- Nuk jam e lodhur, – tha ajo, – do pushoj nesër pas ... pasdite.

- Më lini pak vetëm, – shtoi duke iu drejtuar grave në dhomë.

- Nuk bën, – tha gruaja, – nuk bën të rrish vetëm me...

- Ju lutem, – tha ajo.

Gratë u ngritën dhe dolën në heshtje. Ajo u ul pranë të atit dhe e vështroi.

Babush, tha me vete pa zë, çfarë do më kishe thënë po të kisha qenë këtu sot në mëngjes?

U zgjat, kapi dorën e tij dhe e përkëdheli me të dy duart e saj. I erdhi në mend ajo dorë e madhe, teksa, duke mbështjellë dorën e saj të vogël 6 vjeçare, i mësonte të shkruante.

Po tani ajo dorë iu duk si një gërmë e lënë përgjysmë.

TROPIK MELANKOLIK

(*shkruar në Karaibe*)

ROLAND GJOZA

* * *

këtu s'mund të thuash të dua
më parë ajo ka degjeneruar
të gjitha janë krijuar nga të dua
dhe vendasit jane të zinj

dashuria s'shfaqet, po ndjehet
dhe këmbët nxjerrin pendëza
në duar ndjen luspat e mprehta
këtu heshtet

s'ka protestë, trump harrohet
dhe muri i madh me meksikën!
pak rërë në duar
dhe gjen unazën blu të livias
humbur dy mijë vjet të shkuar
octavio august kthehet nga lufta
për dashurinë
ejani në karaibe
deti është puthje!

* * *

këtu vendasit janë të zinj
s'di prej cilit shkak
dhe gratë janë të mëdha e sensuale
s'di prej cilit shkak

këtu s'dashurohet se je i dashuruar
s'puth se të kanë puthur
dhe ka një paqe prej luleje të pakëputur

këtu vendasit janë të zinj
s'di prej cilit shkak
janë djegur njëherë dhe digjen sërish
nga një diell mishi
s'lindin fëmijë, po ngjyra të mahnitshme

salvator dali është ajri

dashuria mish zjarri
të zinj i bën ata që dinë të japin dashuri
ata që s'dinë
të bardhë
si tebeshiri

vijnë këtu të nxihen!

* * *

çdo gjysmë ore bie shi
që s'të lag
dhe shfaqen ylberë dy minutësh mbi kodrat e kaltra
deti rrëqethet prej pritjes
bien me kumb epshe
dalin skena seksi ne ngjyrat e ylbereve qe i prek me dore
më vjen t'i marr me vete
nju jorkun me borë
ta pranveroj!
ç'lajthitje poeti!
atje zoti ka çuar dollarin jeshil
këtu skamjen e zezë
ç'botë trillane dhe e padrejtë!

* * *

në këto brigje pelikanët s'fluturojnë
janë të zinj, të përmotshëm
dhe vigmat i kanë të shuara
ky është ishulli i shën kryqit
pelikanët nga kripa janë verbuar
kur peshkun gjuanin në cektinë
tani japin frymën e fundit
trupat e gjatë drejt i kanë shtrirë
dhe krahët e mëdhenj anash
në ranishten e bardhë ndanë ujërave blu
si shën kryqi
vdesin
nga kripa të verbuar

* * *

jam i pirë
kokë e këmbë jam i pirë
më duket vetja mushkonjë që gjak thith
si grerëz më duket vetja që thumbin ngul në mish
jam i pirë
me alkoolin më të tmerrshëm
bukurinë
vdes në një palmë
ngjallem në një bugonvile
pi dhe pi
bukuri
miliona do të jepja
për pak shëmti!

* * *

në lulet e kaktuseve, aloeve, kokonateve
zogj fare të vegjël si pulse
që iu thonë zuzukama
me të gjitha ngjyrat e ndezura
sa herë i shoh s'kam vertebra
lakuriq zemra
shylla kurrizore kolonadë e koloseut
këndon për mua boçelli
dhe fyte kristali në ajër plasin
i mbush grushtet me to
dhe mbush katedralet e zbrazëta
më iku rinia me valse
me bidëllsat vera në plazhe
me vaçen
dhe rej çarlsin
tani po iu afrohem organove madhështore
të kishave
dhe korit divin
që këndon salve
pata orë të mëdha
tani kam minuta të ankthshme
pastaj do të kem sekonda
atomike
që do të më çojnë lart të lulëzoj si trëndafil i zi në planetin blu të poetëve
do të më këpusë zoti
dhe do të më vërë në hundë
po si bombë do të plas
zotin do ta hedh në erë
rëntë si pleh
në tokën e poetëve!

* * *

ç'dhimbje
që ke zemër njeriu!
midis luleve të tropikut
kaq të lumtura

më mirë të isha lule bugenvile
të bëja harakiri
duke lëshuar petale të kuqe

si njeri s'di të lulëzoj
ç'dhimbje!

* * *

uraganë të tmerrshëm në ajër këtu flenë
zgjohen kur t'iu teket
dhe bugenvilet e kuqe lulëzojnë për tmerr
si një lumturi në ferr
meshkujt kanë ereksione të shpeshtë
ndiejne dhimbje molisëse
lëngje veshtullorë lagin kofshët e grave
me grishje
fuqia, fuqia e uraganeve që flenë në ajër
përbindshëm
i krijon këto gjendje qëniesh mitologjike
dhe ke një ankth të madh
të frikshëm
po dhe të gëzueshëm gjer në ekstazë
po sikur të zgjohen?
të gjithë do t'ia mbathin
ç'dashnorë frikacakë!

* * *

albatrosët shfaqen si bodler
në qiellin e kaltër me hyjnorë
dhe zgjatin krahët si krisht
në shtyllën e ajrit mbi ujë

nuk zbresin poshte tek tokësorët
fluturojnë me krahët madhështor
kanë frikë njeriun e pashpirt
përçmimin dhe lojën prej demoni

krishtërojnë në qiell dhe këlthasin
me gjuhën e tyre na mallkojnë
nuk i harrojne cigaret qe u shtypen
ne trupat e tyre prej qielloresh

madhështor, madhështor, madhështor
veç në ajrin e kaltër pa mëkate
s'e kanë vendin poshtë, ku vulgu
poetin merr nëpër këmbë, e tall

në qiell i ke poetët përgjithmonë
këtë e thotë bodleri blu qiellor
prandaj u shfaqën albatrosët
në shtyllën e ajrit mbi ujë

* * *

këtu vjen turist dhe vdekja
në këtë vend të përralltë ndërron mendje
nuk merr njeri me vete
pi birrë me të vdekurin e mundshëm
në mbrëmje
me dy hëna me ngjyra
njëra e kuqe
në qiell
tjetra e kalter
në ujë
për një me infarkt miokardit
dhe për një tjetër me ishemi cerebrale
skadon afatet fatale
një vajze bionde me kancer
i jep jetën e një orkideje të bardhë
dhe me lulet e verdha të aloes
ndalon dhimbjen e tmerrshme të veshkave
rroftë vdekja!

* * *

çdo gjysmë ore këtu bie shi
si krehër na kreh
si grim i kaltër bie
dhe ngjyrat e humbasin esencën e tyre
shiu kërcen salsa
vertikale
dhe sërish zhduket në qiell
s'janë pika shiu blu
po vajza lozonjare
që zbresin të gjejnë dhëndurë
pastaj del dielli si otello

alarmi i katërt

tregim nga

JOHN CHEEVER

Jam ulur nën rrezet e diellit, ndërkohë që pi një gotë xhin. Ora është dhjetë e mëngjesit. Është e diel. Zonja Uxbridge, governantja, ka shkuar diku me fëmijët. Ajo kujdeset për shtëpinë, për gatimin dhe për Peter-in e Louise-n. Ndoshta ora dhjetë e mëngjesit është pak si herët për një gotë plot me xhin, por unë alkolit i jam më shumë mirënjohës se sa dyshues. I kam bërë kontrollin e mëlçisë dhe analizat e gjakut. Jam shumë mirë me shëndet dhe xhini më pëlqen. Ai më ka ndihmuar t'i përballoj me qetësi rastet e uljeve të detyruara me avion, krizat bashkëshortore, madje edhe fundosjen e një barke me vela. Kështu që, kur kjo gotë të zbrazet, do të mbush një tjetër. Është vjeshtë. Gjethet janë zverdhur. Mëngjesi është pa erë, megjithatë ato bien me qindra. Që të mund të përjetosh gjithçka, - renien e nje getheje, një fije bari - duhet, mendoj unë, të dish ta njohësh dhe ta ndjesh grishjen e dashurisë. Zonja Uxbridge është gjashtëdhjetë e tre vjeç, ime shoqe është më shumë e ikur, ndërsa zonja Smithsonian (që banon në anën tjetër të qytetit), ka filluar, këto kohët e fundit, të ketë gjithnjë e më pak dëshirë të shoqërohet me mua. Dhe kështu më duket se po më ikën kot një pjesë e mëngjesit, sikur orët të ishin në vetvete një lloj pragu, që unë s'arrij dot ta kapërcej. Ndoshta do të më bënte mirë të luaja pak me top, por Peter-i është shumë i vogël dhe fqinjin e vetëm që di të luajë me top, më shumë e gjen në kishë.

Ime shoqe, Bertha, duhet të kthehet të hënën. Vjen në shtëpi të hënën dhe kthehet sërish në qytet të martën. Bertha është një grua e bukur, me një trup të mrekullueshëm. Ndoshta sytë i ka disi shumë afër me njëri-tjetrin dhe ka një karakter mjaft të ashpër. Kur fëmijët ishin të vegjël, ajo kishte një mënyrë të saj për t'i edukuar: - Po s'e hëngre mëngjesin që të ka përgatitur mamaja, përpara se të kem numëruar deri në tre..., - thoshte, - do të të çoj përsëri në shtrat. Një, dy, tre... Ndërsa në mbrëmje: - Nëse nuk e hani darkën që ju ka bërë gati mamaja, para se të kem numëruar deri në tre, do t'ju çoj në shtrat pa darkë. Një, dy, tre... Më duket sikur e dëgjoj ende kur thoshte: - Nëse nuk i vini lodrat në vendet e tyre, përpara se të kem numëruar deri në tre, mamaja do t'jua flakë ato jashtë. Një, dy, tre... Dhe kështu vepronte kur fëmijët duhej të bënin banjë, kur duhej të shkonin për të fjetur dhe "një, dy, tre"-shi ishte një lloj nina-nana për ta. Ndonjëherë mendoja se ajo e kishte mësuar këtë mënyrë të numëruari që kur ishte foshnje dhe se në çastin final të jetës, do t'i kish numëruar mbrapsht edhe engjëllit të vdekjes. Tani, nëse më lejoni, po mbush një gotë tjetër me xhin.

Kur fëmijët nisën të shkonin në shkollë, Bertha gjeti një vend pune si mësuese e shkencave sociale në një shkollë nëntëvjeçare. Kjo punë e mbante të angazhuar dhe e kënaqte dhe ajo thoshte se kishte dashur gjithmonë të bëhej mësuese. U bë e famshme për ashpërsinë e saj. Vishte rroba të errëta, flokët i krihte thjesht dhe kërkonte që nxënësit t'i bindeshin e t'i nënshtroheshin plotësisht autoritetit të saj. Për t'i dhënë më shumë larmi jetës së vet, u bë pjesëtare e një trupe amatore teatrore. Luajti rolin e kamerieres në pjesën "Angel Street" dhe atë të këngëtares së vjetër tek "Desmonds Acres". Miqtë që zuri në atë rreth ishin të gjithë njerëz simpatikë dhe mua më vinte mirë kur e çoja në festat që ata organizonin. Është e rëndësishme të theksoj se Bertha nuk pi. Mund të pranojë për mirësjellje një "Dubonnet", por nuk i pëlqen të pijë.

Përmes miqve të rrethit teatror, mori vesh se po kërkonin disa aktorë për një shfaqje nudistësh të titulluar "Ozamanides II". Këtë gjë ma tha vetë ajo, ashtu siç m'i tha edhe gjërat e tjera. Kontrata me shkollën parashikonte dhjetë ditë pushim në rast sëmundjeje dhe ajo, duke u shtirur sikur ishte e sëmurë, u nis një ditë për në Neë York. Aktorët përzgjidheshin nga një producent që e kishte studion në periferi dhe kur ajo shkoi atje, gjeti një radhë të gjatë prej njëqind e më shumë njerëzish, burra e gra, në pritje për t'u futur. Nxori nga çanta një kambial dhe duke e tundur sikur të ishte ndonjë letër rekomandimi, kaloi përpara të gjithëve duke thënë: - Me leje, me leje! Kam një takim... Askush nuk protestoi dhe ajo e gjeti veten në krye të radhës, ku një sekretare i mori shënim emrin, numrin e librezës së punës, etj. Pastaj i tha që të hynte në një si depo dhe te zhvishej. Më pas e çuan në një studio ku ishin katër burra. Biseda, duke pasur parasysh rrethanat, ishte e matur. I thanë se do të interpretonte nudo gjatë gjithë shfaqjes. I thanë se do t'i duhej të bënte dashuri në skenë, ose të shtirej sikur, të paktën dy herë, në dy skena të ndryshme dhe se duhej të merrte pjesë në orgjinë finale bashkë me spektatorët.

Më kujtohet ajo mbrëmje kur ajo më tregoi gjithçka. Ishim në sallon. Fëmijët i kishim çuar në shtrat. Padyshim, ajo ishte shumë e lumtur. Dhe ia nisi: - Qëndroja aty, krejt lakuriq, por s'ndihesha fare në siklet. E vetmja gjë që më shqetësonte ishte fakti se mund të bëja pis shputat e këmbëve. Studioja kishte atë pamjen klasike, me ato afishet teatrore të varura në mure dhe me fotografi të mëdha të Ethel Barrymore-s . Kështu pra, rrija e ulur, pa asnjë rrobë në trup, para atyre burrave të panjohur dhe për herë të parë në jetën time, m'u duk se zbulova vetveten. Gjeta veten time në atë lakuriqësi. U ndjeva si një grua tjetër, një grua më e mirë. Të qëndruarit nudo para të panjohurve ishte një nga përvojat më emocionuese të jetës sime...

Unë, aty për aty, nuk dija ç'të bëja. Në të vërtetë, edhe tani, në këtë mëngjes të diele, nuk e di mirë se ç'duhej të kisha bërë. Ndoshta duhej ta kisha rrahur, por vetëm i thashë se nuk mund të merrte pjesë në një shfaqje të tillë. I përmenda fëmijët, kurse ajo më tha se kjo përvojë do ta bënte një nënë më të mirë. – Kur i hoqa rrobat, - shtoi, - m'u duk se u çlirova nga gjithçka meskine dhe e keqe. Atëherë unë i thashë se s'kishin për t'ia dhënë kurrë atë rol për shkak të shenjës së operacionit të apendicitit. Në atë çast, ra zilja e telefonit. Ishte producenti që po i ofronte rolin. – Oh sa e lumtur që jam, - tha ajo. – Oh sa gjë e mrekullueshme, e larmishme dhe e veçantë duhet të jetë jeta kur ti nuk interpreton më në rolet që të kanë caktuar prindërit apo miqtë. Më duket vetja si një eksploruese!

Mundësia që pata për të bërë diçka atëherë, ose më mirë, ajo çka lashë pa bërë, m'i pështjellon ende mendimet. Ajo e la punën në shkollë, u regjistrua në sindikatat e teatrove dhe filloi provat. Sapo nisën shfaqjet e "Ozmanides", ajo pajtoi si governante zonjën Uxbridge dhe shkoi të banonte në një hotel pranë teatrit. Unë i propozova që të divorcoheshim. Ajo më tha se nuk shikonte ndonjë arsye për t'u ndarë. Tradhëtia bashkëshortore dhe dhuna psikologjike janë motive shumë të forta në një proces gjyqësor, por ç'mund të bëjë një burrë nëse gruaja e tij dëshiron të shfaqet nudo në skenë? Kur isha më i ri, kisha parë balerina që zhvisheshin dhe disa prej tyre ishin të martuara dhe me fëmijë. Por ato bënin atë që donte të bënte Bertha vetëm në shfaqjet e të shtunave në mesnatë dhe më kujtohet që burrat e tyre ishin aktorë komikë të vjetër e të dështuar, ndërsa fëmijët e tyre dukeshin gjithmonë të uritur.

Disa ditë më vonë shkova tek një ekspert divorcesh. Ai më tha se shpresa ime e vetme ishte një ndarje me mirëkuptim. Nuk ekzistonin precedentë që simulimi i akteve të turpshme në vende publike, të përbënte motiv për divorc në shtetin e Neë York-ut dhe asnjë avokat nuk kishte për t'u marrë me një çështje divorci që nuk kishte precedentë. Pjesa më e madhe e miqve të mi silleshin me shumë takt kur binte fjala për jetën e re të Bertha-s. Besoj se thuajse të gjithë ata duhet të kenë vrapuar për ta parë, kurse unë përkundrazi, prita rreth një muaj apo ndoshta më shumë. Biletat ishin të shtrenjta dhe ishte e vështirë t'i gjeje. Atë mbrëmje që shkova në teatër, apo më mirë të themi, në atë vend që dikur kishte qenë teatër, binte dëborë. Paraskena ishte hequr, dekori i skenës përbëhej nga një grumbull gomash të vjetra automobilash dhe elementi i vetëm i zakonshëm ishin kolltukët dhe korridoret. Spektatorët e teatrit gjithmonë më kanë trembur. Ndoshta ngaqë aty e gjen veten në mes të një shumëllojshmërie të pakuptimtë njerëzish, të mbledhur në një mjedis që duket shumë mikpritës, por që në fakt të krijon ndjesinë e kundërt. Dhe atë mbrëmje kishte lloj lloj njerëzish. Kur hyra, po luhej muzikë rock. Ishte nga ai rock-u primitiv, shurdhues, që dikur e dëgjoje në vende si "Arthur-i". Në orën tetë e gjysmë dritat u ulën dhe aktorët – ishin katërmbëdhjetë të tillë – përshkuan platenë. Ishin të gjithë krejtësisht të zhveshur, përveç Ozamanides-it që mbante në kokë një kurorë.

Nuk jam në gjendje ta përshkruaj shfaqjen. Ozamanides-i kishte pasur dy fëmijë dhe më duket se i kishte vrarë që të dy, por nuk jam i sigurt për këtë. Marrëdhëniet seksuale ishin masive. Burrat dhe gratë përqafoheshin pa ndonjë rregull të caktuar, ndërsa Ozamanides-i bënte dashuri me dy burra njëkohësisht. Një çast, një burrë i ulur pranë meje, më vuri dorën mbi gju. Unë nuk desha ta qortoja për këtë dobësi njerëzore, por nuk doja as ta nxisja. Kështu, ia largova dorën dhe më kapi një mall i madh për ato kinematë naive të fëmijërisë time. Në qytetin e vogël ku unë u rrita, kishte vetëm një të tillë, me emrin "Alhambra". Filmi që më la më shumë mbresa nga të gjithë quhej "Alarmi i katërt". E pashë për herë të parë një të martë pas shkolle dhe ndenja në kinema deri në rishfaqjen e tij të parafundit për atë ditë. Prindërit e mi u shqetësuan sepse isha vonuar për darkë dhe më qortuan paq. Të mërkurën nuk vajta në shkollë dhe e pashë filmin edhe tri herë të tjera, por arrita të mbërrija në kohë në darkë në shtëpi. Të enjten shkova në shkollë, por sapo mbarova mësimin, vrapova për në kinema dhe ndenja aty gati në mbarim të rishfaqjes së tij të fundit. Prindërit e mi duhej të kishin lajmëruar policinë, sepse një çast, një polic më ngriti nga ndenjësja dhe më tha të shkoja menjëherë në shtëpi. Të premten, m'u ndalua t'i afrohesha kinemasë, por e kalova aty gjithë ditën e shtunë, madje edhe të dielën, që ishte dita e fundit e shfaqjes së atij filmi. Filmi bënte fjalë për zëvendësimin e karrocave të vjetra me kuaj të zjarrfikësve me makinat zjarrfikëse që kishin filluar të përhapeshin në ato kohë. Përshkruhej historia e katër apo pesë skuadrave zjarrfikësish. Tri prej tyre ishin pajisur me makina dhe kuajt e shkretë ua kishin shitur disa fabrikantëve të gjorë sapuni. Kishte mbetur vetëm një skuadër me karrocë me kuaj, por që i kishte ditët e numëruara. Njerëzit dhe kuajt ngjanin si të mjerë. Pastaj, papritur, një ditë, ra një zjarr i madh. Makina e parë zjarrfikëse u nis e më pas e dyta dhe e treta, me gjithë shpejtësinë në vendin ku kishte rënë zjarri. Por skuadra me karrocën e vjetër me kuaj qëndronte në mënyrë të trishtueshme pa lëvizur. Krejt papritur, ra alarmi i katërt – ishte për ta – dhe ata brofën në këmbë, mbathën kuajt dhe u nisën turravrap nëpër rrugët e qytetit. E shuan zjarrin, e

shpëtuan qytetin dhe kryetari i bashkisë i lejoi që ta mbanin karrocën me kuaj. Tani, në skenë, Ozamanides-i po shkruante disa fjalë të pista në mollaqet e gruas sime.

Mos ndoshta lakuriqësia e saj, rrëqethja që të shkaktonte kjo gjë, ia topiste nostalgjinë? Nostalgjia, edhe pse sytë i kishte shumë afër njëri- tjetrit, përbënte një nga hiret e saj më të mëdha. Kishte një aftësi të veçantë për të ruajtur brenda vetes, plot ndjenjë, disa përvoja të caktuara dhe t'i risillte ato në një kohë tjetër. Vallë, ndërkohë që bënte seks në publik me një të panjohur krejt të zhveshur, i kujtohej ndonjë vend ku ne kishim bërë dashuri? Dhomat pranë detit, ku, nën zhurmën e shiut të verës, përsëritej premtimi aq i lashtë i dashurisë së përjetshme, i paqes dhe i bukurisë? Më erdhi të ngrihesha në këmbë në mes të platesë dhe t'i thërrisja që të kthehej, të kthehej për hir të dashurisë, të harmonisë, të çiltërsisë shpirtërore. Sa bukur ishte kur ktheheshim me makinë pas ndonjë feste, ndërsa binte dëborë, mendoja. Dëbora që fluturonte drejt dritareve të makinës, të krijonte përshtypjen se po grahnim me dyqind km në orë. Sa bukur ishte ta ktheje në shtëpi me makinë, pas ndonjë feste, ndërsa binte dëborë. Por në këtë çast, aktorët u rreshtuan në skenë dhe na ftuan, madje na urdhëruan, të zhvisheshim dhe të bashkoheshim me ta.

U ndjeva si i detyruar. Në ç'mënyrë tjetër do të mundja ta kuptoja Bertha-n? Unë kam qenë gjithmonë i shkathët për t'u zhveshur. U zhvesha. Ku mund t'i lija portofolin, orën dhe çelësat e makinës? Nuk mund t'i lija këto gjëra bashkë me rrobat. Kështu që, i gjithi lakuriq, u drejtova për nga korridori, duke i mbajtur sendet e vlefshme në dorën e djathtë. Kur mbërrita pranë tyre, një djalosh nudo më ndaloi duke bërtitur sikur të ishte duke kënduar: - Lërini gjërat e tepërta! Gjërat e tepërta janë të pahijshme.

- Kam hallin e portofolit, orës dhe çelësave të makinës, - thashë unë.

- Lërini gjërat e tepërta, - ma ktheu ai.

- Por më duhet te kthehem në shtëpi me makinë nga stacioni, - thashë unë. – Dhe kam rreth gjashtëdhjetë dollarë në portofol.

- Lërini gjërat e tepërta!

- Nuk mundem, vërtet nuk mundem. Më duhet të ha e të pi dhe pastaj të kthehem në shtëpi.

- Lërini gjërat e tepërta!

Pastaj, të gjithë me radhë, përfshirë edhe Bertha-n, filluan të përsërisnin në kor të njëjtën fjali: - Lërini gjërat e tepërta, lërini gjërat e tepërta!

Ndjesia e të qenit i padëshiruar, më ka shkaktuar gjithmonë një dhimbje të madhe. Ndoshta një ditë ndonjë mjek mund ta zbulojë arsyen e saj. Kam një lloj ndjesie që ma trondit gjithë qenien time dhe duket sikur i shton një hallkë të re zinxhirit të formuar nga të gjitha përvojat e mëparshme të ngjashme. Zërat e aktorëve ishin kumbues dhe shpërfillës dhe unë qëndroja aty lakuriq si një krimb, në një vend të çuditshëm të një qyteti të çuditshëm, nudo dhe i padëshiruar, ndërsa më vinin ndër mend golat e munguar të ndeshjeve, grushtet që kisha ngrënë, vajzat që më kishin refuzuar, vështrimet e vëngërta të të panjohurve, të qeshurat e mbytura që dëgjoheshin përtej dyerve të mbyllura. I mbaja sendet e vlefshme në dorën e djathtë, sikur ato të përbënin treguesin e vetëm të identitetit tim. Nuk ishin absolutisht gjëra të pazëvendësueshme, por t'i braktisje ashtu më dukej sikur po vija në rrezik ekzistencën time, emrin tim, madje edhe vetë hijen që trupi im lëshonte në dysheme.

U ktheva në vendin tim dhe u vesha. Ishte e vështirë ta bëje këtë në atë hapësirë të ngushtë. Aktorët vazhdonin të thërrisnin. Ndërsa po drejtohesha kah korridori për t'u larguar nga ai teatër i rrënuar, më erdhën të kthjellëta në mend kujtime të tjera. Kisha përshkuar një korridor të ngjashëm me një pendencë të butë ngjitjeje, pas shfaqjes së "Mbretit Lir" dhe të "Kopshtit të qershive". Më në fund dola në rrugë.

Vazhdonte të binte borë. Ngjante me një stuhi. Përpara teatrit gjendej një taksi e bllokuar dhe mua m'u kujtua që ua kisha vendosur zinxhirët rrotave. Kjo gjë më shkaktoi një ndjesi sigurie dhe kënaqësie, që, pa dyshim, do t'i kishte ngjallur një farë neverie Ozamanides-it dhe lajkatarëve të saj. Në fakt, e gjithë kjo që ndodhi, nuk dukej se më kishte çliruar nga frenimet e mia, por më shumë ngjante sikur kishte nxjerrë në pah një tipar të mrekullueshëm, praktik dhe të ekuilibruar të vetes sime. Era ma përplasi dëborën në fytyrë dhe unë, duke luajtur nëpër gishta me çelësat e makinës, u drejtova për nga stacioni.

Përktheu ALBAN BOBRATI

Solidaritet njerëzor

tregim nga

Qazim Shehu

Si zakonisht, në mëngjes, çohem herët dhe ose dal e pi kafe në lokalin e lagjes, ose rri në dritare dhe vështroj sesi dalin nga shtëpitë njerëzit, të cilët tek-tuk ngarendin për në punë.

Pallatet ku banoj vijnë në formë katrori, para tyre, ndodhet një shesh i madh, përreth të cilit vjen një rrugë jo shumë e gjerë, e shtruar me asfalt. Ajri i freskët i mëngjesit frushullon ngadalë, duke dhënë pak optimizëm për ditën që po nis.

Nga katrorët intimë të dritareve fillojnë e duken shenjat e jetës, diku shoh një grua që del në dritare, vëren një minutë, pastaj e mbyll atë me nxitim, siç duket, sapo ka përfunduar një zënkë me burrin, sepse e tërheq perden me nervozizëm. Një grua tjetër, nuk pret një orë më të volitshme, po në parmakët e shkallëve godet me rrahëse një tapet, me gjithë forcën e krahëve të saj. Njerëzit kalojnë pranë saj dhe nuk i thonë gjë.

Më bëhet se kjo radhë pallatesh ka njerëz të krisur, sidomos gratë që rrinë gjithë ditën nëpër shkallë, ulur grupe-grupe, duke diskutuar për një botëzë interesante, të cilën, në kuptimin e saj vertikal, s'mund ta vjedhësh lehtë as të futesh në të. Më pëlqen të sodis fillimin e ditës si një ritual fragmentar, i përsëritur sa e sa herë, por gjithmonë shkrydhës dhe i bukur.Përzemërsia e butë e këtij rituali më forcon një bindje afektive, sidomos kur shoh çifte që puthen shqeto në dritare, pa pikën e drojës, sikur të mos u ketë mjaftuar nata ose të parandjejnë gjatë ditës një ndarje të gjatë. Të gjitha pallatet e vendosur në formën e katrorit sikur janë ndërtuar kështu, që asgjë mos u shpëtojë nga njëri-tjetri, s'ka asnjë fshehje, asnjë mundësi, për të mos u parë nga dikush. Ky ndërtim djallëzor ka shmangur edhe rrugën, për të hyrë zjarrfikësja, ndonëse gjer sot zjarr s'ka rënë, përveç zjarrit të intimiteteve dhe brengave që djegin çdo ditë këtë hapësirë të mirëpërcaktuar, si në një teatër memec, ku ulërima duket sikur ka gjithnjë një fuqi tmerruese, për t'u zhytur kokëposhtë në gremina të mistershme, sesa të ngjitet lart.

Gjithë këto mendime, kam dëshirë t'i provoj dhe t'i thërras mëngjeseve, ndërsa zhurma e rrugës së madhe duket se nuk do që nuk do të depërtojë në Katror. Pasi vështrimi im shëtit gjithë dritaret, duke qenë i pafajshëm prej natyrës sime kurioze, befas ndal tek kazani i plehrave, aty ku një rom po rrëmon në të. Nuk më duket rom i lagjes sime, pasi të gjithë i njoh.Qenka treguar guximtar duke ardhë nga lagja e Breglumit gjer te Katrori ose i mençur, sepse të tjerët, siç duket, kanë kuptuar se s'duhet të rrëmojnë më në plehra.Lagjja ime është disi e mbajtur, vetëm në shkallën time banojnë tre drejtorë drejtorish dhe hedhin te kazani ushqime gjysmë bajate, rroba të mira, por të dala mode. Çfarë nuk hidhen aty, këpucë, aparate telefoni, orë, zinxhirka nusesh, pako me djathë etj. Një ditë, orën time të vjetër e pashë në një tezgë dhe shitësi ma ofroi që ta blija. Kështu është kjo botë, riciklim plehrash, mendova, ndërsa romi rrëmonte në kosh dhe nxirrte nga kazani ato që një sojli i quan plehra.Dukej sikur i falenderonte njerëzit për gjahun e mirë, sepse punonte nxitimthi, sikur të kishte rënë në një thesar të cilin e kishte pritur prej kohësh. Ja tek nxori nga kazani një shishe uiski, që ndoshta dikush e kishte hedhur aty gabimisht. Pa një herë me vëmendje, i hoqi tapën dhe e ktheu. Pastaj e futi në xhepin e vet të xhaketës, sepse ajo vetëm aty duhej ta kishte vendin.Ndonjë send që nuk i pëlqente, ai e merrte, e kqyrte njëherë e mirë, sikur të kishte kapur ose gjetur ndonjë perlë, pastaj e fuste në thesin e vet, që e mbante afër, ose, po të mos i pëlqente, ngrinte krahun lart, si të gjuante ndonjë hobe dhe e flakurinte në kazan, ose jashtë tij. E pashë sesi e hoqi kapelen dhe e hodhi tutje, sepse siç duket kishte gjetur një kapele më të mirë. Dhe nuk gabova, ai vuri në kokë një kapele ushtarake, kasketë allaruse, nga ato që mbanin operativët e sigurimit dikur. Ndoshta kjo do t'i jepte autoritet më shumë dhe s'dihet se me çfarë ndjenje të një rizgjimi të ëndrrës bënte lojë. Njëherë ai e ngriti thesin lart, për të provuar peshën e tij ose sikur ai të ishte vërtetë aty, s'dihet nga ç'frikë që iu faneps në mendje, se mos thesi bënte këmbë e ikte. Njerëzit kalonin pranë tij, askush nuk i fliste, ata ishin mësuar me pamje të tilla. Një grua rome kaloi pranë tij dhe i foli, po ai nuk ia vari fare e kjo e tërboi më shumë gruan që iu afrua dhe, nga pozicioni i lëvizjes së trupit dhe gjymtyrëve, dukej se i fliste e nxehur. Qetësia e tij e çarmatosi dhe ajo u largua duke rrahur me dorë prapanicën. Mund të qe punë dashurie ose tradhtie ose mbase punë plehrash, sepse ky rom kishte hyrë në ngastra të tjera. Sidoqoftë, ai nuk e vriste mendjen, punonte me ngut, me nxitim, një nxitim që tregonte një orar të caktuar, i cili duhej zbatuar, një kohë për t'u kapur.

Veçse ky nxitim i tij nuk kishte qenë i kotë, sepse se nga mbiu një qen i madh, i zi,i cili ia nguli dhëmbët thesit të mbushur deri në gjysmë, duke e tërhequr me fuqinë e tij prej qeni, sa romi u hepua, gati- gati të binte mbi shpinën e qenit. Veçse, shpejt e mblodhi forcën dhe qeni për një çast e lëshoi thesin, por duke qenë qen këmbëngulës, sapo romi e ngriti thesin në një lartesi të caktuar, ai hovi përpjetë, kapi fundin e thesit dhe e tërhoqi me një egërsi të furishme.

Njeriu për pak u rrëzua, mbështeti trupin te kazani i plehrave, për të marrë një pikëmbështetje, shpëtoi nga rrëzimi, po qeni prapë nuk e lëshoi thesin.

Desha të thërras, po thirrja ime u mbyt në vetvete, si gazrat e trupit në ujë. Skena të tilla, shumë njerëz i argëtojnë, po unë e prisja me një ankth të lehtë se si do të përfundonte kjo betejë midis njeriut dhe kafshës. Me siguri do fitonte njeriu, po dale…qeni ia rrëmbeu sërish thesin romit, i cili me një manovrim të shpejtë arriti ta tërheqë, duke e lakuar trupin prapa.Të ishte ndonjë thes me para ose ndonjë kuletë politikani, ia vlente, po në të vërtetë as romi nuk e dinte çfarë kishte brenda, ai dinte se aty kishte diçka të rëndësishme, se një thes aq i madh s'duhej të ishte pa gjë, pastaj, ç'donte ai qen aty, jo, një thes aq i madh s'duhej të ishte pa gjë. Tani po luhej në nderin e ekzistencës së tij prej romi, ekzistencë, të cilën, ajo kafshë e zezë po ia lëkundte fort.

Dikur thesi u ça, po nuk doli gjë jashtë, kjo qe fat për romin, me siguri, thesi duhej të ishte prej materiali të mirë. Pranë tyre kalonin njerëz dhe s'i shihnin, s'kishin kohë ose ishin mësuar me skena të tilla. Dikush duhej të afrohej, të trembte qenin dhe t'i vinte në ndihmë këtij njeriu, po të merresh me qentë është punë e rrezikshme.

Desha të zbres shkallët e pallatit, të ndihmoja atë njeri të mirë, por, më ikte skena. Nga aty, si në një llozhë teatri, pa pasur nevojë për dylbi, e ndiqja këtë skenë me një përfundim që nuk dihej si do vinte. Të dy ishin të fortë, qeni dhe njeriu, nuk i lëshonin pe njëri- tjetrit dhe, më e rëndësishme, ishte një skenë pa duartrokitje, pa aktorë të tjerë, diçka e heshtur, që fliste me gjuhën e gjesteve si në një teatër absurd. U dëgjua një zhurmë e zakonshme. Ishte makina e plehrave e cila, pasi bëri rrotullimin, u afrua te kazanet e plehrave. Punëtorët dolën nga makina, morën lopatat dhe u nisën drejt kazanit. Lufta e romit vazhdonte. Befas, njëri nga punëtorët iu turr qenit me bishtin e lopatës, i cili, duke ndjerë veglën kërcënuese, ia krisi vrapit.

Romi e tërhoqi thesin drejt vetes, sikur të shpëtonte një fëmijë nga dallgët e lumit. Pastaj e vuri thesin, të shkalafitur pak nga dhëmbët e qenit, në karrocën e tij të vogël, pranë thesit tjetër. Ai e pa thesin, e mbylli sërish dhe vuri gishtin kokës. Siç duket qe penduar pse nuk ia kishte lënë qenit.Thesi nuk duhet të kishte ndonjë vlerë, por ndoshta egoja e tij prej triumfatori e bëri që thesin të mos e hidhte..S'dihej sesi do kishte përfunduar kjo betejë po të mos vinte kjo makinë dhe po të mos shfaqnin solidaritetin me romin punëtorët…Romi u drejtua nga ata, ndoshta për t`i falenderuar, pastaj ktheu kurrizin dhe iku me karrocën e tij të vogël…



MARIO VARGAS LLOSA
Leximi i letërsisë së mirë

Ndosh shpesh që në panairet e librit ose në librari, më afrohet një burrë që mban librin tim në duar për të më kërkuar autograf, ndërsa thotë: "E dua për gruan dhe bijën e vogël, për motrën ose nënën, ato janë lexuese të devotshme dhe e dashurojnë letërsinë." Unë sakaq e pyes: "Po ju, s'ju pëlqen të lexoni?" Përgjigja është gati e pashmangshme: "E dini, patjetër që më pëlqen, por jam shumë i zënë me punë." Po e di, sepse këtë e kam dëgjuar me dhjetëra herë: ai burrë dhe mijëra si ai, kanë kaq shumë gjëra më të rëndësishme për të bërë, kaq shumë detyrime dhe përgjegjësi në jetë sa s'mund ta harxhojnë kohën e çmuar duke kaluar orë të tëra për t'u përhumbur në faqet e një romani, të një libri me poezi apo me ese letrare. Ka një ide të përhapur gjerësisht se letërsia është aktivitet jo i domosdoshëm, thjesht për të kaluar kohën, e dobishme për zhvillimin e ndjenjave dhe zakoneve, një stoli për njerëzit që kanë kohë për argëtim dhe duhet të përshtatin kohën për sportin, kinemanë, shahun ose lojën me letra por është edhe diçka që mund të kalohet në plan të dytë pa e menduar dy herë kur bëhet fjalë për të përcaktuar çfarë është më e rëndësishme në jetë.

Është e vërtetë që letërsia po bëhet gjithnjë e më shumë aktivitet i grave dhe vajzave: në librari, leksione, apo takime ku lexojnë shkrimtarët, dhe sigurisht në departamentet dhe fakultetet e shkencave humane, gratë dhe vajzat e tejkalojnë dukshëm numrin e burrave. Shpjegimi që jepet është se gratë e shtresës së mesme lexojnë më shumë ngaqë punojnë më pak orë se burrat, dhe kalimi i kohës me leximin e krijimeve letrare që krijojnë iluzionin e realitetit është më i përligjur për gratë sesa për burrat. Jam disi mosbesues ndaj interpretimeve që i ndajnë burrat dhe gratë në kategori të caktuara, sepse u mveshin gjinive cilësi dhe të meta kolektive, por është e vërtetë që, në përgjithësi, lexuesit e letërsisë po pakësohen, dhe pjesa më e madhe e këtyre lexuesve që mbeten janë gra. Kjo mund të themi se është e verëtetë thuajse kudo.

Një studimi të Shoqatës së Autorëve Spanjoll doli në përfundimin shqetësues që gjysma e popullsisë s'kishte lexuar kurrë një libër. Studimi vuri në pah që tek kjo pakicë që lexojnë, numri i grave që i kushtojnë kohë leximit është 6.2% më i madh se i burrave, dhe prirja është që ky hendek të rritet. Jam i sigurtë që këto dallime janë të vërteta edhe në shumë vende të tjera ashtu si në vendin tim, Perunë. Sigurisht, më vjen shumë mirë për këto gra, por më vjen shumë keq për burrat dhe për miliona njerëz që mund të kishin lexuar, por kanë vendosur të mos e bëjnë jo vetëm ngaqë ata s'e kanë idenë e kënaqësisë që po humbasin, por, në një këndvështrim më pak hedonist, sepse jam i bindur që shoqëria pa letërsinë apo në të cilën letërsia shmanget është një shoqëri e dënuar të bëhet barbare në aspektin shpirtëror dhe madje ta vërë në rrezik lirinë e saj.

Do të doja ta kundërshtoja me argumente idenë se letërsia është kohë e tepërt e kaluar për qejf për të mbështetetur pikëpamjen se është një nga aktivitetet më pasuruese të mendjes, i domosdoshëm për formimin e qytetarëve në një shoqëri moderne, demokratike, një shoqëri të individëve të lirë, dhe për këtë arsye, duhet të bëhet zakon qëfamilja e ngulit te fëmijët që në moshë të hershme, dhe duhet të jepet mësim si disiplinë themelore gjatë gjithë sistemit arsimor. E dimë tani se e kundërta është e vërtetë, se mësimdhënia e letërsisë po rrudhet dhe madje po zhduket nga kurrikulat shkollore.

Jetojmë në epokën e dijes së specializuar dhe për shkak të zhvillimit të jashtëzakonshëm të shkencës dhe teknologjisë, dija është fragmentarizuar në mënyra dhe degë të panumërta, prirje kulturore që vetëm do të bëhet gjithnjë e më e theksuar në vitet e ardhshme. Shkenca dhe letërsia po ndahen gjithnjë e më shumë nga një kulturë më e përgjithshme, kjo prej shpejtësisë së zhvillimit dhe ndërlikueshmërisë së shkencës gjë që e cila ka çuar në specializimin e dijes dhe përdorimin e gjuhës hermetike. Letërsia, nga ana tjetër, ka qenë, është dhe do të vazhdoj të jetë derisa të ekzistoj, një nga emëruesit e përbashkët të ekzistencës me anë të cilës qeniet njerëzore njohin veten dhe bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin, pavarësisht se sa të ndryshme i kanë profesionet, planet për jetën, vendndodhjen gjeografike, rrethanat individuale apo epoka në të cilin jetojnë.

Ne që lexojmë Servantesin, Danten apo Tolstoin e kuptojmë njëri-tjetrin dhe ndjehemi pjesë e të njëjtit lloj sepse në veprën që kanë krijuar këta shkrimtarë, mësojmë se si qenie njerëzore gjejmë çfarë është e përbashkët për të gjithë ne, përtej gamës së gjerë të dallimeve që na ndajnë. Dhe s'ka mbrojtje më të mirë ndaj marrëzisë së paragjykimit, racizmit, ksenofobisë, ndarjes politike apo veçimit të plotë nacionalist, dhe kjo e vërtetë e pandryshueshme shfaqet përherë tek letërsia e madhe: burrat dhe gratë në të gjithë botën janë të barabartë, dhe se është e padrejtë t'i nënshtrohen diskriminimit, shtypjes dhe shfrytëzimit. Asgjë më shumë se letërsia nuk na mëson të shohim tek dallimet etnike dhe kulturore, pasurinë e trashëgimisë tonë të përbashkët, dhe t'i vlerësojmë këto dallime si tregues i aftësisë tonë të larmishme krijuese.

Leximi i letërsisë së mirë na jep kënaqësi, pa dyshim, por ne gjithashtu mësojmë, duke e përjetuar po aq thellë jetën çfarë dhe si jemi, integritetin tonë njerëzor, veprimet, ëndrrat dhe fantazitë, vetëm ose në marrëdhënie me të tjerët, në personalitetin tonë publik apo tek vetëdija, tek të vërtetat kundërthënëse, të cilat sipas Isaiah Berlin-it, përbëjnë gjendjen tonë njerëzore.

Degët e tjera të shkencave humane si filozofia, sociologjia, historia apo artet, s'kanë arritur ta ruajnë këtë vizion integrues dhe laik sepse edhe i janë dorëzuar trysnisë së parezistueshme të ndarjes dhe nënndarjes kanceroze të dijes, duke e izoluar veten në fusha gjithnjë e më shumë te segmentuara dhe teknike të ekspertizës, në fusha ku idetë dhe terminologjia shkojnë përtej mundësive të burrave dhe grave të zakonshëm. Kjo s'mund të ndodh kurrë me letërsinë, edhe pse disa kritikë dhe teoricienë përpiqen ta kthejnë në shkencë, sepse krijimi letrar s'ekziston për të hulumtuar një fushë të caktuar të ekzistencës. Ajo ekziston për ta pasuruar jetën me anë të imagjinatës, me gjithçka që ka jeta, jeta e pacopëzuar, e pathyer apo rrudhur në skema

dhe formula, pa humbur të tërën. Kjo është ajo që nënkuptonte Marsel Prusti kur tha: "Jeta e vërtetë, jeta më së paku e bërë më e qartë, tek e cila hidhet dritë, e vetmja jetë, ajo që jetohet plotësisht, kjo është letërsia." Ai s'po e tepronte i ndikuar nga dashuria për prirjen e tij të brendshme. Thjesht donte të thoshte se falë letërsisë, e kuptojmë dhe e jetojmë jetën më mirë, dhe ta kuptosh dhe ta jetosh jetën më mirë do të thotë ta jetosh me të tjerët.

Lidhja vëllazërore që farkëton letërsia mes qenieve njerëzore, duke i detyruar të flasin me njëri-tjetrin dhe të kuptojnë se kanë origjinë të përbashkët, se janë pjesë e së njëjtës familje shpirtërore, tejkalon pengesat e kohës. Letërsia na kthen në të kaluarën dhe na lidh me ata që dikur shijuan dhe ëndërruan nëpërmjet këtyre teksteve që na kanë lënë trashëgimi, na japin kënaqësi dhe ushqejnë ëndrrat tona. Kjo ndjenjë e përkatësisë në bashkësinë e qenieve njerëzore në kohë dhe hapësirë është arritja më e madhe e kulturës dhe asgjë tjetër më shumë sesa letërsia s'kontribuon në ripërtëritjen e saj brez pas brezi.

Borgesi gjithmonë mërzitej kur e pyesnin: "Për çfarë është e dobishme letërsia?" Mendonte se ishte pyetje pa kurrfarë kuptimi dhe përherë përgjigjej: "Askush s'e çon ndër mend të pyesë për dobinë e këngës së kanarinës apo të shkëlqimit të diellit në perëndim! Nëse këto gjëra të bukura ekzistojnë dhe falë tyre jeta, edhe pse për një çast, është më pak e shëmtuar dhe më pak e trishtuar, a s'është mendjevogëlsi të kërkosh ta përligjësh ekzistencën e tyre në mënyrë praktike?

Sidoqoftë, ndryshe nga kënga e zogjve ose spektakli i perëndimit të diellit në horizont, poezia dhe romani s'janë thjesht aty, të formësuara nga rastësia apo nga natyra. Ato janë krijime njerëzore dhe kështu është me vlerë të pyetet se si dhe përse u krijuan dhe çfarë i kanë dhënë njerëzimit, për të kuptuar pse letërsia, e vjetër sa vetë shkrimi, ka jetuar kaq gjatë. Ato janë lindur, si fantazma pa formë, në intimitetin e ndërgjegjes, si kombinim i të pandërgjegjshmes me ndjeshmërinë dhe ndjenjat e shkrimtarit. Poetët dhe rrëfimtarët pastaj përballen me gjuhën për tu dhënë këtyre fantazmave të paforma, trupat, lëvizjen, ritmin, harmoninë dhe jetën. Kjo është një jetë joreale, e modeluar nga gjuha dhe imagjinata, e cila ka bashkëjetuar me jetën tjetër, realen, që nga kohërat më të lashta, kurse burrat dhe gratë kërkojnë njëri-tjetrin në këtë jetë të imagjinuar, disa vazhdimisht dhe disa të tjerë më rrallë, sepse jeta që ata kanë s'u mjafton, s'është në gjendje t'u japë gjithçka që duan. Letërsia nuk fillon të ekzistojë kur shfaqet si vepër e një individi të vetëm, ajo ekziston me të vërtetë vetëm kur përqafohet nga të tjerët dhe nëpërmjet leximit bëhet pjesë e jetës shoqërore, një përvojë e përbashkët.

Një nga efektet e para të dobishme ndodh në nivelin e gjuhës. Një bashkësi pa letërsi të shkruar, e shpreh veten me saktësi, ngjyresa kuptimore dhe qartësi më të vogël sesa një bashkësi tjetër, ku fjala, mënyra kryesore e komunikimit, është lëvruar dhe përsosur nëpërmjet teksteve letrare. Njerëzimi pa lexues, i painfektuar nga letërsia, do të ishte si një bashkësi belbanësh dhe të sëmurësh nga afazia, me probleme të jashtëzakonshme komunikimi për shkak të fjalive të pakuptimta si e foluara e foshnjave. Natyrisht, e njëjta gjë është e vërtetë për individët. Njerëzit që s'lexojnë, lexojnë pak ose thjesht lexojnë gjëra pa vlerë, mund të flasin shumë, por thonë shumë pak, sepse kanë repertor shumë të kufizuar dhe të pamjaftueshëm me fjalë për të shprehur veten. S' kemi të bëjmë vetëm me kufizim verbal; por edhe me kufizim intelektual dhe imagjinativ. Kjo zbulon varfërinë e mendimit dhe të njohurive, sepse idetë dhe konceptet përmes të cilave kuptojmë realitetin ekzistues dhe të fshehtat e gjendjes sonë s'ekzistojnë jashtë fjalëve përmes të cilave vetëdija jonë i njeh dhe i përkufizon ato.

Mësojmë të flasim me saktësi, jo në mënyrë sipërfaqësore, me saktësi dhe elegancë nga letërsia e mirë dhe vetëm nga letërsia e mirë. Asnjë fushë apo degë tjetër e artit s'mund ta zëvendësojë letërsinë kur bëhet fjalë për modelimin e gjuhës me të cilën komunikojnë njerëzit. Njohuritë që na përcjellin manualet shkencore ose raportet teknike janë thelbësore, por ato s'na mësojnë se si të përdorim fjalët apo të shprehemi në mënyrë korrekte. Këto manuale shpesh shkruhen shumë keq dhe janë të paqarta, sepse autorët e tyre janë të paarsimuar në letërsi dhe nuk dinë si ta përdorin gjuhën për të komunikuar thesaret konceptuale që zotërojnë. Të flasësh mirë, të kesh në dispozicion një gjuhë të pasur dhe të larmishme, të gjesh shprehjen e duhur për çdo ide dhe emocion që dëshiron të shprehësh, do të thotë që dikush është më i përgatitur për të menduar, të mësoj të tjerët dhe vetë, të komunikoj, si dhe të fantazoj, ëndërroj dhe të ndiej. Në mënyrë të mistershme, fjalët iu bëjnë jehonë të gjitha aspekteve të jetës, madje edhe ato që duken se janë hequr nga gjuha. Dhe ndërsa gjuha u zhvillua, në sajë të letërsisë, ajo arriti një nivel të lartë të përpunimit dhe ngjyresave kuptimore, duke shtuar kësisoj mundësitë për të marrë prej saj kënaqësi njerëzore.

...Ka edhe një tjetër arsye për t'i dhënë letërsinë një vend të rëndësishëm në jetën e kombeve. Pa të, mendja kritike, e cila është motor i ndryshimeve politike dhe kampioni më i mirë i lirisë që kemi, do të kishte pasoja të pakthyeshme. Sepse letërsia e mirë ngre pyetje thelbësore për botën ku jetojmë. Çdo tekst i rëndësishëm letrar, shpesh pa qëllimin e shkrimtarit, priret drejt rebelimit. Letërsia s'ka asgjë për t'u thënë atyre njerëzve që janë të kënaqur me fatin e tyre, janë të kënaqur me jetën ashtu siç është. Letërsia ofron ushqim për shpirtrat rebelë dhe jo-konformist si dhe një strehë për ata që kanë tepër ose mungesa në jetë, shmang palumturinë dhe çdo ndjenjë të mungesës ose asaj që do.

Letërsia mund ta qetësojë për pak kohë këtë pakënaqësi me jetën, por, në këtë interval të mrekullueshëm, në këtë pezullim të përkohshëm të jetës të ofruar nga iluzioni letrar i cili duket se na shndërrron me anë të kronologjisëdhe historisë duke na kthyer në qytetarë të një vendi të përjetshëm dhe të pavdekshëm, ne bëhemi këta të tjerë. Bëhemi më të thellë në mendime, më të pasur, më të ndërlikuar, më të lumtur, më të qartë se sa në rutinën e kufizuar të jetës sonë reale. Kur, libri të mbyllet dhe trillimi letrar braktiset, kthehemi në jetën reale dhe e krahasojmë atë me vendin e shkëlqyer prej të cilit sapo u larguam, dhe kyështë zhgënjim. Jemi përballur me të vërtetën e tmerrshme: se jeta e fantazisë së romanit është më e mirë, më e bukur, më e larmishme, më e kuptueshme dhe më e përkryer sesa jeta që ne bëjmë kur jemi zgjuar, një jetë e cila peshohet nga kufizimet dhe detyrimet e ekzistencës sonë.

Në këtë kuptim, letërsia e mirë është gjithmonë jo qëllimisht, kryengritëse dhe rebele: një sfidë për atë që ekziston. Si mund të mos ndihemi të mashtruar, pasi lexojmë Lufta dhe Paqen apo Në kërkim të kohës së humbur, kur duhet të duhet të kthehemi në realitetin e kësaj bote me pështjellimin e saj të rëndomtë, rregullat dhe ndalimet që na presin dhe në çdo hap kërkon të na zhduk iluzionet që kemi. Më shumë sesa nevoja për të ruajtur vazhdimësinë e kulturës dhe për ta pasuruar gjuhën, kontributi kryesor i letërsisë në përparimin njerëzor është ndoshta të na kujtoj (pa e pasur synim kryesor) se bota është katandisur keq. Ata që shkruajnë, për shembull pro pushtetit, gënjejnë dhe bota mund të jetë më e mirë, më afër botës që imagjinata dhe gjuha jonë mund të krijoj.

Një shoqëri demokratike dhe e lirë ka nevojë për qytetarë përgjegjës dhe me aftësi të mendimit kritik, të cilët janë të vetëdijshëm për nevojën për ta analizuar vazhdimisht botën në të cilën jetojmë dhe, për të provuar për ta bërë atë më shumë si bota që ne do të dëshironim jetojmë. Qytetërimi ka lindur dhe është zhvilluar nga kjo dëshirë këmbëngulëse për ta arritur këtë ëndërr të pamundur, të bëj njësh realitetin me dëshirën, dhe me anë të këtij qytetërimi ne kemi mposhtur shumë, por natyrisht, jo të gjithë demonët që na sulmuan dikur.

Dhe s'ka mënyrë më të mirë për të ushqyer pakënaqësi ndaj jetës sesa letërsia e mirë. S'ka mënyrë më të mirë për të formuar qytetarë me aftësi të mendimit kritik dhe të pavarur, të cilët është e vështirë të manipulohen, të cilët janë të zgjuar dhe gjithmonë ngrenë pyetje, sesa ata që lexojnë libra të mirë. Letërsia e mirë i paqëton dhe i shton dëshirat njerëzore. Duke zhvilluar një frymë jo konformiste dhe kritike ndaj jetës, ne bëhemi më të ndjeshëm ndaj pakënaqësisë. Pa rebelim ndaj mediokritetit dhe mjerimit të jetës, ne njerëzit do të vazhdonim të jetonim në një shtet primitiv, historia do të mbetej në gjendje amullie, individi s'do të kishte lindur, shkenca dhe teknologjia s'do të kishin përparuar, të drejtat e njeriut s'do të njiheshin, as nuk do të ekzistonte liria, sepse të gjitha këto kanë ndodhur nëpërmjet akteve të rebelimit ndaj jetës, e cila shihej si e pamjaftueshme dhe e padurueshme.

Përktheu: GRANIT ZELA

G. G. MÁRQUEZ

SHQIPËRIMI I PARË NGA ORIGJINALI
MIRA MEKSI

njëqindvjetvetmi

Përkthimi më i mirë i vitit 2020

AKADEMIA KULT

OnufriRoman